

Studiuesja veneciane Lucia Nadin, jetën e saj shkencore dhe angazhimet akademike ia ka kushtuar Shqipërisë, duke zbuluar materiale me vlerë të madhe për historinë e kombit tonë si "Statutet e Shkodrës". Këtë vit, ajo botoi edhe një biografi të rigjetur të Skënderbeut në Itali.

Nadin tregon në këtë bisedë për veprën e saj, raportet e veçanta me Shqipërinë dhe rëndësinë e studimeve që ndriçojnë periudhat rreth së cilave njohja jonë është e kufizuar.

LUCIA NADIN: SHQIPËRIA ISHTE TOKA E NJË KULTURE PËR T'U ZBULUAR

Bisedoi Andreas Dushi



SHËNIME PËR LIBRAT

"Në prangat e shqetësimit" i Fejzi Bojkut

NJË KOHË QË MUND TË
NA IKTE PA U VËREJTUR

Nga Emin Azemi

(fq.5)

Shënimet e Fejzi Bojkut në formë ditari nuk janë vetëm të karakterit privat sepse në to gjejmë reminishenca të një kujdesi kreativ njerëzor lidhur...

Romani "Nata me hënë" i Kadarese

PARALAJMËRUES I MESHËS
SË MADHE TË LIRISË

Nga Ndue Ukaj

(fq.6)

RUDOLF MARKU
BOTOHET NË AMERIKË

Poeti i Parë Laureat i Shqipërisë, Rudolf Marku sapo ka botuar në shtëpinë botuese elitare në Amerikë, MUNDUS ARTIUM PRESS, vëllimin poetik "Mountains Entering" (Hyrje në Male)

(fq. 11)

"I kam shërbyer mbretit të Anglisë" i Bohumil Hrabal, përkthyer nga Piro Milkani

NJË AFRESK BURLESK SI NJË
GAZ-A-VAJ QË NA MAHNIT

Nga Josif Papagjoni

(fq.20)

Letërkëmbimi i panjohur i Faik bej Konicës 1897-1900

FILLIMI I NJË MIQËSIE
TË GJATË NDËRMJET
VJENËS DHE BOTUESIT
TË REVISTËS "ALBANIA"

Nga Sylë Ukshini

(fq.10)

OMER KALESHI,

TË MBETESH
SHQIPTAR

NË METROPOLET
E BOTËS

Nga Feride Pappleka

(fq. 8)

Si e ndryshuan
BEATLES
kulturën
amerikane

Joe McGasko

(fq. 22)

JHUMPA LAHIRI
MBI KËNAQËSINË
E PËRKTHIMIT
SI NJË ZBULIM

(fq.21)



BIBLIOTEKË

Nurie Emrullai

(fq. 13)

Vdekja e befasive

Mehmet Elezi

(fq. 14)

Dashnori

Rudolf Marku

(fq. 16)

Poezi

Shqiptar Oseku

(fq. 18)

Jo si Britney Spears

Neviana Shehi

(fq. 19)

Prozë e shkurtër

PYETËSORI

"LIBRAT E JETËS SIME"

VISAR ZHITI:

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar? Kam një romancier që më dhimbet, Astrit Delvina.

(fq. 12)

LUCIA NADIN: SHQIPËRIA ISHTE TOKA E NJË KULTURE PËR T'U ZBULUAR

Bisedoi Andreas Dushi

A.D: E nderuar zonja Nadin. Kjo bisedë me ju, për mua personalisht merr vlerë të rrallë e të veçantë, sepse, për sa kohë Ju i jeni përkushtuar Shkodrës, ndjej sikur flas me një zë në të tashmen që më tregon Shkodrën e shkuar. Ndaj, s'ri dot pa e shprehur lumturinë që kjo bisedë më jep. Ku zë fill dashuria juaj me Shqipërinë dhe dëshira për të njohur më shumë rreth të shkuarës së saj?

L.N: Me Shqipërinë më lidh një raport njohësh dhe dashurish të zëna fill në vitin e largët 1995, kur erdha me emërim në Universitetin e Tiranës për të dhënë mësim gjuhe dhe letërsie italiane. Pastaj jetova në Shqipëri për 5 vite, duke e njohur nga veriu në jug dhe duke lidhur miqësi që ende i ruaj edhe sot. Për Shqipërinë ishin vite të vështira, ngritja e piramidave, rënia e tyre, dëshira e një shumice të popullsisë për t'u arratisur, vështirësi materiale. Unë isha e ngarkuar edhe me punë jashtë-akademike pranë Ambasadës Italiane, kështu kam qenë në dijeni të shumë prej problemeve që hasnin shqiptarët. Zgjodha të jetoj në një lagje të çfarëdoshme të Tiranës,

midis njerëzve, duke ndarë me ta shumë vështirësi (dritat që iknin, uji që mungonte shpesh e të tjera, e të tjera). Kështu u njoha me njerëzit, u njoha me solidaritetin e tyre dhe lindën sa e sa miqësi. Ruaj një kujtim shumë të bukur të atyre viteve në të cilat Shqipëria kishte hedhur sytë nga e reja, nga demokracia. Që prej asaj kohe kam lidhur miqësi që ende sot mbeten të pazëvendësueshme.

A.D: E me Shkodrën, çfarë ju lidh në mënyrë kaq të veçantë?

L.N: Përpara se të nisesha në Shqipëri për punën që më ishte ngarkuar, kisha kuptuar se historia e qytetit tim, Venecias, kishte një lidhje të ngushtë, tejet të veçantë me Shkodrën. Në Pallatin e Dogjëve, në një tablo të madhe të Paolo Veronese-s që i përket gjysmës së dytë të shekullit XVI, paraqitet Shkodra. Në toponiminë e qytetit, në Lido, gjendet një rrugë që i është kushtuar Shkodrës. Madje edhe mbiemri Scutari (Shkodra, në It.) është i pranishëm të mbiemrat italianë, mjaft të shohësh një listim telefonik. Pastaj, kur hap një libër të

çfarëdoshëm mbi historinë veneciane, gjen mjaft faqe të veçanta kushtuar Shkodrës. Në udhëtimin e parë që krena në Shkodër, kërkoja menjëherë, plot emocione, gjurmë të puseve veneciane që edhe në shekullin e kaluar historiani i artit Sergio Bettini i kish parë dhe fotografuar. Për fat të keq, sot kanë mbetur shumë pak syresh. Me një fjalë, raporti im me Shkodrën që paracaktuar të ishte i veçantë që prej fillimit dhe u vulos mëpastaj me gjetjen e tekstit të Statuteve mesjetare të saj.

A.D: Botimi i studimeve e zbulimeve tuaja të para, si u prit nga lexuesi italian? A u tregua interes ndaj tyre?

L.N: Pata fatin që profesori Gherardo Ortalli, një historian i nderuar i Universitetit të Venecias, e kuptoi menjëherë rëndësinë e teksteve të Statuteve dhe dëshironte që një tekst i tillë të bënte pjesë në "Korpusin Statutor të Venecias", një përmbledhje kjo e të gjitha statutëve të qytetit të Serenissima-s. E kështu ai gjeti fondet për të mbuluar shpenzimet e botimit. Ama u desh kohë që të vlerësohej puna ime mbi Shqipërinë, dokumentacioni që gjeja në arkivat veneciane ishte një material i ri dhe, ashtu siç ndodh gjithnjë, e reja pranohet pak e nga pak.

Ndërkohë, gjatë viteve '90, emigrimi prej Shqipërisë që një akt që në mjedisin italian ndodhi me njëfarë qëndrese, Italia për herë të parë shndërrohej në tokë emigrimi pasi kish qenë tokë prej nga emigrohej. Që në fillime, puna ime ishte kundra rryme, duhej të dëshmoja se vetëm injoranca e historisë mund të të bënte të besoj se Shqipëria nuk kish një histori ngushtësisht të ndërthurur me atë të Republikës Venedikase. Beteja ime ishte të përmbysja imazhin e anijes "Vlora" dhe të dëshmoja se Shqipëria ishte toka e një kulture të tërë për t'u zbuluar. Jam krenare që ia dola kësaj.

A.D: Kontributi juaj është i gjerë, përfshin shumë vite e shumë vepra, por ndër to, nga më kryesoret mund të cilësohen "Statuti di Scutari" apo jo? E keni rrëfyer disa herë se si i gjetët ata, ndaj dua të di diçka tjetër: ç'emocion ju shoqëroi në fillim kur prekët me dorë dorëshkrimin e rregjisruar në Bibliotekën e Muzeut Correr?



L.N: Është e vështirë të përshkruaj një emicion kur, ndër letrat e vjetra të arkivave, befas ti gjen përgjigjen që aq shumë e ke kërkuar. Në vitin 1995, kur gjeta dorëshkrimin e Statuteve të Shkodrës në Bibliotekën e Muzeut Correr, e hapi me emocion dhe zbulova se bëhej fjalë për një gjetje të jashtëzakonshme, e cila do t'i jepte zë Mesjetës shqiptare, duke bërë me dije se sa ishte e përfshirë në rrethin e Adriatikut e të Mesdheut Shqipëria bregdetare, kështu pra edhe në rrethin Europian; pasi përpara se të zbulohet Amerika, ishte Mesdheu qendra e botës dhe rreth tij sillej e gjithë Europa.

Një kodik prej vetëm dyzet faqesh do të zhbënte heshtjen shekullore! Çfarë emicioni! Kërkimi midis dokumenteve të së shkuarës, në arkiv dhe në bibliotekë, është një fushë magjepsëse, sigurisht e mundimshme, të duhet durim për të kërkuar, për të gjetur gjurmët, për të sistemuar burimet, por lodhja shpërblehet mëpastaj prej ngazëllimit, nga vetëdijësimi se ke shkëputur prej harresës periudha historike, e në këtë rast të historisë së popullit shqiptar. Ky kodik, ekzemplari i vetëm ekzistues i një rangu me *Mesharin* e Gjon Buzukut, zeron heshtjen shekullore: kjo është mrekullia e gjetjeve në arkiva.

Mendimi i parë që më behu ndërsa e shfletoja, ishte që të nisesha sa më parë nga Venecia për të mbërritur në Shqipëri dhe t'ua bëja të ditur të gjithëve se një kodik i vogël ia kthente zërin një shekulli heshtjeje. Solla me vete fotokopjet dhe nisa të punoja, në përgjithësi mbrëmjeve, kur kthehesha nga puna në shtëpinë te Rruga Myslym Shyri në Tiranë. U deshën muaj e muaj për të interpretuar disa



radhë, për të kuptuar disa terma, për të gatitur një fjalor. Më pëlqen të përsëris se është një pasaportë për Shqipërinë e cila ishte shtet i Europës dhe sot ka ambicien për të qenë pjesë e bashkësisë europiane. Një tekst i cili, përtej ca bindjeje të ndryshme fetare, duhet të hyjë në çdo shtëpi, pasi është një dokument historik dhe historia njihet e respektohet në etapat e veta të ndryshme, pavarësisht se si zërthehet.


A.D: Po studimi për “Shqiptarët në Venedik” si ishte për ju? Kur u vetëdijësua se duhej shkruar e sqaruar historia e emigrimit të madh të shqiptarëve drejt Venedikut gjatë Mesjetës?

L.N: Vetë rigjetja e kodikut të Statuteve më shtyu të thellohesha në datat dhe periudhën në të cilën ai u mblodh në Venecia prej bashkësisë shqiptare e cila qe shpërngulur në Venecia pas vitit 1479, pra pas paqes së vendosur midis Venecias dhe Perandorisë Osmane. Kështu nisi kërkimi në arkivat e Arkivit Shtetëror të Venecias, i cili më bëri të dokumentoj procesin e plotë të emigrimit nga Shqipëria në Metropolin e Adriatikut. Një punë e gjatë e cila u ravijëzua në librin *Shqiptarët në Venedik. Mërgim e integrim 1479-1552*. Në ndër kohë, isha kthyer në Itali për shkak të një problemi të rëndë që m'u diagnostikua në Tiranë dhe që më shtrëngoi të hiqja dorë nga puna e ngarkuar e mësimdhënies në Shqipëri. Për fat, e kalova këtë problem dhe iu përkushtova punës kërkimore me kohë të plotë.

A.D: “Venezia e Albania. Una storia di incontri e secolari legami” Nga çfarë mendoni se burojnë këto lidhje mes Venedikut dhe Shqipërisë?

L.N: Gjatë studimit të historisë së Shtetit nëpërmjet dokumenteve, zbulova menjëherë raportet përgjatë shekujsh që kishin lidhur Shqipërinë me Republikën Venedikase. Sidomos Shqipërinë e zonës bregdetare, më shumë se atë të thellën, maloren, pasi Shqipëria ishte një tokë strategjike në shkëmbimet tregtare detare midis Venedikut dhe Lindjes. Në veçanti kuptova se sa ishte Venediku i lidhur me Shkodrën, jo se dilte menjëherë në det, por e lidhur saje detit nëpërmjet sistemit të vet të anijeve. Pastaj, Shkodra ishte edhe një kryqëzim i rëndësishëm tregtar me qytetet e brendshme që nuk kishin dalje në det, me qytetet e Europës jugore. Qe e tillë përgjatë gjithë Mesjetës, qe në veçanti përgjatë njëqind vitete të protektoratit venedikas, qe mëpastaj përgjatë shekujve në vazhdim, kur Shqipëria u bë pjesë e Perandorisë Otomane dhe nisën kështu raportet dhe interesat tregtare, edhe pse të ndërprera herë pas here prej luftimeve midis dy fuqive. Por sot dihet se gjithnjë qenë kërkuar periudhat e paqes prej të dy palëve për të lidhur raporte tregtare. Dhe prej shekullit XVII në Venedik u hap zyrtarisht zyra e tregtisë së Perandorisë Otomane, Fondaco dei Turchi, një pallat që sheh nga Kanali i Madh dhe i cili ende sot admirohet.

A.D: Libri juaj “Albania ritrovata” u velësua me çmimin e parë nga Akademia e Shkencave para pak vitesh. Si ka qenë historia e atij libri dhe cilat ishin të rejtat që ai solli në njohjen e historisë shqipe?



L.N: Studimi i migrimeve të shqiptarëve në tokat venedikase më bëri të thellohesha më pas te tema e veprës së parë të shtypur në gjuhën shqipe, *Mesharin* e Buzukut. Nisa të studioja botën e botuesve të Pesëqindës për të zbuluar shtypësin e mundshëm të librit. Pista e kërkimeve më shpuri tek emri i një botuesi: Bernardino Vitali, i cili shtypi dy veprat e Marin Barletit, *Rrethimi i Shkodrës* dhe *Jeta e Skënderbeut*. Këtu ama u çel një tjetër fushë kërkimesh, Vitali ishte me origjinë shqiptare, ai ishte një botues i rëndësishëm për kohën dhe, duke studiuar raportet midis tij dhe botuesve të tjerë (Venediku i shekullit XVI ishte kryeqyteti evropian i shtypshkrimit) nisa të ndërtoj një histori raportesh midis botuesve që shtypnin libra për bashkësitë e huaja, që prej dalmatëve e gjer tek arabët, pra në shumë prej gjuhëve vendase të tyre, nëpërmjet përdorimit të karaktereve të ndryshme të shtypit. Gjeja ndonjëherë edhe të dhëna rreth Buzukëve, jo të lidhura me botën e armatimeve (Bosichio [Bozikiot] qenë stradiotë të njohur në shërbim të Venedikut), por të Buzukëve që vinin nga veriu i Shqipërisë. Hamendësova praninë e Gjon Buzukut në Venedik, në një kuvend françeskan (duke u bazuar te të dhënat françeskane të pranishme në tekst, të vëna në pah tanimë prej studiuesit Roques), hamendësova se *Meshari* mund të jetë heur nga qarkullimi



jo për arsye fetare (pasi në gjysmën e dytë të Pesëqindës u ndalua prej palës romane shtypi i librave në gjuhë të tjera), por ndoshta për shkak të problemeve të lidhura me botuesin e Buzukut që unë e identifikova si Bernardino Bindoni, botimet e së cilit, veçanërisht ato të veprave fetare, paraqesin karakteristika të përbashkëta me tekstin e Buzukut. Ky botues u zbuja nga Venediku më 1550 dhe kështu zyrtarisht nuk mundte të shtypte më, por punishtja e tij mbeti në njëfarë mënyre ende aktive dhe, duke qenë se bëhej fjalë pavarësisht të tjerash për *Mesharin* i cili duhej shtypur në një botim ekonomik, kush e kishte komisionuar tekstin lipsej t'i drejtohej për mbështetje një punishteje shtypi si ajo e Bindonit. I ruaja këto pista kërkimi për thellime të mëtejshme pranë bashkësisë shkencore, publikova *Shqipëria e rigjetur zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e venetos në shk. XVI* dhe për këto shtigje të reja të hapura mora çmimin e Akademisë së Studimeve Albanologjike. Në po të njëjtin libër paraqisja edhe praninë e emigrantëve të rëndësishëm shqiptarë në Venedik që i përkisnin botës së artit venedikas. Dhe, për sa i përket botës së artit, vlen të përmendur sa më poshtë:

Në gjysmën e dytë të Katërqindës, pas Skënderbeut dhe pas dy rrethimeve të Shkodrës, Republika Venedikase u hap ndaj kujtdo që dëshironte të shkonte. U krujua një fluks emigrantësh të cilët

shkruan një histori të ndryshme nga ajo e arbëreshëve të Italisë së jugut. Qe e pabesueshme politika integruese që u vendos prej Venedikut dhe shqiptarët i ftuan përgjatë të gjitha territoreve të Republikës, ku edhe përzihehin me popullatën e zonave. Shumë kisharëve iu dhanë punë arti në kishat ku u caktuan, punë të cilat ende sot admirohen. Nuk mund të harrosh, për shembull, se midis bijëve shqiptarë që u transferuan në Venedik, ishte edhe Paolo Campsa (Kamsi), i cili sot vlerësohet si një prej skulptorëve më të rëndësishëm në dru të Venedikut gjatë Rilindjes dhe se veprat e tij janë stoli të çmuara të cilat ende sot mundet të admirohen në kishat e vendeve të ndryshme të provincave venedikase. Ishte i biri i Alessandro Kamsit, skulptor druri në Shkodër, i cili kishte emigruar në vitin 1479. Historia e Shqipërisë së shekullit XV ka mbetur ne kujtesën e Republikës Venedikase, një histori që mbiu brenda vetë historisë, mbi të gjitha Shkodra dhe qëndresa e saj historike, po ashtu si edhe Skënderbeu, i cili u nderua me statuja, piktura dhe tekste teatrore që mbërrijnë deri në shekullin XIX! Gjithaça e kam përmbledhur në librin *Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shekujt XV-XVIII) të botuar në vitin 2018*, përkthyer në shqip në mënyrë të shkëlqyer nga profesoresha Evalda Paci.

Siç u tha, në Venedik u shtyp *Meshari* i Buzukut më 1555, në Venedik komuniteti katolik i Shkodrës pati zyrën e vet në një pallat, fasada e gdhendur e së cilit ende sot ruhet në mënyrë të përsosur.

Skënderbeut i janë kushtuar shumë faqe nga letërsia venedikase, bëmat e tij u bënë pjesë e miteve të Republikës Venedikase, në Arsenalin Venedikas qenë ruajtur një armaturë dhe armë të tijat. Ja, edhe diskutimi i armëve të Skënderbeut të ruajtura në Venedik ka hapur një skenar të ri mbi këtë argument, në lidhje edhe me armët e ruajtura në Vienë.

A.D: Sërish vini me një rigjetje. Tanimë bëhet fjalë për një biografi të heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit. “Scanderbeg, una biografia ritrovata” u botua në mars nga “Besa Muci”. Çfarë është ky libër? Çfarë të dhënash biografike kemi për autorin Giancarlo Saracenin dhe për nipin e tij që e përmbylli punën? Si u njohën ato me Skënderbeun dhe pse vendosën të shkruanin pikërisht për të?



L.N: Në tjetër zbulim i kohëve të fundit tejet interesant lidhet me Skënderbeun, i nxjerrë nga libri *Scanderbeg: Una biografia ritrovata*, botuar nga Besa Muci pikërisht në vitin 2021. Duke lexuar veprën e një eruditi të gjysmës së dytë të shekullit XVI, Giancarlo Saraceni, pra historinë e njërit prej njerëzve më të famshëm të të gjitha kohërave për bëmat e tij heroike: *I fatti d'arme famosi successi tra tutte le nazioni del mondo*, vepër në dy vëllime, u ndesha në disa faqe të veçanta kushtuar Skënderbeut, në të cilat autori paraqiste një biografi të plotë të Heroit Shqiptar. Për Giancarlo Saraceni-n nuk ka shumë të dhëna, ai ishte një qytetar venedikas i cili iu kushtua përmbledhjeve historike. Në kohët që erdhën pas tij u gjykua si historian skrupuloz i cili i kish mbeldhur me shumë korrektësi burimet. La pas veprën në të cilën bën pjesë biografia e Skënderbeut, sigurisht që në dorëshkrim për shak se ia behu vdekja. Qe i nipi (mbi të cilin duhet kërkuar në vazhdim për të gjurmuar një identitet) i cili pati kujdesin të dërgonte në shtyp të dyja vëllimet e veprës në dorëshkrim, duke e kuptuar rëndësinë e punës së madhe, të jashtëzakonshme, të kryer prej të ungjijt, dhe e botoi në vitin 1600. Përsëris se bëhet fjalë për një galeri të burrave të armëve më të famshëm të kohërave dhe viseve. Skënderbeu, me të drejtë, bënte pjesë në këtë galeri.

A.D: A mund të na flisni për ato fakte që lidhen me Skënderbun të cilat dalin për herë të parë në këtë biografi?

L.N: Në rastin e Kastriot Saraceni, nuk u limitua të rrëfente bëmat e jashtëzakonshme që ndërmoi; donte t'i përfshinte brenda një kornize të saktë, donte të rrëfente pikërisht jetën e këtij heroi të cilin, siç shkroi, e quante "Më të madhin" e kohërave: Herkuli i Tebës, Akilin, romanin Licio Dentato. Ndoshta sepse ishte një hero që i përkiste historisë së shkuar dhe ndaj duhej të paraqitej plotësisht. Biografia përqaset qartësisht me atë të Marlin Barletit, ajo nuk paraqet të dhëna të pasakta në lidhje me ato të historianit shkodran. Kësisoj s'ka për të ngritur midis studiuesve të sotëm kritika apo polemika, pasi, e përsëris, rimerr linjat "klasike" të një Barleti dhe të Demetrio Franco-s, dy tekste të përhapura gjatë shekullit XVI kur edhe shkroi Saraceni. Por është forma, është rrëfimi krejt i ri, dhe i lejojnë edhe atyre që nuk janë ekspertë të lëndës të lexojnë shpërfillshëm bëmat e Skënderbeut dhe të kuptojnë saje një qartësie të jashtëzakonshme teknikat e luftimeve të tij, të cilat edhe unë vetë për herë të parë i ndesha me të vërtetë. Për këtë mendova se ia vlente t'i publikoja, pasi shumë pak dihet për Skënderbeun në Italianë veriore; duhej një tekst i qartë dhe i thjeshtë që të bëjë të kuptosh pse me të drejtë qe mbajtur për hero i kohëve të veta. E kush ndërkohë mundet ta lexojë biografinë e Barletit? Vetëm specialistët; ndërkohë që biografia e Saraceni-t mund të lexohet prej të gjithëve, ashtu siç mundet të lexohen me kënaqësi jetët e personazheve të mëdhenj të historisë. Është ky pra një rast për të afruar jo-ekspertët me historinë e Shqipërisë dhe të kulturës së saj antike. Historia e Saraceni-t, e shkruar me objektivitet të lartë, pa ideologji, pa interpretime "mrekullibërëse, fetare", përshkrimi se

si vërtet dinte të vepronte një strateg ushtarak. Mendoj se kushdo, edhe ata që nuk janë specialistë, mundet ta shijojë një lexim të këndshëm, të rrjedhshëm që të mban gjithnjë pezull. Ja pra, përsëris, arsyet që më kanë shtyrë t'ia propozoj sërish një publiku më të madh, i cili ka shije për bëmat e mëdha të historisë.

A.D: Mendoni se lexuesit dhe studiuesit janë të gatshëm t'i mirëpresin?

L.N: Me një fjalë, nuk është një biografi që duhet të ngjallë polemika, interpretime të reja, pikëvështrime të ndryshme, jo, përsëris, ndjek shtegun e Barletit, por pa sforcime ideologjike. Skënderbeu i përkiste të Mëdhenjve, ashtu si Herkuli, Akili, ishte dhe mbetet Hero i të gjithë kohërave, madhështia e së cilit u pranua prej vetë Armikut, është ky dimension i Viganëve ai që të shijon, përtej shpurës së një pale apo të palës tjetër.

A.D: Po në kopertinën e këtij libri, pse është pikërisht piktura e Vincenzo Giacomellit, "Antonio Loredan e l'assedio di Scutari"?

L.N: Kopertina e librit? Dukshëm, nuk ka të bëjë me Skënderbeun, pasi shfaq rrethimin e parë të Shkodrës, më 1474 dhe mbizotërimin e venedikasit Antonio Loredan. Bëhet fjalë për një tablo që kam "zbuluar" tani së fundmi, e ruajtur në Treviso: i përket gjysmës së Tetëqindës, pra ende në Tetëqindën Venediku promovonte

historinë e Shkodrës të lidhur me atë të Venedikut! Dhe kishin kaluar katër shekuj. Venediku kremtonte Shkodrën "e vet"! Është vigjilje e vitit 1848, viti i revolucioneve, dhe në Venedik mbërriti edhe Pashko Vasa...! pra, tabloja flet për Shkodrën dhe bëmat e ndodhura rreth gjashtë vite pas vdekjes së Skënderbeut. Por çdo tablo duhet lexuar dhe studiuar me ngadalësi.

Në pjesën e poshtme të tablosë, në të majtë paraqitet një personazh i nderuar, i cili nuk ka shumë të bëjë me rrethimin e vitit 1474: besoj se është Skënderbeu, i vendosur lirisht prej piktorit dhe porositesit për të dijesuar se si mbrojtja e Shqipërisë kish mbërritur prej tij gjer në Shkodër, gjithnjë e lidhur me Venedikun. Qe kryer një "montazh i lirë", qe vendosur personazhi i ndritur i historisë së Shqipërisë, Skënderbeu, i cili dërgonte dëshmitarë në Shkodër: sigurisht që kemi të bëjmë me një interpretim të lirë venedikas, duke qenë i vendosur jo rastësisht në qendrën të telajos kolona me Luanin e Shën Markut. Ja pse zgjodha atë tablo si imazh të kopertinës: është "përmbledhëse" e bëmave të Shqipërisë së Katërqindës, që luftonte për afirmimin e saj si shtet në ndërtim përreth personalitetit të Skënderbeut dhe, - a posteriori - "përmbledhëse" e pranisë venedikase në Shqipëri dhe të interesit që e kish lidhur atë vend me Metropolin detar. Me një fjalë, përsëris, edhe ky imazh risjell shekuj të historisë venedikase të gërshetuar me historinë e Shqipërisë antike, na shpie te lidhjet e forta që Venediku pati me Shkodrën

"e vet", shpie te leximi i një aleance të ngushtë me Skënderbeun, veprimet e të cilit edhe u interpretohet sërishmi sipas optikës dhe interesave të Venedikut; por kjo nuk përjashton faktin se Shqipëria, me faqet e saj të ndritura, është bërë pjesë prej shekujsh në kujtesën venedikase dhe se është pavdekësuar në shumë vepra arti.

A.D: Kjo nuk është hera e parë kur studimet tuaja fokusohen në figurën e Skënderbeut, apo jo? Kujtoj këtu "Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut". Çfarë ju frymëzon kaq shumë te Heroi?

L.N: Skënderbeu qe një strateg ushtarak, aq sa qe strateg politik: projekti i tij për të krijuar një shtet të bashkuar, për ta bërë Shqipërinë e përcarë një shtet të vetëm, ndikonte edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, të Venedikut së pari, i cili mbante kontrollin e Adriatikut ndaj lindjes së afërt dhe rrugët e komunikimit të Mesdheut. Dhe ndaj historia e Shqipërisë, e shekullit XV në veçanti, e luftimeve të Skënderbeut dhe të qëndresës së mëpasshme të Shkodrës, nuk mundet të mos i interesojë atij që merret me historinë e Europës e cila kishte ndikimin e saj në Mesdhe, përpara zbulimit të Botës së Re. Ja pse ky interes i imi ndaj Skënderbeut.

A.N: Studimet për të, a janë mjaftueshëm serioze si dhe shtruese?

L.N: Mendoj se ka ende për t'u shkruar mbi periudhën mesjetare shqiptare, besoj se ende ka dokumente për t'u zbuluar. Po kështu edhe për Skënderbeun dhe politikën e tij ndërkombëtare, e cila e përfshinte Shqipërinë në rrethin politik të disa shteteve. Besoj se në të ardhmen kërkimet në arkiva mund të sjellin njohuri të reja.

A.D: E së fundmi: Shqipërinë, kur keni në plan ta vizitoni sërish?

L.N: Në Shqipëri kthehem kryesisht çdo vit. I jam mirënjohëse Autoritetit Shqiptar që më ka dhënë shumë nderime në çmime, përfshirë atë më të çmuarin, "Skënderbeu"! Pasatj jam edhe qytetare nderi e Shkodrës, e kështu e quaj veten veneciano-shkodrane! E si mundet të qëndroj larg një vendi të cilin e kam dashur kaq shumë dhe që kaq shumë më ka nderuar? Një qyteti të cilit ende sot vazhdoj t'i kujtoj gjithë kohën e mundshme për t'i kthyer copëza të historisë? Më duhet të marrë pjesë në dy konferenca në Tiranë, në shtator dhe në nëntor, të shohim nëse situata me Covid-19 dhe shëndeti im do të mund ta lejojnë. Për ta mbyllur, dua të nënvijëzoj kriteret që kam ndjekur gjatë këtyre dekadave punë mbi Shqipërinë: kam dashur gjithnjë të gjej dokumente që edhe studiuesit shqiptarë të mund t'i analizojnë, nuk i kam lejuar kurrë vetes të shkruaj interpretime subjektive, për hir të historisë tërësore të një vendi. Kërkimi, për këtë jam e bindur, duhet të jetë serioz, i ndershtëm, i çinteresuuar dhe i përshkuar nga përlësia përballë problemeve të mëdha që e shkuara na paraqet.

Përktheu nga italishtja
RIGEL RIZAJ



Shënimet e Fejzi Bojkut në formë ditarit nuk janë vetëm të karakterit privat sepse në to gjejmë reminishenca të një kujdesi kreativ njerëzor lidhur me problemet sociale të cilat e rrethojnë. Këtë kujdes dhe shqetësim ai e shpreh me sinqeritet të plotë dhe gjithmonë duke kërkuar përgjigje për shumë çështje ideore dhe dilema që shfaqen gjatë proceseve nëpër të cilat kaloi shoqëria gjatë viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta

NJË KOHË QË MUND TË NA IKTE PA U VËREJTUR

Nga Emin Azemi

Njerëzit mund të mbajnë ditar për shumë arsye, dhe në të shumtën e rasteve ditarët janë bërë objekt analizash e studimesh mbi një personalitet që përmes ditarit të tij ka ruajtur të paprekur një pjesë të padukshme të jetës së tij. Pikërisht ky dimension biografik i autorëve që kanë mbajtur ditar, është përfshi pastaj në korpusin më të gjerë tematik e problemor, duke ndihmuar në ndriçimin sa më të mirë të jetës dhe veprës së autorëve të caktuar. Ka ndodhur gjithashtu që rrjedha biografike e një personaliteti, qoft i artit, i diplomacisë apo i shkencave, të pësojë ndryshim thelbësor pasi që janë zbuluar detaje të panjohura të gjetura në ndonjë ditar të tyre. Pikërisht këto detaje kanë determinuar edhe një dipotri tjetër gjykimi mbi veprimtarinë e tyre, sepse në të shumtën e rasteve gjurmët e jetës së një shkrimtari, artisti, diploamti, shkencëtar i shohim të zënë vend edhe në veprimtarinë e tyre.

Ditarët zakonisht kanë shërbyer si burim informacioni, pasi që shumë emra të njohur kanë ruajtur shënime të cilat më vonë i kanë botuar si ditarë, kujtime ose memoare. Shpesh ka qëlluar që ato ditarë pastaj shkrimtarët dhe skenaristët t'i kenë shfrytëzuar duke i shndërruar në vepra letrare ose kinematografike, sepse ditarët e tillë përmbajnë tema komplekse, drama dhe fate njerëzore.

Edhe shkrimtari ynë Fejzi Bojku jo vetëm që ka dëshmuar aftësitë e tij kreative letrare, por ka mbajtur shënime për ngjarjet dhe njerëzit e kohës me të cilët ka jetuar. Shënimet e tij pasqyrojnë periudhën e viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

Mund të shpresojmë se edhe këto shkrime mund të shfrytëzohen në forma të tjera kreative, për ndonjë roman, tregime, ose krijime poetike.

Autori i këtij ditarit voluminoz në dy vëllime, i cili pothuaj tërë jetën e kaloi me dy revistat e njohura ("Gëzimi" e "Fatosi") dhe krijimtarinë për fëmijë

dhe të rinj, dikur u bind se botën e politikës dhe etjen për pushtet dhe pasuri nuk e njihte sa duhej.

Më në fund, ashtu si thotë edhe vet Fejzi Bojku në ditarët e tij, mendimet dhe vlerësimet për të tjerët nuk mund të jenë kriter absolut i të vërtetës, sepse ato janë të natyrës subjektive dhe në vartësi nga çastet dhe rrethanat e caktuara ideore dhe kohore.

Në ditarët e tij F. Bojku ia ka arritur të ndërtojë parabola rrëfimesh përplot kreativitet, të cilat ndërlidhin anët e ndryshme të botës. Ai vet është dëshmitar i kësaj lidhjeje, sepse ka qenë pjesëmarrës në udhëtime dhe ngjarje të tilla.

Posaçërisht frymëzuese janë udhëtimet e tij në Amerikë, Gjermani dhe vende të tjera, ku gjithmonë në një kënd të kujtesës ndriçon malli dhe kujdesi ndaj familjes, lidhjet me vendin e punës, si edhe problemet që preokupojnë shoqërinë dhe njerëzit me të cilët ai ka bashkëpunuar dhe bashkëjetuar.



Duke udhëtuar dhe biseduar, në kontaktet me njerëz, sidomos me ata të familjes së afërme dhe të fëmijërisë, Fejzi Bojku, njëkohësisht edhe mediton për ngjarjet dhe bisedat të cilat i bashkon në një kuti magjike të mbresave, të cilën e ruan me dashuri dhe fanatizëm.

Në ditarët e tij ai pasqyron ndriçimet dhe hijet e jetës së kurbetçinjve tanë në Amerikë, të cilat për të tjerët janë jo aq të njohura.


Përshkrimi i këtij realiteti bëhet thuaj në mënyrë telegrafike, mirëpo edhe mjaft thelbësore dhe i bartur me plot detaje përcjellëse. Shënimet e Fejzi Bojkut në formë ditarit nuk janë vetëm të karakterit privat sepse në to gjejmë reminishenca të një kujdesi kreativ njerëzor lidhur me problemet sociale të cilat e rrethojnë. Këtë kujdes dhe shqetësim ai e shpreh me sinqeritet të plotë dhe gjithmonë duke kërkuar përgjigje për shumë çështje ideore dhe dilema që shfaqen gjatë proceseve nëpër të cilat kaloi shoqëria gjatë viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta.

Dilemat e Fejzi Bojkut janë të natyrës njerëzore, dilema të një shkrimtari, por gjithsesi edhe edhe të një intelektualit dhe krijuesi të njohur.

Shikuar nga një këndvështrim i këtillë, para nesh del një Fejzi tjetëri, të cilin nuk e kemi njohur sa duhet, një Fejzi që gjatë tërë jetës ka matur pulsën e kohës me ritmin e shqetësimit dhe kujdesit të tij të brendshëm. Duke pasqyruar ngjarjet dhe mendimet në formën e ditarëve, ndoshta edhe duke mos qenë plotësisht i vetëdijshëm, shkrimtari ynë me këto shënime para nesh ka pasqyruar një formë shkrimi, e cila kombinon me mjeshtri pedanterinë e kronikut me mjeshtërinë krijuese të rrëfimitarit.

Këta ditarë janë një pasqyrë narrative kronike e ngjarjeve dhe rrjedhave jetësore, të cilat mund të na iknin pa i vërejtur.

Me këto vëllime biografike veprimtaria jonë botuese po begatohet me një gjini shumë pak të trajtuar te ne, kurse shkrimtari ynë i nderuar Fejzi Bojku do të bëhet nxitës dhe inkurajues edhe për autorë të tjerë



Shkrimtari i njohur bashkëkohor, Milan Kundera, romanin e përkufizon si formën e madhe të prozës, në të cilën autori, me anë të vetë eksperimenteve (karaktereve), hulumton disa tema të mëdha ekzistenciale. Këtë parim, Kadareja e realizoi mjeshtërisht te romanin,

“*Nata me hënë*”, që është një vepër tejet mbresëlënëse përbrenda prozës së tij; një protestë e hollë dhe e hapur kundër totalitarizmit dhe utopisë komuniste, në të cilin sistem, fati i individit ishte hiçgjë ose *pre* e “mëshirës” së makinës kolektive të partisë, që teksa “kujdesej” për “lumturinë njerëzore”, bluante njerëz të pafajshëm dhe i hidhte në humnerë. Kësisoj, kjo vepra ka diçka të veçantë, që e dallon nga tërë opusi letrar i Kadaresë.

Romani e ballafaqon individin me sistemin, por jo duke e vështuar në planin historik, siç ngjet në shumë vepra të tij, por duke e parë si bluhet në kohën reale të shkrimit, kur partia dhe sistemi kujdeseshin për “moralin komunist” e “për lumturinë e njerëzve”, dhe tentonin ta kontrollonin botën intime dhe shpirtërore të personit.

E, Kadareja flet pikërisht për pasojat që ndodhin nga veprimet e tilla të çmendura, që ishin dukuri të shumta dhe më së normale të tiranisë. Pra, në këtë roman, kemi ideologji dhe liri. Kemi përplasje të ashpër mes këtyre dy koncepteve të kundërta dhe përjashtuese.

Derisa ideologjia e kërkon njeriun në sistem e vet, ku do ta tretë dhe ta bëjë hiçgjë, e dyta, e forcon dhe, e bënë të aftë të qëndrojnë në kalvarin e vuajtjeve, me besimin si një ditë, liria, si vlera më sublime e njeriut, do të triumfojë.

Ndonëse në mendimin letrar, romanin “*Nata me hënë*”, nuk ka zënë vendin e romaneve tjera, sikundër janë “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*”, “*Kronikë në gur*”, “*Pallati i Ëndrrave*”, “*Përbindëshi*”, ky libër është vepër e jashtëzakonshme që është shkruar me stil të hollë narrativ.

Ndërkaq, në një plan tjetër, kjo vepër, gjithashtu, lexuesin e ndihmon që të përsiatë rreth artit kadarean, të futet nëpër labirintet e vështira nëpër të cilat u dashtë të kalonte vepra e tij, për t’i gjykuar pastaj botëkuptimet e tija politike dhe kulturore, meqë, në këtë vepër, ai bën politikën personale kundër regjimit dhe shtreson shenjat kulturore dhe identitare të përkatësisë së letërsisë së tij.

Loja e dykuptimësive narrative, që e karakterizon në masë të madhe letërsinë e Kadaresë, në këtë prozë është krejt e qartë. Vetë Kadareja, në një intervistë që i ka dhënë studiueses Lili Sula, kur është pyetur: “A e projektoni lexuesin tuaj kur shkruani, thënë ndryshe, cili është lexuesi juaj ideal? Apo letërsia e juaj nuk kuptohet nga lexuesi i zakonshëm? - Ai i është përgjigjur, duke u ndërlidhë pikërisht me romanin “*Nata me hënë*”:

“Është një mënyrë të thënie për të mos e pranuar këtë letërsi.

Është libri im, *Nata me hënë*. Ç’ka për të mos kuptuar?! E them në fund të librit që: Ajo si një Shën Mëri...Këtë vepër e kam shkruar dhe botuar në vitin 1985. U ndalua. Dakord! Një vajzë desh e marrin më qafë për një thashethem. Lind paradoksi nga tronditja që shkaktoi thashethemi. S’i falën dhe nuk pyeste njeri: *Më kë e ke fëmijën? Në fund thuhet: Që nga shtrojet e bardha, ajo na vështonte, të gjithëve e qetë, buzëqeshëse, jo Shën Mëri e re, që ishte shfaqur në kohën kur pritej më pak.*”

ROMANI I KADARESE “Nata me hënë” PARALAJMËRUES I MESHËS SË MADHE TË LIRISË

Nga Ndue Ukaj

Pra, në këtë roman, siç tregon edhe vetë autori, nuk kemi alegori historike kundër totalitarizmit, nuk kemi simbole që bartin kuptime të vështira për t’u deshifruar-dyzime-për të cilat lexuesi duhet të qëmtojë në kodet alegorike apo metaforike. Teksti është i qartë. Është eksplisit. Është një shfaqje e hapur. Një goditje e fortë ndaj shpërfytyrimit të shoqërisë komuniste. Secili lexues, që e njeh kontekstin e kohës kur u shkrua vepra, e ndien këtë përmasë dhe s’ka sesi të mos admirojë guximin e autorit, për të shkruar një vepër kaq të rrezikshme, kaq goditëse dhe njëherësh kaq mahnitëse.

Romani “*Nata me hënë*”, në aspektin

tematik, duket sikur e “thyen” natyrën narrative të temave të Kadaresë. Si tekst, është botuar së pari me 1985, në një gazetë, dhe qysh atëherë u gjykua armiqësor, nga fakti se, aty paraqitej një realitet i zyrtarë në shoqërinë “idealiste” të diktaturës, dhe parodizohej me trajta të thella groteske regjim, që merrej edhe me punët më të liga, siç mund të ishte morali shoqëror dhe hulumtimet e “virginis” së një femre shembullore dhe të pamëkatë. Më vonë, kjo vepër, përveç se u gjykua, u kritikua, edhe u ndalua. Madje, të dhëna që shoqërojnë botimin e këtij libri përmendin një element me rëndësi që lidhet me aspektin e jashtëm të kësaj



vepre: Në ditën kur autori “hetohej” lidhur me këtë roman, diktatori kishte vdekur, por lajmi ishte mbajtur i fshehtë.

Kadareja, në këtë roman e ndërton portretin fisnik të Marianës, një heroinë dhe figurë shembullore, që rri përballë shëmtisë dhe veseve të diktaturës, tamam si një Shën Mëri biblike. Kjo protagoniste e këtij romani, ndonëse sflitet përballë një gjyqi krejt absurd, ka fatin që t’i sjell Shqipërisë një djalë të ri dhe të duket shenjtërore.


Narracioni i romanit dhe përshkrimet e holla që bënë autori, mënyrë sesi është ndërtuar intriga, pasojat psikologjike që bartë ajo, të përshkruara me një gjuhë poetike, flasin për përmasat e një intrigë që u krijua pas një shëmtitje në një natë më hënë, kur heroína e këtij romani, lexoi disa vargje dashurie, derisa ishte nën shoqërimin e Gazmendit, të sapofejuarit të Norës. Kjo mjaftoi që kundër saj të fillonin shpifje të pashembullta dhe intrigat të mëdha, që atë e bënë të vuante pa masë. Sepse, sipas klanit të Norës, të ndihmuar edhe ngapartia, kjo ishte kundër parimeve të moralit komunist, prandaj edhe

Mariana gjykohet si imorale, meqë ajo “dëmtonte unitetin e familjes socialiste” dhe kjo lidhej me “*ndikimet e moralit borgjezo-revizionist*”. Madje, edhe vargjet e saj, u vlerësuan si dekadente.

Narratori, flet për atmosferën në ndërmarrjen ku punonte Mariana dhe karakteret tjera që përfshihen në këtë dramë, ndërkaq, thelbin i ngjarjes lidhet me dramën psikologjike të Marianës dhe ajo përshkruhet me elemente narrative tronditëse, meqë, atë shpeshherë e shohim buzë gremisë.

Autori, përmes depërtimit psikologjik, në botën e karaktereve, ku luhet loja e “fajit” të orkestruar, tregon ç’vuaite pësonin njerëzit për hiçgjë në atë sistem të degjeneruar. Dhe, siç e do zakoni, faji, nënkupton një shakatar dhe një që e pëson. Ndërkaq, në këtë prozë, jemi përballë “fajit” inekzistent, pra, jemi përballë një intrige, në atmosferën e rëndë të diktaturës, ku fati i individit ishte krejt i parëndësishëm përballë makinës ideologjike kolektive që bluante çdo kënd për një fjalë goje. Autori e parodizon sistemin e përcudnuar shoqëror, i cili, për asgjë ngriste procese të montuara dhe qesharake kundër individit dhe dinjitetit të tij, të cilin e përçmonte deri në përbuzje.

Si në çdo rrëfim, edhe këtë tekst, ndeshën dy botë, dy botëkuptime, dhe dy litarë që tërheqin në drejtime të kundërta.



E partia, ajo që kujdeset për “lumturinë njerëzore”, e përfshirë në këtë dramë “flet për edukimin e njeriut të ri” sipas parimit të moralit komunist, prandaj edhe akti i Marianës gjykohet rënd, dhe ajo në sytë e tyre merr hijen e femrës imorale.

Kadareja, heroinën e përshkruan me dëlirësi të hollë dhe tipare fantastike, kështu që, te lexuesi ajo ngjallë ngashërim, admirim, dhimbje dhe solidaritet të pafund.

Kulmi i konfliktit absurd të kësaj drame njerëzore shpërthen atëherë kur asaj i kërkohet vërtetimi i nderit, për të shpartalluar klanin që e akuzonte atë. Autori këtë e gjykon ashpër, si një akt marrëzi, që fyen rënd dinjitetin e femrës. Pra, asaj i kërkohet vërtetimi për “virginis.”

Dhe, ndërkohë që po mendohej se Mariana u rrëzua, ajo triumfoi, duke u shfaqë e dëlirë. Pasi vizitoi mjekun, ajo arriti të dëshmonte se ishte “virginis” dhe s’kishte pasur asnjë marrëdhënie me Gazmendin, të fejuarin e Norës. Dhe në fakt, siç thotë narratori “*ajo fjalë ‘virginis’ që vinte nga një gjuhë e vdekur, për t’i kthyer nderin asaj.*”

Por ata që tentuan t’i vinin krusmën asaj, bien vetë në kurthin e intrigës që i krijuan heroinës së romanit. Me aktin e saj të fundit, ajo, ndërkaq u dha mundësi të gjithëve që të shpërllanin gjer në fund ndërgjegjen. E me këtë, Kadareja kërkon shpëlarjen e ndërgjegjes së sistemit, që bluante njerëz të pafajshëm në makinën e vet të çmendisë.

Shkrimtari, romanin e përfundon me imazhet e lindjes së një foshnje-të një djali. Pra, epilogu i kësaj drame, protagonisten e nxjerrë shëmbëlltyrë të pashoq morale, që ndonëse akuzohet dhe vuan, nuk përulet dhe as nuk nënshtrohet. Sepse, nën petkun e saj rri dëlirësia, pastërtia, dhe ajo bëhet figurë model, ashtu siç ishte Maria biblike, me të cilën autori e krahason atë. Duke e qartësuar pastërtia mendore e shpirtërore të vajzës së re, Kadareja e shpallë atë shenjtore të kohës, ndërkaq, me lindjen e djalit të saj, ai thërriste hapur për lindjen e një epoqe tjetër: të lirisë dhe përfundimin e mynxyrave njerëzore, ku njerëzit shkonin buzë tragjedisë, për hijëgjë.

Pra, përballë një intrige të shëmtuar, të konstruktuar, Mariana, ndonëse u gjind buzë tragjedisë, ajo triumfoi si shenjtëreshë, rreth të cilës, një ditë, me devocion u përkulen të gjithë dashakeqët e saj, e të cilët nuk ishin pak. Kështu, ajo bëhet personazh model në letërsinë e Kadaresë, dhe mbetet personifikim i fisnikërisë dhe bukurisë shpirtërore që përballët me shëmtinë, shpifjet dhe veset e manive ideologjike.

Pikëtakimet me letërsinë e Kafkës dhe Biblën

Romani “*Nata me hënë*”, me elementet absurde që ngërthen, ndërton një relacion kuptimor me romanin e madh të Franc Kafkës, “*Procesi*”, ndërkaq, zgjidhja që u autori i jep kësaj drame, ndërlidhet me “*Biblën*”, si vepër e madhe e njerëzimit, që ka influencuar artin perëndimor në të gjitha kohët.

Pikëtakimet mes romanit “*Nata me hënë*” dhe romanit “*Procesi*”, mund të vërehen në disa rrafsh dhe ato janë filozofike dhe semantike.

Në romanin e Kafkës, ashtu sikundër në romanin e Kadaresë, kryeheroi Jozefi



K., i nënshtrohet një procesi hetimor, i pavetëdijshëm për fajin dhe i pamëkatë për çka ngarkohej. Kundër tij, orkestronhet një gjyq i madh dhe ai jeton në prehjen që gjen ne vetvete, se ndihej i pafajshëm. Ndërkaq, në romanin e Kadaresë, Mariana, po ashtu është viktimë e komplotit shoqëror dhe gjykohet kinse ka dashur t’ia marrë shoqes, Norës, të dashurin, në një natë më hënë, kur ka recituar disa vargje romantike.

Për dallim prej romanit, “*Procesi*” të Kafkës, në të cilin, heroi ndëshkohet nga një gjyq real, te Kadareja, ndodh e kundërta, meqë heroina e silitur ngadhënjën përballë gjyqit qesharak, dhe, shfaqet si Shën Mëri e ditëve të saj, në kohën kur më së paku pritej një gjë e tillë.

Ky epilog i tillë, i befasishëm, kaq përndjellës, ngërthen në vete shenja profetike dhe artikulon qëllimet e tekstit. Ndërkaq, lexuesi pyet, si guxonte autori, në kulmin e marrëzive komuniste, të kërkonte kaq hapur lindjen e një kohe të re, nëpërmes një mesie, që do ta shpëtonte e shëlbonte Shqipërinë e mbërthyer në çmendinë komuniste?

Nëse teksti i Kadaresë ndërton një relacion filozofik dhe semantik me tekstin e Kafkës, në kuptimin e esencave të brendshme që dalin nga mikrostrukturat letrare dhe filozofia e tekstit, në një rrafsh tjetër, romani e ndërton një relacione krejt të hapur dhe të ontologjik me Biblën, sidomos me episodet që lidhen me lindjen e Jezu Krishtit.

Me këtë shfaqje kaq të hapur në këtë vepër, autori godet një ide dhe njëkohësisht e nxit një tjetër: ai e godet utopinë komuniste që rrafshonte objekte kulti, dhe e nxit atë të përlindjes së Shqipërisë posttotalitare, përmes përmbykses së sistemit të çoroditur dhe triumfit të njeriut që reziston, të shëmbëllyeshëm me Shën Marinë.

Përzierja e regjimit në çështje morale, për autorin është krim, prandaj edhe zgjidhja letrare që bënë ai për t’i dhënë heroinës atributet e një gruaje të shkëlqyer, duke e personifikuar me një figurë

qenësore të njerëzimit, është mahnitëse. Krahasimi i Marianës me Shën Mërinë biblike, është një lartësim etik e filozofik i figurës së saj krejt i veçantë dhe i pashoq në letërsinë tonë.

Për të realizuar këtë objektiv, shkrimtari funksionalizon diskursin biblik, dhe romanit i jep ngjyrim universal, duke e bërë shëmbëlltyrë të pranisë së influencë biblik, si ligjërim dhe tematikë.

Mariana, heroina e romanit “*Nata me hënë*” është e pafaj, një Shën Mëri, që lind një fëmijë triumfues në Shqipërinë ateiste, që vriste priftërinj dhe rrëzonte kisha.

Maria e kohëve të lashta, arketipi biblik, lindi një foshnje që i ndërroi kahet e zhvillimit planetare, ndërkaq, një Marianë tjetër, pasi përmbyes rrjetin e intrigantëve, lind një foshnje.

Siç tregon historia biblike, Maria, kur e kuptoi se ishte shtatzënë, pa patur ndonjë marrëdhënie seksuale, u vu në presion e një “gjyqi” dhe për pak sa nuk u braktis nga i fejuari, por triumfoi, sepse, puna e shtatzënisë së saj ishte proveniencë hyjnore, për t’ia sjellë njerëzimit shpëtimtarin, Jezu Krishtin. Po ashtu, në fund të romanit, ngjashëm me rrëfimin biblik, Mariana, e cila mban edhe emrin e ngjashëm me arketipin biblik, pas shumë vuajtjeve, triumfoi dhe botës së egër të diktaturës, gjithë dashakëqijve, ia dha një flakaresh, duke i turpëruar dhe duke dëshmuar se ajo ishte grua e dëlire dhe e pamëkatë. Kështu, ajo triumfoi kundrejt komplotit të madh që u zhvillua kundër saj dhe kundër partisë shtet, që kompletonte kundër fesë. E, autori kështu e përshkruan këtë moment:

“*Pas daljes nga materniteti, shkuam për ta vizituar vajzën në shtëpi, me përplot dhurata sipas zakonit. Foshnja ishte aty, përbri saj, një djalë yll i bukur, por veç njerëzve të fëmijës, as burrë, as i fejuar, as asgjë. Por kaq e thellë ishte mirënjohja e jonë ndaj saj, mirënjohja që ajo na kishte falur fajet, sa që gjithçka vazhdonte të na dukej e natyrshme dhe plotë dritë. Që nga shtrojat e bardha, ajo na vështronte, të*

gjithëve e qetë, buzëqeshje kjo Shën Mëri e re që ishte shfaqur në kohën kur pritej më pak. “

Romani bartë elemente dhe shenja eksplicite biblike. Takimi me Marianën dhe fëmija që qëndron përballë saj, kur dihet se ajo nuk kishte patur mashkull dhe ishte “virginus”, është trajtë hyjnore, që shkruhet në përkim frymën që përçon rrëfimi biblik për Virgjërinë Mari. Po ashtu, vizitat e atyre që e kanë akuzuar në maternitet, ndërpusin në lojë elemente biblike, respektivisht momentet që pasojnë tregimin për lindjen e Jezu Krishtit dhe vizitat që i bëhen Marisë në

Shpellën e Betlehemit, që nga barinjtë deri te mbretërit.

Heroina që e shitoi sistemin

Shpifja kundër Marianës ishte e qëllimshme, e kurdisur dhe e përpunuar mirë nga armiqtë e saj, të ndihmuar edhe nga sistemi.

Ajo thirret para “gjyqit” të shpifëseve dhe ballafaqohet me tronditje të madha shpirtërore. Në ndërmarrjen ku punonte, kudo flitej për të, nga armiq dhe miq të saj, aq sa psikoza kundër saj, përfshiu një pjesë të repartit. Dhe, siç e do puna, në këso raste, në një sistem të çmendur, shteti, jo që nuk rri indiferent, përkundrazi, përfshihet keq në të. Në këtë lojë narrative, personazhet e romanit ndahet në dysh: ata që e gjykojnë heroinën dhe ata që e mbrojnë atë, por këta të fundit ballafaqohen me fuqinë e pushtetit, prandaj edhe detyrohen ndonjëherë të jenë të lëkundur në qëndrimet e tyre përballë thashethemeve dhe intrigave që vërtiteshin rreth saj.

Autori triumfin e Marianës e përshkruan me një gjuhë të ëmbël dhe mikluese, ndërkaq, në anën tjetër, po ashtu, me një gjuhë goditëse, i përshkruan dashakëqijtë, ata që thuren intriga kundër saj. Triumfi i Marianës krijoi pikëllimi në kampin e armiqve, meqë ajo u shfaq si diçka e pëtejme, si diçka hyjnore: “*Si të ishte shpallje që vinte nga lart përmes një qarje ajo na shitoi të gjithëve.*”

Teksti thotë që fitorja e saj na shitoi të gjithëve. Kjo *ne* është therëse dhe përfshinë tërë sistemin.


Narratori figurën e heroinës e përshkruan me dashuri e devocion hyjnor, dhe, në korpusin romanesk të tij, ajo përfaqëson figurën fisnike dhe shembullore, që e sfidoi marrëzitë komuniste dhe kujdesin e tyre “lumturinë njerëzore”.

Ismail Kadare, në këtë vepër letrare, është me heroinën dhe me devocion flet për të, për përmasën e saj, aq sa, siç shkruan Eric Faye, duket se kur flet për të ka një esencë hyjnore dhe kjo e bën rrëfimin magjik.

Ky roman, i shkruar me mjeshtëri të hollë, tregon edhe njëherë atë që Paul Auster e shtronte në formë të pyetjes: pse i shërben arti, në veçanti arti i fiksionit, asaj që e quajmë botë reale? Lexuesi shqiptar dhe ai i huaj, kur e mbyllë së lexuari këtë roman, kaq të bukur, kaq të guximshëm dhe kaq madhështor, mbetet i kënaqur artistikisht. Po ashtu, ai e ndien peshën e artit të madh dhe të ideve të mëdha letrare, që kumbojnë fuqishme, siç kumbojnë kambanat e një katedrale madhështore që paralajmërojnë një meshë të madhe, ashtu siç paralajmëronte Kadareja me këtë vepër meshën e madhe të lirisë.

OMER KALESHI, TË MBETESH SHQIPTAR NË METROPOLET E BOTËS

Nga Feride Pappleka



"Kokat e prera" në pikturën e Omer Kaleshit tashmë janë bërë të famshme. Ato koka sido që t'i interpretosh mbeten simbol i fatit të njeriut, në të cilin përfshihen disa të vërteta universale të jetës si : lindja, ëndrra, dashuria, vetmia... Piktori krijon një botë të gjallë imagjinare me fytyra të menduara duke dhënë nga afër se çfarë lexohet te sytë e njeriut e ç'mistere fshihen në mendjen e tij. « Piktura, thoshte Leonardo da Vinçi, është diçka mendore ». Si e tillë ajo është njëlloj ligjërimi me anë të ngjyrës, revoltë, optimizëm dhe dashuri përmes shijes së absolutes dhe një misticizmi qenësor.

Me këto piktura ai nuk eksperimenton, por shfaq një mënyrë origjinale vështrimi duke e kërkuar frymëzimin te vrojtimi i brendshëm dhe te mekanizmi imagjinar që është tharmi i artit të tij. Ka një brishtësi, gati-gati legjendare në pikturat e tij, të arritur me pak mjete shprehëse të jashtme, por me një ritëm të brendshëm të përkryer. Barinjtë e tij dallohen për një paraqitje idilike, symbyllur, sentimentalë, ëndërrues, besimtarë të një parajse, në kontrast me modernitetin.

Piktura e kokës si pjesa më e rëndësishme dhe më sublime e trupit të njeriut interpretohet edhe si energjia, si e ardhmja, si bukuria e konkretizuar, por herë-herë jeta duket sikur lëngon në një agoni të vazhdueshme me kokëprerje, me moskuptim të madh të njeriut me kohën. Ky aspekt i pikturës së Kaleshit mbase nuk është vënë në dukje sa duhet e megjithatë në substancë ai është një qëndrim ideoemocional i përhershëm, një temë themelore që përcakton objektivin e tij, pushtetin e kohësisë e të ngjyrës. Ka heshtje, ëndërrim, por edhe vuajtje, ndalje, aq sa në disa raste kokat shndërrohen në simbol të vdekjes, sidomos kur i dorëzohen fatit të futura në një shportë të varur.

Në shikim të parë duket si absolutisht e pamundshme për piktorin ta mishërojë trupin njerëzor, sepse në realitetin e përditshëm trupi i njeriut është jo rrallë i çmishëruar, i capërluar, i dërrmuar nga luftërat klasore, ekonomike, atomike, fetare apo terroriste. Kjo gjëmë e realitetit tonë hyn si jehonë e historisë, si frymë e ngjizur pavarësisht nga vetë piktori. Njeriu i sotëm është i gatuar së bashku me dhimbjen, sidomos nga aktet e shumta të terrorizmit. Ky motiv me një vështrim sado të shkurtër nëpër tablotë e tij do të na tregojë se çdo të thotë dhimbje dhe të duket sikur piktori i bën gjithkujt një thirrje të heshtur të ndalet për ta vështuar. Bota e dhimbjes ka relief të thellë e tronditës në tablotë e tij. Mes shumë të tjerave dy tablotë monumentale « Dramë ballkanike II» dhe « Dramë ballkanike III (1994) e reflektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë përmbajtje. Me perspektivën e saj të shkurtër, drejt, përpara syve tanë, duke ruajtur kontrastin që krijon në imagjinatë realja dhe syrrrealja, drama është pikturuar në kuptimin më të ngushtë të fjalës, domethënë lufta ka përherë viktimat e saj, por edhe në kuptimin universal : njeriu mbetet një gjah në duart e së Keqes.


Tablotë e Kaleshit në vështrim të parë mund t'i interpretosh si të papërfunduara, por ato fragmente trupash, të simbolizuar te koka, bartin ide të fuqishme. Fragmentares i kanë thurur lëvdatë shumë shkrimtarë dhe artistë në shekullin XX. Madje efektin e saj e kanë krahasuar me vetëtimën apo me zbulimin e papritur. Fragmenti te Kaleshi është një arsye e thellë e ekzistencës së pikturës së tij, një histori e plotë.

Omer Kaleshi është mjeshtër i pikturës fragmentare. Pavarësisht nga punët e ndryshme që bëri si student në shkollën e Arteve të Bukura në Stamboll, ai nuk u ndahet « kokave » duke dhënë tërë pozicionet e mundshme të shtrirjes së mendimit e të ëndrrave, qofshin ato të lumtura, qofshin ato të vrara. « Bariu i ri XI » (1990) i tij është një shprehje e funksionit natyror të njeriut, përjetim i botës reale në brendësi. Duke soditur me vëmendje punët me figurat e barinjve të rinj apo të dervishëve të çuditshëm të

titulluara « Dervishë dhe spektatorë » (1994), e ndien fuqinë meditative të kësaj pikturë, e cila është thujse si një spektakël madhështor i botës njerëzore. Fytyrat paraqesin tipare që të krijojnë herë përshtypjen e një ëndërrimi të fjetur e herë të një lëvizjeje të pandërprerë jetësore.

Personazhet « koka » përbëjnë tashmë repertorin më të rëndësishëm të pikturës omeriane. Kjo gjë, domethënë përqendrimi i psikologjisë pikturale te koka, vihej re edhe në pikturat dhe skulpturat e antikitetit Egjiptian, i cili e transformoi kokën në simbol me një domethënie epokale. Realizimet më të bukura të Kaleshit nënvizojnë dinjitetin e njeriut, shprehësinë e një fytyre, në një lëvizje poetike të brendshme, sikur t'i përkisnin një bote tjetër, të mbushur me një lloj nostalgjie që i lejon shikuesit të vëzhgojë diçka që gjithsesi mbetet e përjetshme : shpirti njerëzor i shqetësuar. Kjo njohje e brendshme, tregon edhe shtendosje nga rregullat e vendosura, një krijimtari e lirë që është shumë e rëndësishme për identitetin e tij të thellë si piktor. Prandaj, piktura e tij ka unicitet. Kokat vendosen përherë në plan të parë, në qendër të tablosë dhe thellësia e kompozimeve, arrihet me një thjeshtësi të mahnitshme, duke kombinuar ngjyrat. Në tablotë e quajtura thjesht « kokë » dallohet një punim « Kokë » (2002) që të kujton kokën e prerë të një shqiptari në Reçak në kohën e Luftës së Kosovës. Aty e kupton sesi rishpiket jeta në tërësinë e një kompozicioni pikturor, për t'u shfaqur paskëtaj plot sublimitet, me koka engjëjlore, gati për të vdekur, si koka madhështore, pa jetë e Gjon Pagëzorit në tabaka. « Kuptohet, kjo kërkon të zbulosh jo vetëm çfarë del nga këto tablo, por çfarë dëshmojnë ato për botën nga vijnë », shkruan Jacques Lacarrière, në parathënie e albumit të tij më të ri. Lacarrière, u njoh me pikturën e Omer Kaleshit në Unesco më 1990, kur piktori ekspozoi dhjetë piktura së bashku me disa piktorë turq.

Por, cili është Omer Kaleshi ? "Piktor ballkanas", - u përgjigjet ai qetësisht gazetarëve. Do të donim të thoshte : piktor shqiptar, por ai në atë përkatësi përfshin tri hapësira



dashurie : Maqedoninë, ai u lind dhe u rrit në Kërçovë; Shqipërinë që e ka vendin e të parëve, në dejtë e tij rrjedh gjak shqiptari dhe Turqinë, e cila e bëri piktor e ku jeton edhe familja e tij.

Për mua ishte diçka sugjestionuese, pothuaj një mister, që një piktor jeton dhe punon në Paris që në vitet e rinisë së tij, si të thuash është parizian më shumë se *de jure* dhe i mbush tablotë me figura burrash qeleshebardhë që e tresin vështrimin larg në humbëtitat e kohërave, me njerëz shpatullgjërë si të dalë nga legjenda e Mujit dhe Halilit. Misterin e shtonte edhe më tepër teknika e tij e veçantë që mund të quhet teknikë omeriane. Mendja më shkonte pastaj te Homeri i Iliadës, te Omeri i Ciklit të Kreshnikëve, te Omer Khayami dhe krijoja në imagjinatë një personazh të ri të kohërave moderne, Omer Kaleshin, piktor. Rasti fatlum e solli që ta takoja një ditë vjeshte të vitit 2010, kur isha në Paris për kontroll mjekësor.

Omeri tregon se i ka hyrë rrugës së pikturës në një mënyrë të çuditshme, aq sa e ritreguar sot, ajo ngjan me një fikcion. Ndodhi kështu : Një ditë që kthehej nga puna, - kishte rreth një vit që kishte filluar punë në Centralin Elektrik të Shkupit, - atij i tërhoqi vëmendjen një grumbull njerëzish para një muzeu. U afrua kureshtar dhe e mori vesh se ishte hapur një ekspozitë me vepra të skulptorit dhe vizatuesit anglez Henry Moor. E vizitoi ekspozitën dhe e pëlqeu. Madje e dashuroi aq fort atë lloj arti, sa në mënyrë misterioze që atë ditë në zemrën e tij u skalit një mendim i fuqishëm : do të bëhej piktor. Ishte viti 1955. Deri atë çast ai s'kishte pasur ndonjë lidhje me artet pamore. Ishte hera e parë.

Kështu ai nisi të punonte fshehurazi pikturë e skulpturë në allçi e të vizitonte ekspozita. Kur e pa njëherë i ati, e këshilloi që të pikturonte lule, sepse në Kuran paraqitja e figurave njerëzore quhet mëkat. Omeri iu përgjigj : « Edhe zoti vetë, piktor është, përderisa ka bërë Adamin nga balta ». I ati, një njeri i fesë e vazhdoi bisedën : « Por ai e ka bërë vetëm sa t'i frynte e t'i jepte shpirt ». Sigurisht Omeri i ri heshti, sepse ai s'mund të matej me të atin që lexonte arabisht dhe ishte njeri me kulturë të madhe. I ati i tij qe i pari në Kërçovë që i çoi fëmijët në shkollë.

Pas një viti familja e tij si e shumë shqiptarëve të tjerë të përndjekur nga Rankoviçi, u shpërngul në Turqi dhe u vendos në Stamboll. Për Omerin, sidoqoftë u hap rruga e artit. Ai mori pjesë në një konkurs pikturë, fitoi dhe u regjistrua në Akademinë e Arteve të Stambollit. Por në fillim nuk punonte dot në klasë, sepse ishte i druajtur dhe me shumë emocione. Druajta dhe emocionet lidheshin së pari me moshën, ai ishte pak më i madh se studentët e tjerë dhe së dyti me gjuhën që nuk e kuptonte mirë. Gati një vit ai mbeti fare i bllokuar, nuk zuri penel me dorë në klasë. Bënte piktura në shtëpi pa model, përmendësh.

Pas një viti kur kishte ecur mjaft me gjuhën dhe ishte çliruar disi nga kompleksi i moshës, si të gjithë studentët e tjerë ai mori detyrë të zgjidhte mjeshttrin dhe ngjyrën. Omeri zgjodhi piktorin *Franisco Goya* dhe si ngjyrë, *të kuqen*. Gjatë pushimeve të vitit të dytë erdhi në Europë dhe u njoh me pikturën perëndimore. Kur mbaroi vitin e tretë pati fatin të vizitonte Muzeun « Prado » në Madrid për të njohur nga afër punët e mjeshtrit të tij. Përse zgjodhi ai Francisko Goya-n si piktor është mister. Dhe pastaj ngjyrën e kuqe. Kjo është më e shpjegueshme: e kuqja është ngjyra e gjakut, e zemrës së dashuruar, e fljimit, e fitores. Kur i analizon në hollësi pikturat e tij mund t'i afroresh disi misterit.

Teknika e veçantë e punës së Omerit lidhet edhe kjo me një histori origjinale. Ai kaloi gati gjashtë muaj për të përfutur nuanca duke realizuar me dhjetëra kombinime gati magjike të së kuqes në gjithë spektrin e saj. Për të përzier ngjyrat i duhej një vegël e fortë; ishte e bukur, por e lodhshme të përfutoje qoftë edhe një ngjyrë të re. Dhe ai krijoi një spatul të veçantë

që u bë më vonë mjeti kryesor i punës për pikturën e tij të ardhshme, e që i jep Omer Kaleshit titullin e piktorit shpikës, i vetmi në Ballkan gjer më sot që përdor një teknikë të tillë. Madje as në Europë nuk njihet ndonjë rast tjetër i ngjashëm. Te rrëmbimi për ngjyrën e kuqe i ka rrënjët edhe talenti i tij i fshehur për shumë vite.

Për Omerin piktura është aq jetësore, sa tani ai e vë në dyshim nëse mund të merrej me tjetër gjë. Bota e parasë nuk e tërheq dhe çdo punë për të jetuar, ai do ta bënte aq artistike, sa do ta çonte larg konsumit të përditshëm.

Në Shqipëri për herë të parë Omeri ka ardhur më 1989. Ashtu si e pohon vetë, atë e zbuloi që ishte shqiptar, ambasadori i Shqipërisë së asaj kohe në Turqi, Nesip Kaçi e më pas e ftoi Ramiz Alia. Vizitoi disa qytete, sidomos Beratin që i pëlqeu shumë. Shqipëria iu duk e bukur dhe ai vlerëson së tepërmi faktin se ajo është vendi ku bashkëjetojnë të gjitha fetë në liri e paqe. Ai thotë se ka pasur një dëshirë të hershme të ekspozonte si shqiptar, pavarësisht se kjo u realizua më 2003.

*


Omeri u bë piktor në Stamboll. Nga kujtesa dhe zemra e tij nuk mund të fshihet kurrë Turqia, e cila e trajtoi si të ishte bir i asaj toke. Në Paris ai njihet si piktor turk. Ne si shqiptarë ndihemi pak « xhelozë » për këtë gjë, por realiteti nuk duhet të marrë fytyrën e pasionit. Për të shmangur këto keqkuptime, kur e pyesin për përkatësinë kombëtare ai ka filluar të përgjigjet në një mënyrë të re: Artist. Dhe nuk e fsheh se të vetmet lëvdata apo qortime që i pëlqejnë janë ato që lidhen me pikturën. Lufta e bën të vuajë. Mosmirënjohja e zemëron dhe e trondit.

Kur kërkon të mësosh se cili mbetet momenti më i bukur i jetës së tij, ai të përgjigjet se kjo ka ndodhur në Stamboll, kur u pranua në Akademinë e Arteve. Atje ai ka hapur disa ekspozita. Ekspozita ka hapur edhe në Shkup, në Beograd, në Prishtinë dhe në Tiranë.

Duke folur nga lartësia e viteve të piktorit, mund të thuash se Omer Kaleshi ia ka kushtuar jetën pikturës në kuptimin e plotë të fjalës. Ai ka sakrifikuar familjen që e la në Stamboll dhe familjen që s’e krijoi në Paris, vetëm e vetëm që të ruante në mënyrë sa më të kulluar dashurinë për pikturën. Ky është një shembull i njohur në historinë e artit duke filluar nga Fidias në Antikitet dhe deri te William Turner e të tjerë në kohët moderne.

●

Shtëpia e tij në Paris është një dhomë e madhe në katin e shtatë të një pallati, në bulevardin Arago, në lagjen 13, shtëpi dhe atelie bashkë, tërë dritë nga xhamat që zënë një faqe të tërë muri. Atje poshtë në *Place des Gobelins* atë ditë kur i bëra vizitë, hapej një peizazh vjeshtor, melankolik me një rrugë të qetë ku gjethonin ca gështenja të egra. Po t’i hidhje sytë më tej, dukej Sorbona dhe Panteoni. Në krahun e majtë çante qiellin Kulla Monparnas. Dhe tutje, larg në një hapësirë të madhe, nën rrezet e një dielli të ngrohtë për stinën, mund të shihje një pjesë të Parisit, me një bardhësi të dendur, kombinuar me grinë në blu të çatave të pallateve të ndërtuara një shekull, dy, madje disa edhe tre shekuj më parë; një qytet aq piktorik, sa të dukej vetja sikur ishte një personazh që kishe dalë nga



romanet baritore mesjetare. Kur gjendeshe brenda në studion e tij, pareti i xhamtë fillimisht ngjante si mirazh. Madje mbi tryezë na priste edhe rakia. Në telefon para se të niseshim, ai i tha Orionit, tim biri: “Ejani se kam raki Shqipërie !»

*

Omerin dhe shtëpinë e tij atelie nuk mund të mos i shihja pa emocione gjatë gjithë kohës që isha aty. Kjo s’më kishte ndodhur kurrë herë tjetër. Qëkur u nisa, vërtet mendoja për një të papritur, por të tjetërlojtë. Omeri kishte një jetë të tërë në Paris dhe unë mendoja për vulën e « llahtarshme » që duhej të kishte lënë ai qytet te shqiptari ynë. Një vulë që nuk më pëlqen sado që e dua Parisin. Por, Omeri hapi derën e na dha dorën, duke thënë « urdhëroni », thjesht e me ngrohtësi, shqiptarçe. « Ah, - pëshpërita në heshtje,- kjo është e pabesueshme, një ëndërr e shndërruar në realitet shqiptar aty për aty». Dhe isha në zemër të Parisit ! Në një metropol që gllabëron në mënyrë të pamëshirshme imtësitë. Megjithatë Omeri qëndronte i palëkundur me pikturën e tij plot imazhe pakohësie dhe shqiptarie njëkohësisht. Ligjërimi në gjuhën e bukur shqipe (çdo gjuhë kur është gjuha jote është e bukur), e cila i shuan të gjitha pengesat në komunikim, na bëri që të ndiheshim si të njohur të hershëm.

*

Piktori ynë ka flokë të bardhë që ia shtojnë fisnikërinë e fjalës, sy të qeshur, të zinj që e gjallërojnë kur flet, zë të butë që e bën të thjeshtë e të dashur. Ka mbetur shqiptar, i pastër, si ata heretikët e lashtë që i dënonin të ecnin duke mbajtur prush të gjallë ndër duar dhe kur arrinin te vendi i caktuar, i kishin duart të pacenuara. Aty çdo gjë ishte shqiptare : tymtar muzeal i formës tradicionale, me vatër të rrumbullakët, i ndërtuar nga vetë Omeri, me çengel dhe me një kusi dekorative si dhe elemente të tjera të vatrës së dikurshme si: këmbja, luga e gacave, mangall bronzi në sofër druri etj. Pastaj një fron me tri këmbë pranë vatrës e që ishte i familjes së tij, këtu e njëqind vjet të shkuara; tryezë e ulët druri si « tërvezat » e dikurshme ; mindere me shtrojë tipike, një pëlhurë e endur në tezgjah me vija dhe me motive të tjera gjeometrike. Në mur, në mjedisin e ndenjjes, ishin varur një ikonë e shën Sebastianit dhe një syret kurani i të atit ; hoja të punuara nga e motra (në familjen e tij kanë qenë dhjetë fëmijë, pesë vajza e pesë djem, Omeri ishte i shtati); një tufë çibukësh të punuar nga vetë ai e shumë objekte të tjera tipike. Mjedisi shqiptar vihej re në çdo hollësi të asaj shtëpie studio. Ai kishte krijuar një univers të vogël shqiptar. Një palë shkallë të brendshme të ngjisinin te këndi i fjetjes. Dhe gjithçka ishte punuar nga duart e tij. Madje edhe një dollap i vogël ushqimesh si ata të hershmit, me tre-katër raftë e dy kanate me xhama ishte vendosur në mjedisin e quajtur kuzhinë. Mbi tryezë rrinte edhe një kuti shahu.

Omeri ishte vërtet një mjeshtër ndërtimi e një mjeshtër i punës me dru. Por mjeshtëritë e dyta nuk mbaronin me kaq. Në murin përballë, midis paretit të madh me xhama që kishte një ndërprerje me hapësirë muri në mes, ishte vendosur një vepër elektrike. Them vepër se aty ishin me dhjetëra çelësa, priza, llamba që kur i vuri në punë u ndezën si një maket i një qyteti me arkitekturë dritash të shumëngjyrshme. Kjo dobësi flinte brenda tij në heshtje. Omeri ka mbaruar studime të mesme elektrike dhe aty ai kishte fiksuar një pjesë të atyre

dijeve si të nguroste një dashuri të humbur, së cilës nuk mund t’i përgjigjemi.

*

Atelieja e Omerit ishte e mbushur me tablo që i kishte paketuar për një ekspozitë dhe punët e reja të tij ne i pamë në një album të botuar rishmëzi. Te ai shihet edhe një lëvizje drejt figurës së plotë njerëzore. Duke pasur parasysh ato piktura që nuk lidhen me imazhet e tij, si *Trung*, seria *Peshqit* që i kërkoheshin kur ishte student si dhe një *nudo* à la Giacometi, pa e njohur ende skulpturën syrealiste, duket se Kaleshi është vazhdues brenda identitetit të tij të thellë si piktor. Ka njëllor aureole te ato fytyra që të druajtura e në heshtje rrëfejnë për një të kaluar, për një histori të përjetshme. E shkarkuar nga baroku, nga sajimi i së vërtetës, për të cilën nuk është nevoja, sepse ajo ekziston dhe duhet zbuluar, tabloja e tij ndonjëherë thotë se njeriu duhet të luftojë edhe kur ia kanë rrëmbyer dëshirën për të luftuar. Kjo shprehet sidomos në elementin karakteristik si pozicioni i ngurosur, që është mungesë lirie, të cilën personazhi përpiket ta fitojë, prandaj edhe karakteri i tyre jepet nëpërmjet shfaqjeve të dritës që triumfon mes errësirës. Ruskin-i thotë se edhe mrekullia më e përsosur nuk mund të ekzistojë pa u përzier me pak mjegull. Sepse arti i vërtetë ka anën e tij të panjohur, anën misterioze që duhet të na nxitë për ta njohur më shumë vetveten. Domethënia e jashtme e tablove të tij është simbolika e një brendësie ku ligjërimi ia ka lënë vendin heshtjes. Si çdo krijues këto histori ai i ka të gdhendura në identitetin e tij.

*

Pikturat e Omer Kaleshit janë përsiatje filozofike, për një univers të rikrijuar, të ri, të panjollë. Pika orientuese, ajo që udhëheq vështrimin tonë janë sytë, shikimi i tyre i fshehtë. Dhe ky është në radhë të parë një raport me rëndësi jetësore. Është një përpjekje për të zhbiruar unin. Te vetvetja është rifillimi dhe vazhdimësia e jetës. Ato koka mbushin zbrazëtinë dhe flasin me memecërinë e tyre për vuajtje dhe dashuri të pashprehura, për fjalë të pathëna, për druajtje, për lot, për ëndrra. Është një realitet që ngrihet përtej imagjinatës. Tej këtij realiteti, ekziston edhe një realitet mitik, të cilin piktura e tij përpiket ta japë me ngjyra të mbyllura që shprehin thellësi e trishtim.

Omer Kaleshi është vërtet një piktor i papërsëritshëm.

Paris-Tiranë, dhjetor 2011

Shënim:

Ky ribotim mori shkas nga një e-mail i datës 19 gusht 2021 që shkëmbeva me Z. Luan Rama në Paris, në të cilin e pyesja për shëndetin e Omerit; para disa kohësh, fillimisht qe lidhur im bir me telefon për të ditur diçka në situatën e re të krijuar nga COVID 19. Luani është njohës i thellë i pikturës dhe i personalitetit të Omer Kaleshit si dhe autor i një libri për të. Përveç kësaj, vitin e kaluar ai i ka shpëtuar jetën, si të thuash, nga që e shpuri menjëherë në spital se e gjeti midis jetës dhe vdekjes kur sapo i kishte rënë ishemi cerebral. Ndër të tjera Luani më shkruan: “Une jam ne Normandi dhe nesor kthehem ne Paris. Ne fakt te shtunen do te jem tek Omeri ta shoh. E pashe dhe para nje jave. Ka mbetur ne klinike qe nga ishemia cerebrale [...]. Te shtunen do te bej nje lidhje me video me familjen ne Turqi qe te komunikojne permes telefonit ... »

Në spital Omeri ka kaluar prova të tjera të vështira se u sëmur edhe me Covid. Para dy vjetësh e ca unë e takova vetë Kaleshin në panairin e librit të Ballkanit. I dashur dhe energjik si përherë. Shqiptar i rrallë, thashë me vete duke e përqafuar kur u ndava.

(Letërkëmbimi i panjohur i Faik bej Konicës 1897-1900. Vëll. I, përgatiti: Selver Islamaj, Botoi, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2020.

FILLIMI I NJË MIQËSIE TË GJATË NDËRMJET VJENËS DHE BOTUESIT TË REVISTËS “ALBANIA”

Nga Sylë Ukshini



Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe veçanërisht pas Lidhjes së Prizrenit, në kohën kur aktiviteti i shoqërive dhe klubeve shqiptare për pavarësi kombëtare, shtet e mëdha evropiane ndiqnin me interesim të madh ngjarjet politike në territoret shqiptare nën Perandorinë Osmane. Në radhë të parë, Austro-Hungaria dhe Italia, dy shtete rivale, bënë të gjitha përpjekjet politike dhe financiare për të çimentuar ndikimin e tyre mbi shqiptarët. Por, lëvizja kombëtare dhe kulturore shqiptare, për shkak të vështirësive dhe pengesave të shtetit osman, zhvillohej kryesisht jashtë atdheut, në qendrat e huaja dhe në disa raste mbështetej nga shtetet të cilat synonin të ruanin kontrollin mbi zhvillimet politike dhe kulturore në hapësirën shqiptare si dhe të ruanin interesat e tyre në Evropën Juglindore. Para së gjithash, Vjena dhe Roma po bënin përpjekje për rritjes e ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe në të njëjtën kohë këto dy shtetet po shndërrohen në rivale kryesore. Në këtë mes shtypi mbarte një vlerësim të veçantë në programin e veprimtarisë politike të Austro-Hungarisë në Shqipëri, përmes të cilit Vjena zyrtare synonte të ndikonte në mënyrë dinamike në formimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve dhe të mbante vulën e konsolidimit të lëvizjes shqiptare për liri, pavarësi kombëtare dhe për emancipim të përgjithshëm kulturor dhe politik. Për këtë qëllim, Ministria e Punëve të Jashtme Perandorake dhe Mbretërore e Austro-Hungarisë propozoi të realizohen botime të dizajnuara dhe të kontrolluara nga politika austro-hungareze, të cilat do të formonin ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve, të cilët shiheshin si aleat strategjik kundër tendencave pansllaviste në Ballkan. Qëllimi strategjik i Vjenës për të ndalur në mënyrë afatgjatë dhe përfundimisht çdo lloj zgjerimi sllav në kufirin jugperëndimor merret si arritje që shqiptarët të kthehen në një element strukturimi i të ardhmes së shtetit shqiptar. Sipas politikës austro-hungareze, e cila që nga Kongresi i Berlinit filloi ta kishte prioritet Shqipërinë, arritja e këtij qëllimi do të mund të realizohej përmes një procesi gradual, hapa pas hapi, respektivisht përmes hapjes së shkollave dhe përhapjes së shtypit dhe librave shqip. Sipas planit të aprovuar në konferencat e fshehta (1896) me qëllim të fillimit të një “aksioni” energjik austro-hungarez në Shqipëri, Vjena vendosi të përdorte shtypin për të arritur objektivat e saj politike. Ideja fillestare e shtetit austro-hungarez ishte themelimi i një organi shtypi shqip, si për shembull i një reviste të përmuajshme, por në ndërkohë u vu në kontakt me botuesin e revistës “Albania”, Faik Konicën, i cili gjithashtu kishte nevojë monetare për vazhdimin e botimit dhe të shpërndarjes së kësaj reviste. Për këtë qëllim Vjena mori informacionet e nevojshme për redaktorin e revistës “Albania”, që botohej në Bruksel dhe kontaktet i para i vendosi me të me ndërmjetësimin e kontit Khevenhüller, i cili ishte përfaqësues diplomatik i Austro-Hungarisë në Bruksel.

Faik Konica, edhe pse i lindur në Konicë të Janinës (1875), Turqia evropiane, me emrin e të cilit janë të emërtuara shumë institucione të vendit jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, mbetet një nga figurat më të njohura të kulturës dhe më me ndikim në kulturën shqiptare në fundshekullin XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XX. Kjo kujtesë historike për Konicën është e merituar, sepse me formimin dhe vokacionin e tij, ai u dëshmuua si një nga intelektualët më largpamës, si një evropian i madh dhe si një erudit shqiptar, i cili gjatë gjithë jetës së tij u angazhua për zgjimin e shpejtë të ndërgjegjes kombëtare dhe për krijimin e një Shqipërie të vërtetë evropiane. Faik Konica ishte nga të paktët intelektual shqiptarë që kishte një mendim dhe një plan të qartë për ndërtimin e një lidhje të ngushtë të lëvizjes kombëtare shqiptare me Austro-Hungarinë, të cilën në konstelacionin e atëhershëm e shihte si të vetmen fuqi evropiane me të cilët shqiptarët do të mund të ndërtonin një aleancë strategjike dhe me afatgjatë kundër synimeve pansllaviste ruse në Ballkan, përkatësisht kundër idesë së krijimit të Serbisë se Madhe në llogari te territoreve etnike shqiptare. Si rezultat i sfondit të larmishëm arsimor, shkollën fillore në Konicë, kolegjin frëng në Shkodër, shkollën e mesme në Stamboll, dhe më pas studimet në Francë, përkatësisht në Harward të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai ishte i rrjedhshëm në gjuhën shqipe, turke, italiane, frënge, gjermane dhe angleze. Qysh gjatë kohës së studimeve në Francë, Konica filloi të interesohet për gjuhën amtare, letërsinë dhe historinë e vendit të tij, dhe të shkruante artikuj mbi Shqipërinë në shtypin francez.

Në vitin 1897, në moshën 22 vjeçare u transferua në Bruksel, ku me ndihmën financiare të Austro-Hungarisë filloi botimin në gjuhën shqipe dhe frënge të revistës “Albania”, e cila shpejt u bë një nga revistat më të njohura shqiptare në mërgim. dhe të rëndësishme në ndërgjegjësimin e kombit shqiptar dhe në artikullimin e kërkesave të shqiptarëve në atë periudhë. Pa dyshim Konicës i njihet merita e madhe për të shkruarit në një shqipe me një stil të lartë diplomatik. Ideali i tij ishte pavarësia e Shqipërisë, por ai ishte i vetëdijshëm se kjo nuk ishte e mundur në periudhë afatshkurtër për shkak të disa faktorëve gjeopolitike, ndaj dhe për këtë arsye ai kërkonte mbështetjen e një fuqi evropiane, respektivisht të Austro-Hungarisë. Edhe pse pas vitit 1902 Konica u zhvendos në Londër, revista vazhdoi botimin e saj deri ë 1909 dhe nuk ndryshoi karakterin e saj dhe programin politik. Ndërsa pas largimit në Amerikë, ai u bë redaktor i gazetës “Dielli”, e cila

ishte themeluar nga Fan Noli. Ai ishte edhe kryetar i federatës “Vatra” në Boston dhe në emër të saj shkoi në Londër me 1912 për të mbrojtur interesat e Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve, e cila do të përcaktonte të ardhmen e Shqipërisë dhe të vendeve tjera të Ballkanit. Edhe pse ishte kundërshtar i mbretit Ahmet Zog, në verë të vitit 1926 ai u emërua ambasador i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara, post të cilin e mbajti deri në pushtimin italian të Shqipërisë 1939.

Faik Konica ka njohur shumë krijues të shquar dhe ka komunikuar me personalitete të shumta të kohës. Në të njëjtën kohë, letërkëmbimi i tij ka qenë shumë intensiv dhe i pasur. Ai u ka dërguar letrë dhe materiale të ndryshme shkrimtarëve, artistëve, gazetarëve, diplomatëve, shkencëtarëve, lider shteteve dhe figurave të njohura të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Për këtë arsye, materiali burimor i arkivor për Faik Konicën është jashtëzakonisht i gjerë dhe i shpërndarë nëpër vende të ndryshme, në Shqipëri, në Turqi, Francë, Belgjikë, Britani të Madhe dhe SHBA. Ky gjeografi e gjerë e rrugëtimit dhe e aktivitetit politik dhe kulturor i Faik Konicës gjatë shekullit 19 dhe 20 ka tërhequr interesimin e madh të studiuesve të shumtë, të cilët kanë ndriçuar aspekte të ndryshme të jetës dhe veprimtarisë të këtij personaliteti të shquar të letërsisë dhe kulturës shqiptare dhe njëres nga figurat qendrore të epokës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Megjithatë deri më sot janë shkruar libra dhe studime të shumta për Konicën, edhe më tej vazhdojnë të dalin në dritë dokumente dhe artikuj të kohës dhe shkrime të tjera të autorit, të cilat janë të rëndësishme për jetën dhe krijimtarinë e përgjithshme të Konicës, si edhe për aspektet të tjera të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Hulumtimi dhe studimi sistematik i të dhënave është pra baza për një ndërmarrje të tillë, e cila do të hidhte dritë të plotë edhe mbi angazhimin kulturor dhe politik të Faik Konicës, për lidhjet e tij me politikan dhe personalitete të ndryshme shqiptare (Naimi dhe Sami Frashëri, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, familja Qiriazi në Manastir etj.) nga fusha e kulturës dhe e diplomacisë.

Për ndriçimin e aspekteve të ndryshme të jetës dhe të krijimtarisë së Konicës, është e rëndësishme vazhdimi i punës hulumtuese shkencore nëpër arkivat evropiane dhe amerikane, në të cilat supozohet se mund të ketë dorëshkrime dhe materiale të tjera të rëndësishme. Së fundi, historiani i ri shqiptar nga Kosova, Selver Islamaj - doktorant në Universitetin e Vjenës (Austri), i cili prej vitesh hulumton në arkivat austriake dhe ka qasje të vazhdueshme në Aktivin Shtetëror të Austrisë (Haus-Hof und Staatsarchiv), ka gjetur material të vëllimshëm dhe shumë të rëndësishëm e të panjohur më parë lidhur me letërkëmbimin intensiv të Faik Konicës me zyrtarë dhe diplomatë të Austro-Hungarisë dhe me personalitete të botës shqiptare. Këto materiale të botuesit të revistës “Albania” Faik Konicës, monumentit të publicistikës shqiptare, janë sistemuar dhe botuar në dy vëllime: “*Letërkëmbimi i panjohur i Faik bej Konicës 1897-1900*”, Vëll. I dhe “*Letërkëmbimi i panjohur i Faik bej Konicës 1901-1912*”. Vëll. II, të cilat janë botuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Veprimtaria e Faik Konicës në Bruksel, Londër dhe në SHBA zë vend të rëndësishëm në kulturën, letërsinë dhe në publicistikën e kohës. Vlerësojmë se me publikimin e këtyre dokumenteve arkivore të dosjes së veçantë të Arkivit Shtetëror të Vjenës, ndriçohen më mirë disa aspekte të jetë dhe të veprimtarisë letrare, politike dhe diplomatike të Faik Konicës dhe problemet e vështirësive e botimit të revistës “Albania”.

Vëllimi i parë “*Letërkëmbimi i panjohur i Faik bej Konicës 1897-1900*”, përveç origjinalit të transkriptuar, i paraqet për herë të parë lexuesit shqiptar një përmbledhje kronologjike të letërkëmbimit të Faik Bej Konicës me Baron von Zwiëdinek, i cili drejtonte Departamentin e Shqipërisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, si dhe ofron të dhëna interesante dhe deri tash të panjohura, lidhur me kushtet në të cilat u botua “Albania”, njëra prej revistave më të njohura të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ky letërkëmbim i përket një periudhe vendimtare të historisë shqiptare, vetëm pak vite pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare, e cila për shkak të mungesës së përkrahjes së fuqive evropiane nuk arriti të jetësonte kërkesën e saj për një shtet shqiptar autonom, në të cilën Konica është një protagonist i rëndësishëm dhe një intelektual erudit, që ka një projektion të qartë për të ardhmen e popullit shqiptar. Dokumentacioni i botuar këtu ka vlera të rëndësishme historiografike, sepse letërkëmbimi i Faik Konicës ofron informacione jashtëzakonisht të vlefshme, jo vetëm për sfidat me të cilat do të përballlet Konica për botimin e gazetës “Albania”, por edhe për ndikimin që kishte politika zyrtare austro-hungareze në profilin e saj kryesisht letrar. Në fakt, ky bashkëpunimi mes Konicës dhe zyrtarëve të Vjenës ndodhi, jo vetëm pas rekomandimeve të kontit Khevenhüller, por edhe pas këshillës së Theodor Ippenit, i cili i sugjeroi Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë se do të ishte më e përshtatshme të vendosej bashkëpunimi me gazetës ekzistuese “Albania” të Brukselit, në mënyrë që të shmangej rreziku i dështimit duke provuar që të përzgjidhej një gazetë në gjuhën shqipe. Dhe në të njëjtën kohë, edhe Ippen përfaqësonte mendimin se redaktori i kësaj gazetës duhej të bënte disa ndryshime jo të vogla, duke shmangur gjithashtu edhe kritikën ndaj sovranitetit të shtetit osman.

Në këtë komunikim dalin po ashtu në pah edhe dallimet e Konicës me Baron von Zwiëdinek lidhur përmbajtjen e gazetës “Albania”,

e cila nuk do të mund të publikohej pa mbështetjen financiare të Vjenës zyrtare dhe për këtë ajo kujdeset që gazeta të mos përmbajte artikuj politikë, por të mbante kryesisht profil letrar dhe që të mbronte “fuqimisht interesat kulturore të kombit” si dhe këshillohej që “Albania” përmbahej nga gjuha austro-file dhe njëkohësisht të “mbështetej në faktin se ajo do të mbronte vetëm interesat thjeshtë dhe veçanërisht shqiptare”. Në komunikimet e para në gusht të vitit 1897 me botuesin e gazetës, i njohur me pseudonimin Trank Spiro Bej, Vjena përcaktoi orientimet e saj si dhe njoftoi kontin Khevenhüller, se Konica do të ishte përfaqësues më i ri i propagandës shqiptare, pasi vlerësohej veprimtaria e tij. Bëhet fjalë për një lëvizje që lidhet me të ardhmen e krahinave në kufi me Austro-Hungarinë, të cilat meritonin interes maksimal dhe rekomandohej që përmes njohjes së interesave të Trank Spiro Beut dhe grupit të tij, të plotësohet informacioni që ishte grumbulluar deri në atë kohë lidhur me temat shqiptare. Në anën tjetër, Konica, i cili kishte studiuar në Universitetin Tuluzë në Lion të Francës, dëshironte që revistën e tij ta përdoret për të propaganduar autonominë e Shqipërisë nën protektoratin e Austro-Hungarisë.

Megjithatë zyrtarët austro-hungarezë Konicën e konsideronin fanatik në bindjen e tij, ata pas takimit dhe bisedave konfidencial në Ballhausplatz, pranuan subvencionimin e revistë së Konicës, por sipas disa kushteve: së pari, gazeta nuk duhej të shërbente si organ që bënë thirrje për një lëvizje kryengritje kundër qeverisë osman. Së dyti, aktiviteti botues të fokusohet mbi të gjitha në zgjimin e kuptimit të interesave të përbashkëta kombëtare. Së treti, artikujt të botoheshin në dy dialekte shqipe si dhe në frëngjisht, me qëllim që të lexoheshin në gjithë hapësirën shqiptare, nga jugu në veri. Së katërti, botuesi i gazetës duhej të merrte përsipër të botonte artikuj dhe lajme të cilat Vjena dëshironte t'i transmetonte të shqiptarët përmes revistës “Albania”. Por, për të arritur objektivin e fundit, konsujt austro-hungarezë në Shqipëri u këshilluan që revista të mos komentonte aq shumë Austro-Hungarinë, në mënyrë që të qetësohej qeveria osmane dhe të shuhej bindja e përhapur mes lexuesve se kjo revistë ishte e blerë nga Vjena dhe se i shërbente interesave të saj.

Megjithatë këto nuk ishin kushte të lehta, Konica ishte i detyruar të pranonte këtë pozicion të Vjenës, sepse pa mbështetjen e drejtpërdrejt financiare të Austro-Hungarisë dhe konsullatave të saj në hapësirën shqiptare do të ishte e pamundur që revista “Albania” të botohej dhe të depëronte në të gjitha territoret shqiptare nga veriu në jug, për shkak të vështirësive të krijuara nga autoritetet osmane. “Për Shqipërinë Veri-Lindore, ne do të përpiqemi të hyjmë në marrëdhënie me shqiptarët e Vrajës në kufirin serb, të cilët do të kenë mundësi të dërgojnë me lehtësi pako të revistave në Gjakovë, Prizren etj.”, i shkruante Konica në komunikim me Vjenën (Vëll. I, f. 100).

Ky letërkëmbim, që ndjek rrjedhën kronologjike të kohës, pos që shënon fillimin e një miqësie të gjatë ndërmjet Vjenës dhe botuesit të revistës “Albania”, njëkohësisht mund të cilësohet si nismëtar i diplomacisë shqiptare për nivelin dhe kulturën e tij të lartë diplomatike. Këto dy vëllime të përgatitura nga Islamaj hedhin dritë mbi një periudhë të gjerë të angazhimit të shumanshëm të Konicës për formimin e ndjenjës kombëtare në një terren heterogjen shqiptar dhe të sunduar nga administrata e shtetit osman, e cila me këmbëngulje e luftonte emancipimin kombëtar shqiptar, duke ndaluar hapjen e shkollave dhe publikimin e shtypit dhe librave shqip. Po ashtu, ky letërkëmbim shpalosë tërë dinamikën e bashkëpunimit të botuesit të revistës “Albania” me Ballhausplatz-in në Vjenë, që ai e shihte si orientim strategjik për realizimin e qëllimit të krijimit të shtetit shqiptar, si dhe dokumentohet programi shqiptar që Vjena mori përsipër për të arritur objektivat e saj politike. Në këtë kuptim, ai që nga fillimi kishte hyrë në shërbim të Austro-Hungarisë dhe revistën e kishte bërë përçues të politikës së saj. Korrespondenca e tij me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë qet në sheh edhe të dhëna të cilat flasin në mënyrë të bindëse për pozicionin e Vjenës zyrtare ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare dhe Perandorisë Osmane dhe në këtë kontekst edhe ndaj synimeve serbe për ekspansion territorial në drejtim të territoreve shqiptare. Nga ky letërkëmbim lexuesi ka mundësi të fitojë një pasqyrë të përgjithshme për zhvillimet brenda hapësirën shqiptare nën administratën perandorake osmane si dhe për gjendjen politike brenda kësaj perandorie si dhe për caqet e aksionit politik austro-hungarez.

Në përgjithësi, letërkëmbimi i Konicës me diplomatët e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, ndriçojnë momente dhe aspekte të rëndësishme të përpjekjeve shqiptare për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar si dhe vë në pah rolin dhe pozicionin e diplomacisë austro-hungareze për zgjidhjen hap pas hapi të çështjes shqiptare, të cilën e shihet si barrierë të zgjerimit territorial serb drejt Ballkanit jugor dhe përpjekjeve pansllaviste për daljen në Detin Adriatik. Po ashtu, del në pah se Vjena zyrtare distancohej nga çdo lëvizje kryengritëse e armatosur shqiptare, që nuk ishte e frymëzuar nga ajo, nga frika se një lëvizje e pa planifikuar mirë do të mund të shfrytëzohej nga shtetet fqinje dhe nga vetë shteti osman. Në të njëjtën kohë, zyrtarët e Vjenës potenconin dëshirën e Austro-Hungarisë që kombi shqiptar të jetë i fortë dhe i bashkuar, në mënyrë që të mund të ruajë rangun e

tij në mesin e popujve të tjerë të gadishullit ballkanik dhe të mbrojtë pozicionin e tij në brigjet e Detit Adriatik kundër gjithë tendencave ekspansioniste të shteteve fqinje sllavë. Në këtë kontekst, del në pah politika represive e Perandorisë Osmane ndaj shqiptarëve, e cila derisa me zemërgjerësi lejonte hapjen e shkollave greke dhe serbe në hapësirën shqiptare, ndaj kultivimit të gjuhës, librit dhe shkollave shqipe mbante një qëndrim tejet armiqësor. Ky qëndrim represiv i shtetit osman duke qartë se ka dy premisa: e para, pengimin e çfarëdo përpjekje për ndërgjegjësimin kombëtar të shqiptarëve dhe vazhdimin e trajtimit të tyre në kuadrin e milletit osman vetëm si popullatë myslimane. Dhe e dyta, qëllimi për ruajtjen e status quo-së në hapësirën ballkanike, duke penguar me çdo mjet çdo tendencë për krijimin e një shteti autonom apo të pavarur shqiptar.

Në këtë linjë, korrespondenca e Konicës me zyrtarët e Vjenës ofron detaje të rëndësishme edhe për rivalitetin ndërmjet italianëve dhe austro-hungarezëve për shtrirjen e ndikimit të tyre në Shqipëri. Dokumentet e proveniencës austro-hungareze në formë bindëse konfirmojnë se Faik Bej Konica tregohej mjaft i kënaqur me angazhimin dhe pozicionin e Austro-Hungarisë karshi çështjes shqiptare dhe njëkohësisht ai na shfaqet një kundërshtar i madh edhe tendencave të Italisë për zgjerimin i propagandës së saj në Shqipëri, e që natyrshëm se pëlqehet mjaft nga bashkëbiseduesit e tij në Vjenë. Në këtë pikë na shfaqet konkurrenca ndërmjet dy shteteve evropiane, të cilat vazhdonin garën për kontrollimin e bregut lindor të Adriatikut dhe në këtë kontekst figura të rëndësishme si Konica ishin me rëndësi si për Romën ashtu edhe për Vjenën, por beu shqiptar në përpjekjet e tij për të ardhmen e vendit të tij, e quante detyrë patriotike të punonte kundër tendencave italiane.

Në anën tjetër, del në pah po ashtu synimi i Vjenës zyrtare për ndërgjegjësimin kombëtar dhe kulturor shqiptar, me qëllim që në një fazë të caktuar, kur do të bëhej e pashmangshme ruajtja e pjesës evropiane të shtetit osman, të mbështetej ideja për krijimin e një shteti autonom shqiptar, i cili do t'i shërbente edhe austro-hungarezëve si një barrierë ndaj ekspansionit territorial serb dhe kundërpeshë të ndikimit rus në Ballkan. Në këtë kuadër, shqiptarët dhe Shqipëria shikoheshin si një faktor i rëndësishëm në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Ky orientim i Austro-Hungarisë, si duket edhe nga përmbajtja e letrave të Konicës dhe të Baron von Zwiedinek, konsistonte për një veprim të matur e të koordinuar të shqiptarëve, duke shmangur veprimet e parakohshme nga të cilat do të mund të përfitonte ndonjë shtet tjetër ballkanik apo evropian dhe që do të mund të dëmtonte relacionet ndërmjet Vjenës dhe Stambollit. Nga kjo korrespondencë arrijmë të kuptojmë se Konica pajtohej me rekomandimin e Vjenës se mjeti kryesor për realizimin e objektivave kombëtare, duhej të bëhej bashkimi i të gjitha forcave rreth një qendre për të mundësuar një aksion të përbashkët.

Korrespondenca e Konicës me Vjenën zyrtare nxjerr në pah gjithashtu problemet dhe dallimet konceptuale që ekzistonin ndërmjet personaliteteve të botës shqiptare, shkrimtarë, studiues gazetarë dhe politikanë, të cilat shpesh përbejnë një shqetësim edhe për Vjenën zyrtare, e cila ishte e interesuar fort për ndërtimin e një kohezioni brenda elitës intelektuale dhe politike shqiptare të kohës. Në këtë kuadër, me shumë interes janë informacionet për angazhimin e patriotëve shqiptar brenda hapësirës shqiptare, në diasporë dhe në Konstandinopojë për hapjen e shkollave shqipe dhe për përhapjen e shtypit dhe librave shqip, të cilat ishin të ndaluar nga autoritetet e shtetit perandorak osman. Në këtë korrespondencë na shfaqen emra të rëndësishëm të elitës politike shqiptare, por edhe të zyrtarëve austro-hungarezë, të cilët ishin të përfshirë në zhvillimet e kohës për dhe rreth çështjes shqiptare.

Në këtë linjë, Konica besonte se puna e tij me revistën “Albania” do të mund të jepte rezultate në dy drejtime: letrar dhe politik. Në drejtim letrar synohej frymëzimi i shumicës së popullit shqiptar për ngritjen e kërkesës për unifikimin e gjuhës shqipe. Dhe në drejtimin politik, duke ushtruar ndikimin tek drejtuesit e lëvizjes kombëtare shqiptare, duke krijuar një rrymë të fuqishme kundër helenizmit dhe kundër përpjekjeve për centralizim nga osmanët. Përballë propagandës italiane për bashkimin e Shqipërisë me Italinë, Konica mendonte nëse nuk do të ishte e mundshme një autonomi politike e shqiptarëve brenda shtetit osman, atëherë do të ishte e dëshirueshme një administratë autonome në kuadrin e Austro-Hungarinë, pasi në këtë mënyrë mendonte se shqiptarët do të zhvilloheshin më shpejt nga pikëpamja kombëtare, ekonomike dhe intelektual. Në këtë kontekst, është interesant dhe përmendet një komunikim mes Konicës dhe Naim Frashërit, lidhur me ndikimin austro-hungarez në Shqipëri dhe për propagandat e huaja kundër ndikimit. Tre vjet më parë, Naim Bej Frashëri më shkroi “Ajo që më së lumturi mund të ndodhë për kombësinë shqiptare është një aneksim i Shqipërisë në Austri, por i Shqipërisë në tërësi”, i shkruan Konica Baron von Zwiedinek, duke shtuar se njëjtë si Frashëri mendojnë shumë personalitete tjera shqiptare dhe kjo ndjejnë austrofile e kishte ngushtuar mundësinë për propagandë të vendeve tjera.

Nga korrespondenca ndërmjet Konicës dhe zyrtarëve të Vjenës, që në shumë aspekte ishte e karakterit të lartë diplomatike, mësojmë edhe për ndalesën e Ismail Qemailit në Bruksel gjatë rrugës së tij për në Londër. Për këtë ndalesë dhe takimin e tij me Ismail Qemailin, të cilin sa e vlerëson të sjellshëm dhe inteligjent, ai e informon në detaje Vjenën zyrtare. Megjithëse ai na lë të kuptojmë se e kishte mirëpritur qëllimin e Ismail Qemalit që të përfshihej në mënyrë aktive në lëvizjen shqiptare, Konica vinte në pah se ishte e vështirë të depërtoje në synimet e tij të vërteta. Në fakt, Osmail Qemaili ishte një politikan me eksperiencë, i cili për katër dhjetë vite kishte punuar në administratën e qeverisë osmane, dhe i kuptonte mirë maniret e pushtetit. . “Ismail Beu miraton plotësisht programin e Partisë Kombëtare Shqiptare, që të merret për momentin vetëm me propagandë gjuhësore, të kërkojë shkolla dhe të kufizohet në pikat tjera për të kërkuar një riorganizim të plotë të kushteve ekonomike të vendit”, i shkruan Konica në letërën dërguar Baron von Zwiedinek. (f. 500). Por, shumë shpejt me këtyre dy personaliteteve të njohura shqiptare lindën mosmarrëveshje, për shkak të dallimeve në pikëpamje, si dhe, siç pohon Konica, për shkak të lidhjeve të Ismail Qemailit me njerëz të pallatit mbretëror të Sulltanit dhe princin Nikolla të Greqisë, si dhe për shkak të dallimeve për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Nga dokumentet e botuara këtu është evident se për dallim nga Konica, Ismail Qemaili dëshironte të mbante një qëndrim më fleksibil dhe pragmatik ndaj italianëve,

grekëve dhe vende të tjera dhe për rezervat që shfaqet ai ndaj politikës austro-hungareze në Ballkan.

Lartësia dhe pragmatizmi i Konicës lidhur me planet e tij të shpërfaqur dhe në një letër dërguar në adresë të Baron von Zwiedinek në nëntor 1897, ku ai thekson se shqetësimet e tij duhet konsideruar nga një këndvështrim i trefishtë: e para, zhvillimi i ndjenjës kombëtare shqiptare me qëllim që t'i të bëjë gjithë shqiptarët plotësisht të vetëdijshëm për ndryshimet e tyre radikale me turqit. E dyta, që revista e botuar në toskërisht e në gegërisht dhe në frëngjisht do të duhej të publikonte kronika, histori, poezi patriotike, këngë popullore, çështje ekonomike, shënime politike në formë artikujsh-lajmesh, në mënyrë që të mos zgjonte mosbesimin e Portës. Në këtë kuadër, si instrument të nevojshëm për realizimin e objektivave politike, Konica e shihte themelimin e një shoqërie të përgjithshme (“Rilindja shqiptare”), e cila do të mund të kontribuonte në vendosjen e marrëdhënieve të rregullta dhe të vazhdueshme me të gjithë shqiptarët që mund të ushtronin ndonjë ndikim në drejtimin e duhur tek autoritetet e shtetit osman për lejimin e hapjes së shkollave në gjuhën shqipe në Shqipëri. E treta, si pengesë serioze që lipsej tejkaluar ishte mosbesim tradicional dhe në rritje i Portës së Lartë ndaj çdo organizimi politik të shqiptarëve, duke këshilluar se duhej ndjekur “një politikë e zgjuar, që të besojnë se është lëvizje paqësore, thjesht intelektuale dhe pa qëllime politike. (Vëll. I. f. 38-40).

Siç përmendëm më lartë, në këto korrespondenca edhe aktivitetet e personaliteteve tjera të botës shqiptare, siç ishte edhe rasti i Sami Bej Frashërit, i cili së bashku me vëllanë e tij Naimin kishin shkruar dhe botuar një mori librash në gjuhën shqipe dhe nga autoritetet osmane shihej si udhëheqës i lëvizjes shqiptare. Në letërën e dt. 1 janar 1898, Konica e vinte në dijeni Baron von Zwiedinek se Sami Frashëri ishte thirrur dhe pyetur në Yildis-Kiosk (rezidenca e Sulltanit) nga Sekretari i Përgjithshëm i Sulltanit lidhur me librat shqip të botuara në Bukuresht dhe të nënshkruara me inicialet N.H.F. Megjithëse Samiu e kishte mohuar se qëndronte prapa këtyre librave, ai do të deklaronte se “nëse shqiptarët kërkonin shkolla, mund të jetë vetë për të ndaluar progresin e sllavizmit dhe helenizmit”. Por, meqë Konica nuk kishte besim se autoritetet osmane do të lejonin edhe më tej hapjen e shkollave shqipe, ai angazhohej të krijohej një klimë e favorshme në mesin e shqiptarëve për shkollat shqipe, në mënyrë që ato të hapeshin me pëlqimin e fisnikëve dhe parisë të vendit. Në të njëjtën kohë, Konica përpqej të shfrytëzonte edhe lidhjet e tij brenda pallatit perandorak të Sulltanit, siç ishte rasti i Tahir Pashës, kreut të Gardës Perandorake Shqiptare, i cili gëzonte besimin e Sulltanit, për ta bindur personalisht Sulltanin që të autorizonte hapjen e shkollave shqipe. Njëkohësisht me çështjen e shkollave dhe publikimin e revistave dhe librave, si instrument absolut të nevojshëm për ndërtimin e kohezionit ndërmjet toskëve dhe gegëve e shihte vendosjen e një alfabetit përfundimtar shqip, sepse në mungesë të një alfabeti unik do të bëhej e pavlefshme çdo propagandë për mësimin e gjuhës kombëtare dhe shtypja e librave në një numër më të madh (f. 132). Në të njëjtën kohë, Vjena zyrtare e inkurajonte Konicën për patriotizmin e tij dhe zellin vetëmohues për emancipimin e popullit shqiptar dhe në këtë kontekst i shprehte keqardhjen për qëndrimin e Madhërisë (Sulltanit) jo favorizues “për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe për rrjedhojë” që revista “Albania” nuk mund të hynte lirshëm në territorin e Perandorisë Osmane (f. 388). Sidoqoftë ndikimi i revistës “Albania” brenda dy viteve kishte dhënë rezultate dhe për këtë Konica plotë entuziazëm i shkruante Baron von Zwiedinek se në mesin e shqiptarëve librat dhe gazetat shqiptare lexohen nga dora në dorë, edhe pse marrësi i revistës vazhdimisht kërcënohej me burg nga autoritetet osmane.

Në këtë kohë, çështja e përpilimit të alfabetit të gjuhës shqipe dje problemi i gjuhës letrare ishin një preokupim i vazhdueshëm i botuesit të revistës “Albania”, të cilën Konica e konsideronte si armë të fuqishme në luftën për pavarësi dhe emancipim të përgjithshëm kombëtar. Në këtë kuadër, Konica i propozonte Vjenës idenë e organizimit të një kongresi të albanologëve për ta diskutuar çështjen e alfabetit shqip. Siç mësohet nga një letër përgjigje e Baron von Zwiedinek, e dt. 8

qershor 1898, mësohet se Vjena e konsideronte “shumë të vështirë idenë e mbledhjes së një kongresi të albanologëve”, ndërsa e quante të parakohshme të diskutohej publikisht çështja e alfabetit dhe i kërkohej Konicës që të përdorej alfabeti që i përdoret për shtypjen e revistës “Albania” dhe që në ndërkohë të punohej për dallimet që ekzistonin brenda elitës intelektuale shqiptare. Jo vetëm në këtë çështje, por Vjena zyrtare e këshillonte Konicën dhe udhëheqës të tjerë shqiptarë se në “përpjekjet për të përmirësuar gjendjen e shqiptarëve në Perandorinë Osmane nuk duhet të marrin kurrë karakter revolucionar dhe të dhunshëm. Njëkohësisht me këtë, nga ky letërkëmbim del qartë se Vjena në mënyrë të vazhdueshme, pavarësisht çfarë raportonte Konica, tregonte kujdes të madh lidhur me pritjet e revistës në zonën e aksionit të Austro-Hungarisë. Në këtë linjë, konsujve të saj u jepeshin orientime që të informonin për çdo gjë që ndodhë, cili ishte reagimi i lexuesit shqiptar ndaj revistës nga Brukseli si dhe të evidentojë çdo reagim negativ lidhur me përmbajtjen e revistës. Në këtë kuadër, Vjena e kishte marrë me shqetësim edhe një informacion nga Prizreni të konsullit austro-hungarez Rappaport, i cili, në përgjigje të kërkesës për informacione nga qendra, shkruante se revista “Albania” ishte krejtësisht e panjohur në zonën e tij konsullore dhe se vetëm një person kishte dijeni për revistën. Njëherësh del në pah se edhe popullata shqiptare myslimane e kësaj treve nuk tregonte edhe aq shumë dëshirë për të kultivuar e zhvilluar gjuhën shqipe, për shkak të fanatizmit fetar dhe prapambetjes së gjatë ekonomike si dhe mungesës së elitës intelektuale.

Por, pavarësisht kësaj situatë zhgënjyese, ky konsull vlerëson se duhet të vazhdohet të punohet për zgjimin e ndjenjës kombëtare në mesin e shqiptarëve, pasi kjo do t'u jepte në të ardhmen një themel të qëndrueshëm dhe rezistencë për superioritet. Rappaport, i cili prej pesë vitesh po punonte për zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqipe, mendonte po ashtu se pjesa më e madhe e shqiptarëve në Vilajetin e Kosovës do të sllavizohen ose turqizohen me kalimin e kohë, nëse nuk kërkojnë zhvillimin tregtar dhe kulturor.

Sipas kësaj korrespondence intensive mësojmë qartë se redaktori i revistës “Albania” si pengesë serioze, për përballje me një ndërmarrje të tillë, e konsideronte mosbesimin e thellë të trashëguar prej vitesh dhe në rritje ndaj qeverisë osmane. Në optikën e rekomandimeve të Vjenës, Beu shqiptar provon t'i shmanget kritikave të ashpër përkundrejt qeverisë osmane me qëllim që përmes një politike të zhdërvjellët të krijohej përshtypja se bëhej fjalë për një lëvizje paqësore dhe intelektuale e pa objektiv politike. Redaktori i revistës “Albania” tregohet i kujdesshëm ndaj sugjerimeve të Vjenës, dhe ku ndonjëherë rastësisht i shpëton ndonjë detaj që e shqetësonte Vjenën, tregohej i gatshëm ta korrigjonte, gjë pëlqehet nga subvencionuesi i tij në Vjenë. Por, meqenëse Vjena ishte e interesuar që të mos bëheshin të njohura marrëdhëniet e saj me revistën “Albania”, me qëllim që të mos rrezikohet suksesi i revistës përballë lexuesve të shumtë.

Një pengesë tjetër të rëndësishme Konica i shihte propagandat e shteteve të ndryshme, si dhe vetë komunitetin shqiptar jashtë, si në Itali dhe në Bukuresht, të cilët punonin për interesa të qeverive të ndryshme. Konica në bashkëbisedimet me Baron von Zwiedinek nënvizon se i gjithë aksioni duhet të dominohet nga nevoja e bashkimit të të gjithë shqiptarëve rreth të njëjtit objektiv dhe se të gjitha energjitë duhej drejtuar për hapjen e shkollave shqipe, të botimit dhe të shpërndarjes së revistave dhe librave shqip. Por, pikërisht problemi i shkollave kombëtare, një çështje tjetër ku përpqiej të bënin diversion vendet fqinje sllave të përkrahu edhe nga Rusia, ishte propaganda fetare, përmes së cilës provohej të instalohet konkurrenca ndërmjet shqiptarëve mysliman, katolik dhe ortodoks. Rrezikun nga sllavizmi, siç del kjo korrespondencë e kishin ngritur edhe shqiptarët e fisit Berishë nga Gjakova, të cilët qysh me 1879 kishin dërguar dy përfaqësues të tyre në Vjenë për të kërkuar ndihën e autoriteteve austro-hungareze nga kërcënimi dhe “progresi i vazhdueshëm i sllavizmit në Shqipëri”.

Në vëllimin e parë kanë vlerë të madhe edhe shënime të tij të titulluara: “Kujtime lidhur me lëvizjen kombëtare shqiptare”, të cilat kapin një hark kohor 1897-1899 dhe evidentojnë këndvështrimet e Konicës lidhur sfidat e lëvizjes kombëtare shqiptare përballë pushteti perandorak të Kostandinopojës, si dhe Patrikanës Greke, e cila kërkonte mundësi për ta çrënjosur gjuhën shqipe. Nga ky letërkëmbim i këtij vëllimi mësojmë për letërkëmbimin e Konicës me shumë shqiptarë të njohur të kohës, të cilët llogaritej se mund të ndikoheshin në drejtimin e dëshiruar për kultivimin e ndjenjës kombëtare. Në këtë linjë, del në pah kontributi i shumë figurave kombëtare që nga Naum Veqilharxhi e deri te Sami Frashëri, natyrisht duke evidentuar edhe kontributin e shumë shoqërive dhe shoqatave kulturore shqiptare në Sofje, Bukuresht, Bruksel dhe Egjipt dhe vende të tjera. Në pjesën e 5-të dhe e fundit përmbajnë një listë alfabetike të të gjithë shqiptarëve që, drejtpërdrejt ose indirekt, për ose kundër, ishin të përfshirë në lëvizjen shqiptare.

Dokumentet e përfshira në këtë vëllim, të panjohura për lexuesin shqiptarë, që tani i publikon historiani Selver Islamaj, kanë vlerë të madhe për studimin e historisë së popullit shqiptar, rolin dhe pozicionin e politikës austro-hungareze ndaj çështjes shqiptare, si dhe kanë vlerë të madhe për historinë, për kulturën dhe në përgjithësi për albanologjinë. Kjo korrespondencë shumë e pasur pasqyron veprimtarinë e gjerë kulturore, letrare, publicistike dhe diplomatike të Faik Konicës, si dhe përshkruan rrugëtimin e vështirë të revistës “Albania”, e cila na shfaqet më tepër sesa një revistë e rëndomtë letrare. Në këto materiale gjithsesi gjejmë edhe shumë dëshmi të cilat ndriçojnë shpërfaqjen e dallimeve të para në mes Konicës dhe zyrtarëve austro-hungarezë në Vjenë, të cilët shpesh herë nuk hezitojnë të shpërfaqin vërejtjet e tyre për përmbajtjen dhe karakterin e revistës. Andaj, botimi i dokumenteve origjinale në këtë vëllim, gjithsesi paraqet një kontribut të rëndësishëm historiografik sepse jep mundësi për ndriçimin sa më gjithëpërfshirës të kaluarës së kombit tonë dhe gjithsesi edhe të qartësimi të mëtutjeshëm të pozicionit dhe rolit të Austro-Hungarisë në kultivimin e gjuhës shqipe dhe të botimit të revistës “Albania” si një instrument i rëndësishëm për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe për përhapjen e ndikimit të saj në hapësirën shqiptare. Pa dyshim, ky kontribut i dedikohet miqësisë së gjatë ndërmjet Vjenës zyrtare dhe botuesit të revistës “Albania”, Faik Konicës, evropianit më të madh shqiptar dhe personalitetit erudit dhe më të shquar të letërsisë dhe kulturës shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XX..



Pyetësori "Librat e jetës sime"

VISAR ZHITI

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar? Kam një romancier që më dhimbet, Astrit Delvina.

1. Libri që po lexoj ndërkohë:

Rileximet janë leximi më i mirë, sipas Borges-it dhe, edhe mua, po më ndodh po kjo gjë, madje kam në dorë pikërisht Borges-in, të gjithë tregimet e tij, po i shijoj ngadalë, këtë radhë me përkthimin mjeshtëror të shkrimtarit Bashkim Shehu. Ndërkaq lexoj disa libra njëherësh, ka kohë që veproj kësht, jam duke mbaruar një vepër të kozmologut, shkencëtarit Stephen Hawking dhe iu ktheva romanit të Lev Tolstoit "Haxhi Murati", e solli rasti, s'do ta besoja që do të më pëlqente aq shumë tani, sa klasik, m'u duk dhe modern. Në botimin e parë, të "para çlirimit", siç thuhej atëhere, mbaja mend përshkrimin e vrasjes së çëçenit Haxhi Murati, ngrihej toka dhe i binte në ballë, më kishte tronditur, kurse në botimin e ri me përkthim të ri, Haxhi Murati, teksa rrëzohej, i binte me ballë tokës. Trille përkthimesh a të kujtesës?

Poezinë e mbaj vazhdimisht ndër duar, në çdo moshë dhe kudo, nxënës, rrugëve, mësues, në burg, në stacione, hoteleve. Lexova poezitë e Atë Pjetër Meshkallës, do të dalin në një libër më vete dhe po

shoh poezitë e një poeti amerikan, Robert Frost, "signature edition", ku mes poezive ka disa fletë të bardha, mund të shkruash dhe vetë, një botim i veçantë. Te vargu "Write on the sole of my shoe" (Shkruaj në shuallin e këpucëve të mia) desha të shtoj, që unë kam shkruar mbi paketa cigareshe, ...

2. Libri që më ka ndryshuar jetën

Mua realisht më ka ndryshuar jeta prej librave, do të thosha si fat, sepse unë jam dënuar prej tyre. Në akuzë, krahas poezive të mia, kam dhe librat që kisha lexuar. Dhe u dënova me 10 vjet burg. Rashë në ferr. Pra, do të kujtoj nga ata libra armiqësore, siç i quanin, kur libri vetëm armik s'mund të jetë. Do të veçoja Dostojevskin, shkrimtar i ndaluar, kur në shqip ai kishte veç një libër, atë të parin e tij, "Netë të bardha". Kisha gjetur romanin "Shënime nga shtëpia e të vdekurve", e lexova fshehurazi, mësues në fshat, por kisha shkruar në ditar për të. Është libri që më ka ndihmuar shumë të kuptoj burgun dhe kur kupton, di të qendrosh. Pati rëndësi të dorës së parë për mua.

Kisha lexuar At' Gjergj Fishtën e ndaluar dhe Kanunin e Lek Dukagjinit, me parathënie të Fishtës dhe të Konicës. Akuzohesha që pse kisha lexuar librin "Jabloko" (Molla) të poetit revisionist Evgeni Jevtushenko, madje më bërtitej që pse kisha përkthyer poezi të tij, po kështu dhe për një poet japonez, Isikava Takuboku, kishte vdekur 27 vjeç nga tuberkulozi si Migjeni ynë, e kisha përkthyer të gjithë librin e tij nga rusishtja me shokun tim student, poetin Skënder Rusi. Prokurori në gjyq Takubokut i thoshte hapur "Taketukja".. Po kështu në hetuesi jam pyetur për poetin francez Zhak Prever, etj.

Ndërsa në burg, kur ende nuk ishte botuar në shqip, lexova të 7 tragjeditë e Sofokliut, U mahnita. Nga fati dhe fataliteti. I kopjova. Franc Kafkën e mora gojarisht së pari. E njihte shkëlqyer një bashkëvuajtës imi, Inxhinieri Ismail Farka, ishte diplomuar në Sankt Petërsburg, ma tregonte me pathos, parabola, tregimet. Nuk po zgjatem. Librat bëhen me jetë dhe jeta bëhet me libra. Duan liri dhe japin liri.

3. Libri që do të doja të kisha shkruar

Shkruajmë atë që do të donim të shkruanim.... Nëse është fjala për librat e të tjerëve, janë shumë, shumë, të shkëlqyer, libra jete, dhe i dua ashtu, me autorët që kanë, si një pasuri e përbashkët..

4. Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia

Në gjeneratën time, duke qenë një Shqipëri e mbyllur, hermetikisht, me letërsinë hermetike të ndaluar, ka ndikuar letërsia e Kadaresë, më së shumti poezia e tij atëhere, mendoj, edhe pse me Kadarenë koha bëri një romancier shqiptar të përbotshëm, me kryevepra si "Kronikë në gur", "Viti i mbrapshtë", "Muzgu i perëndive të stepës", "Pallati i ëndrrave", që habiti dhe burgjet se si u lejua, etj, e deri te romani i fundit i tij, "Kukulla".

Unë kisha një trini poetësh timen, Esenin, Uitman, secili me nga një libër, të ndaluar më pas, dhe Lorka, ende pa libër poetik atëhere, me drama po. Edhe nga poeti francez Pol Eluar duhet të jem ndikuar, e doja dhembjen dhe paqen e tij. Bofleri me "Lulet e së keqes" ishte një përmbysje për mirë. Dhe poezia që vinte nga Kosova, në koncept, sipas meje, ishte më modern se poezia jonë këtej kufirit. Sigurisht duhet të ngaj me të tjerë të brezit tim në zgjedhje, se kishim të njëjtin realitet përballë dhe na jepej e njëjta letërsi. Vështirësitë e rreziqet për të gjetur libra, që s'ishin në qarkullim, në treg, më saktë, ishin të shumta, por arrihej me ndihmën e njëri-tjetrit, po kështu dhe denoncimet. Romanet e Heminguejit dhe të Remarkut, brezi i humbur, paten një ndikim të madh. Edhe Tolstoi me romanet e tij epope, edhe Gollsuorthi me "Saga e Forsajtëve"..

Ishim me fat që Imzot Fan Noli na kishte dhënë Shekspirin dhe Servantesin. Ne ishim copra Hamletësh e copra Don Kishotësh.

5. Libri që më ndryshoi mendjen

S'e di saktësisht. Ata ia arrijnë të të ndryshojnë mendjen, besoj, pa u kuptuar, jo menjëherë, me kujdes, me dashuri, me art mbi të gjitha. Natyrisht ka befasira estetike, të vetëtimta.

Do të thosha se Realizmi Socialist që u përpoq ta bënte këtë, s'e di se sa ia doli. Prishi shijet dhe moralin e leximit. Se dhe leximi ka moral ashtu sit ë shkruarit, raporti me të vërtetën u prish. Mund të



botohej një roman atëhere për një kënetë, tharjen e së cilës e kishin sabotuar (?) inxhinierë dhe intelektualë, që i pushkatojnë, kur e vërteta ishte ndryshe apo tregohej për partizanë që vriteshin me emrin e Enver Hoxhës në gojë, kur ai gjatë luftës ka qenë ilegal, i padëgjuar. Letërsia jonë mbante anën e sundimtarëve. Por, ndërkaq, na vinte në ndihmë një Shvej, që të mund të talleshim apo një Bertold Brehti q:ë të mësonim të mendoheshim.

Fëmininë na i shpëtoi “Pinoku”, Hamleti i fëmijëve dhe më pas “Princi i vogël” i Ekzyperisë.

Pas viteve ’90 për mua Ernesto Sabato, Markezi, Kortasar, Roberto Bolanjo, realizmi i tyre magjik, kanë qenë një mrekulli. Sollzhenicin tregoi atë që s’e kishim treguar ende. Shallamov më ashpër. Ernest Koliqi, jo vetëm me tregimet, por me dramën “Rrajët lëvizin” duhej të ishte ndikues më shumë për mendimin tonë. Musine Kokalari ka zë nënë, plakash letrare ashtu si Mitrush Kuteli që ka zërin e të treguarit shqip. Riardhja e 7 tragjediive të Et’hem Haxhiademit është ngjarje, po kështu dhe ndoshta jo vetëm për mua, edhe zbulimi i 7 komedive tragjike të tim eti, Hekuran Zhiti.

Poetët e pushkatuar Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, i varuri Havzi Nelaj, goftë dhe me një poezi e ndryshojnë botën përreth. Ato që i kam quajtur burgologji, “Rrno vetëm për me tregue” të At Zef Pllumit apo libri i vogël studimor “Letërsia e pame ndryshe” e Dom Zef Simonit, botimet e tjera të kësaj hullie, besoj ta kenë ndryshuar ndjeshëm mendjen e popullit që lexon..

Do të thosha se tek ne ka ndodhur një dukuri e çuditëshme, që s’e kanë lexuesit e letërsive të tjera në botë. Unë dhe të tjerë të gjeneratës time u formuam më shumë me letërsinë që mungonte, atë të ndaluarën, se sa më atë që lejohej e na jepej, shpesh me dhunë psikologjike, propaganda, me programet në shkolla, etj, që ende kanë një inertësi të dëmshme.

6. Libri i fundit që më bëri të qaj

“Kështjella” e Franc Kafkës.

7. Libri i fundit që më bëri të qesh

“Kështjella” e Franc Kafkës sërish. Ai ka një humor tragjik, që ngjason me atë të burgjeve...

8. Libri që më vjen turp që s’e kam lexuar ende

Të shumtë janë librat që do të doja t’i kisha lexuar. Që të më vijë turp, do të duhet ta lexoj më parë, që ta di, por po e lexova, ai s’është më te të pa lexuarit.

Tani që ra pandemia e Covid-19, shumë veta thoshin që po lexonin “Murtajën” e Kamysë, sa keq që nuk e kishin lexuar më pare. Pra, ka vonesa. Dhe shumë. Ne jemi popull i vonuar.

Më keq do të ishte nëse do të na vinte turp për çfarë lexuam

9. Librat që kam dhuruar

Po, kam dhuruar me dëshirë, më kanë dhuruar dhe i çmoj. Së pari gjestin. Është bukur të dhurosh libra ashtu siç më pëlqejnë dhe radhët nëpër librarira, i kam parë metropoleve. Unë më shumë do kem dhuruar, nga librat e mi, se kam patur më të lehtë nga ana etike, nga që kam të drejtën e autorit mbi to.

Nuk ka rëndësi sa e shtrenjtë është dhurata, thoshte Shenjtja Nënë Terezë, por sa dashuri ke vënë në të. Libri shkruhet nga dashuria dhe është dashuri.

10. Libri me të cilin dua të mbahem mend

Nga që nuk kam shkruar vetëm një libër, nuk e di kë të zgjedh, vërtet. Dhe pse? E di lexuesi...

11. Leximi që me jep rehati

Ndoshta leximi më emblematik është ai pranë zjarrit në një kolltuk, ka dhe romantizëm, familjaritet, etj, Më pëlqejnë shumë kur shoh që lexojnë në tren, në metro, më duket vagoni si një bibliotekë lëvizëse. Vetë kam lexuar dhe parqeve, në ballkon, dhe në këmbë, në rreshtat e burgut, në sale biblioteke. Më pëlqen të lexoj herët në mëngjes, edhe pas mesnate është qetësi.

Kur lexon, je në një tjetër jetë. Ti shton jetët e tua me leximin. Gjithsesi të lexuarit është një nga punët më të rëndësishme në botë, më dobibukura.

12. Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

Kam një romancier që më dhimbet, Astrit Delvina. Po ne kemi një letërsi të gjithën, që duket si e nënvlerësuar, zyrtarisht të paktën, padrejtësiht, atë që erdhi nga burgjet dhe internimet si një letërsi tjetër.



NURIE EMRULLAI

Vdekja e befasive

Tani jetoj në paqe,
se të gjitha befasitë e jetës
që duhej të më ndodhnin ndodhën.
Nëpër sytë e mi nuk fluturojnë më zogj,
as trotuarit të ballit nuk ecin çifte që puthen,
e duart e vogla, tmerrësisht të mrekullueshme, nuk zgjatem t'i kap.

Gjërat që më ndodhën
vërshuan mbrenda meje si një lum i rrëmbyeshëm,
dhe i degdisën ndijimet e mia prej fëmije,
derisa të tashmen e mbushën me kujtimet gur të rënda,
që asnjë harresë nuk i tëhollon dot honeve të gjata të trurit,
dhe kjo i ngjante një torture, por deri sot.

Dashuritë që i prisja,
trokitën në derën e qelqtë të shpirtit tim,
pak gjëra që kishim i rrëmbyem nga njëri- tjetri,
për të ardhmen tonë që e mendonim gjithnjë vetëm.
Dhe të thuash ASGJË, s'ke thënë gjë.
Kjo vajzë që u bie me grusht tëmtHAVE nuk vuan më nga asgjëja...
Sot jam një krijesë me shumë gjak, por me rrahje të rralluara zemre.

Nata ime e gjatë, si fjala “E j-a-sh-t-ë-z-a-k-o-n-sh-m-e”,
teksa dita e ruan të njëjtën trajtë,
e njëjta dritë ruhet në errësirë dhe e njëjta hije- ditëve.
Por hija e asnjë trupi nuk më befason më.
Nuk është më detyra e diellit për t'i rritur krijesat.

Dikur gjuaja yjet që binin, se majë mendimeve të mia e thellë në zemrën time ngaqë
kisha një dëshirë që e thoja përnjëherë me yllin që binte.
Dhe ngelesha pa frymë. Dhe isha kaq egoiste për fatin tim. Dhe isha kaq e
dëshpëruar.
Por tani kam harruar të pyes:
A rron diku? A vlen për dikë? A i shkëlqejnë akoma sytë?

Kureshtja ime ngjan me një mace që bën gjumin e mbasditës.

S'ka më tronditje.
Se këtu ku jam asnjë zë nuk dëgjojnë veshët e mi,
se qe një herë kur Zoti më dha shenjë.
Jo më. Jo. Jo. S'ka jehonë, e as nuk guxoj të dëgjoj nëse zëri më kthehet mbrapsht,
Madje e kam harruar në cilën anë të malit fytyrën ta kërkoj.

Kaq ishin gjërat e mia.
Që lehtësisht mund t'i mbart në një çantë lecke,
dy-tre mbathje dhe dy tre çaste.

Çudi me ç'ngushëllime e nanurisja veten,
Se asnjë lëkurë nuk mbulonte madhësinë e zemrës sime,
Se asnjë trup nuk nxente bukurinë time.

Gjithçka që duhej të ndodhte ndodhi,
Dhe është zemra ime ky fanar që ndizet,
kujdestarja e fundit e dritës,
kjo shpëtimtare e kujtimeve.

DASHNORI

tregim nga
Mehmet Elezi

Drejtori mbylli telefonin dhe kërkoi një kafe të shkurtë. Doni të dini për Dogjanin?

Atëherë nuk isha drejtor televizionit, isha kandidat për t'u bërë kurrkush. Kisha fjetur në këmbë si kuajt, në grunishtë. Kisha fjetur në shkollë, duke bashkuar dy banka nxënësish. Kisha fjetur, ç'rëndësi ka, më në fund më gjetën një strehë në pjesën e mbrapme të vatrës së kulturës. Një si kthinë a aneks, mbushur me gjithfarë rrangallash, një daulle e shqyer, do perde të mbledhura duq, një zgjedhë, ç'dreqin donte zgjedha aty?, veshje popullore të brejtura prej tenjës, gazeta të zverdhura palë, mbytur në pluhur. Kryesorja, aty ishte një dritare e madhe, hynte dritë dielli sa të duash. Do dërrasa e listela të kalakryquara, që mbyllnin dritaren, i zhgojova, ua hoqa gozhdët e ndryshkura e njollat e gëlqeres dhe sajova me to një shtrat druri. Tashti mund të mblidhja brinjët rehat-rehat, në vetminë time.

Nuk ju thashë, drita e diellit ka lidhje me minierën, fillimisht më patën çuar në minierë. Sa hyja në galeri, zverdhësia. Ndieja kërcitjet e armaturave, dheu e gurët çuquritnin, do t'i shtypim si bubrreca, i thoshin shoqi-shoqi. Më terroreshin sytë, disa herë më ra të fikët, duke shtyrë vagonin. Gazetar, bythëpambuk qyteti, i rritur me makarona, më shkundi brigadierit. Mos e çaj kryet, shtylla në këmbë në galeri dhe gruaja shtrirë në shtrat mbajnë sa të duash. Më vizitoi mjeku i minierës, je klostrofob, më tha. Falë tij më caktuan me dhanë mësim në shkollë. Në minierë më patën çuar për riedukim.

Me Dogjanin më afroi ajo fjala e Nastradinit, të vijë me më pa vetëm kush është rrëzuar në dardhë si unë. Dogjani dhe unë qemë rrëzuar në të njëjtën dardhë. Ky do vjet më i ri, kish mbaruar shkëlqyeshëm të mesmen bujqësore, duke bërë dy orë me shkue e dy me ardhë mbi ato këmbë të gjata si të Husein Boltit, për universitet nuk ia dhanë të drejtën. I ati kish mbaruar akademinë ushtarake në Itali, kish qenë oficer i lartë xhandarmërie i mbretnisë. Dreqi di pse e caktuan Dogjanin në atë kooperativë, ai vinte nga malet, atje kish më shumë nevojë. Me gjasë aty qe më i kontrolluar.

Djalë i bukur, në sy kish përherë një mjegull plot mall, stërpikur me gjelbrim. Rrinte i tërhequr, nuk afrohej. Po t'i flisje, buzëqeshte. Ku po fle, i thashë një ditë. Mjegulla e syve të tij u tremb, thua e çau ujku. Pse e pyet, i thashë vetes. Po flije ti kur erdhe në fillim?

S'e di si u gjet një krevat portativ i harruar diku dhe u bëmë dy në atë që po e quaj dhomë a fjetë. E vetmja kërkesë që më bëri pas do ditësh, qe për librat, mund t'i lexoj edhe unë? Po unë mund t'i bie violinës tënde? Kish një violinë të vjetër, e paskesh prurë i ati nga Italia, im atë e çmon mbi çdo send që ka, tha. Një herë i kam thënë vetes kushedi, po sikur të jetë e Stradivarit? Aq tingëllim qiellor, të dridhshëm kishte. Dogjani luante herë pas here do pjesë të huaja, disa pa ua ditur emrat, luante këngë shkodrane dhe këngë napolitane. Nuk dinte nota, pjesët i mbante mend siç ia kish kapur veshi në fëmëni, duke dëgjuar të atin në kullë mes maleve.

Rrallë na binte me ndenjë një orë bashkë, kohën e gjumit nuk po e shti në hesap. Ai vonohej, kooperativa kooperativë, i duhej me dhanë llogari edhe për një bisht shati.

-Si e kalove sot Dogjan?

-Paj, mirë.

Prej qenit të rojes e merrja vesh se po vjen. Lehte si i çartur. Pasi u miqësuan, qeni tundte bishtin, kur kalonte ai. Mbasandej nuk më lajmëronte më qeni i rojes, më lajmëronte një lepur. Lepuri i gjumit tim të lehtë. Edhe pse hynte pa u ndier, thua qe hije dhe jo qenie me shpirt, nuk ndodhte mos me e ndie kur çelte derën.

-Shumë u vonove Dogjan. Ke hangër gjë?

-Paj, punë.

Vonesat e tij po bëheshin më të shpeshta. Dhe sidomos

më të zgjatura.

Këqyr orën, ka kaluar mesi i natës. Këqyr prapë shtratin e palosshëm, Dogjan s'ka. Hë, djalosh, nuk po e marr vesh punën tënde. Diçka nuk shkon këtu.

Je më i ri se unë, dëgjo, i them një natë. Nga bredh nëpër terr, kur gjindja flenë? Do ta marrësh veten në qafë. Je rritur në fshat, e di ç'u bëjnë maçorrave? Kur e teprojnë pas maceve nëpër shtëpitë e botës, duke zgjuar edhe muret me mjaullima, ua këputin bishtin. Po, po, bishtin. I kapin, ua venë në cumër druri dhe krrup, me sqepar. Ti e kupton, hm, këta nuk merren me bishtin. Këta këputin koka!

Mjegulla e syve të tij u shndërrua në vesë.

Të kuptoj, je i ri e të vlon gjaku, hormonet ulurojnë si uj, jo si maçokë. Të paktën kapu pas njerës e mbaju aty, për së mbari. Mos bridh natën shtëpi në shtëpi.

-Paj, nuk.

Zëri i humbi nëpër terr.

Jo vetëm zëri. Edhe ai vazhdonte me humbë nëpër terr. Një herë në javë, dy herë në javë, tri herë në javë. Pa një rregull.

Një natë i dhashë karar me këqyrë ku po mbytet, më dhimbsej. I vihem pas. Ngrohtë, s'kish hënë, shpërhapej erëhim barishtesh të njoma dhe uji të ndenjur kanalesh, crrikaçët nuk pushonin, tej priste heshtjen një klithmë, pingronte gjoni. Kishim ecur nja katërdhjetë minuta të mira nëpër xhade, kur më humbi. Se nga doli një motor, grahësi zbriti, ia la motorin këtij dhe u zhduk. Shih, qenkan grup! Në ç'punë të fëlliqët je zhytur more djalë?! Për fat ia beh autokinemaja, operatorin e njoh, kishte shfaqur film diku në fshatrat matanë e po kthehej. Po ti këtu? Shkelja, i them. Pas tetëmbëdhjetë kilometrash Dogjani merr kthesën në një rrugë të ngushtë. Le motorin te këmba e urës së drunjtë, hyn përfund saj, vonohet pak, aty paske lënë takim o bukurosh? Hyn në një barakë. Atje banonin të internuarit, pasi kishin bërë burg politik. Palohem pas një trungu. Filloj me nirthtë, më kaploi i ftohti, ndoshta lagështia e natës, ndoshta ethet e zemërimit me Dogjanin. Pas një farë kohe çelet dera, nuk ndizet dritë. Dalin dy hije. Puthje cuk-cuk, pëshpërma. Prapë po putheni, nuk ju mjaftoi një orë brenda? Ah, more Dogjan!

Kisha hyrë në tesha, kur u kthye. Hape dritën pa merak, dashnor i orëve të vona, i them. Jam zgjuar. Se edhe në ma pastë qejfi me fjetë, nuk fle dot. Sonte është nata e fundit që ti, more djalë, rri në dhomë me mua. Madje as sonte nuk duhej të puthje këtu. Por s'ke ku shkon në këtë orë,

më vjen keq. S'ke ku shkon, se edhe ajo dashnorja jote, me sa duket s'të mban dot brenda. Mos thuaj jo. I pashë të tëra me sy.

-Paj, tha Dogjani. Mund ta ndez një cigare?

-Ndiz cigare e çka të ta dojë zogu i qejfit, vetëm banesës mos ia ve flakën, boll po i ve flakën jetës tënde. Paç veten në qafë, kush vret veten, shkon gjakhupun. Me gra të martuara, të internuara! Nuk gjen një vajzë të hajrit në tërë këto katunde?

Nuk besoj se mbyllëm sy njëri as tjetri. Pak pa zbardhur, nisi me u veshë.

-Faleminderit për bujarinë, më mbajte me bujtë kaq kohë, tha. Diku kam me e shti kryet edhe unë, si tërë qeniet e gjalla. Ose do të kthehem në rrenojat e kullës. Atje, në male.

-Pse thua rrenojat, s'ke prind atje?

Më dridhej zëri prej idhnimit.

-Paj.

Po çel drita, tha gjeli i rojes. Andej kah kodrinat derdhej frymëmarrja e lëbardhme e qiellit. Në krahun tjetër, nga deti, notonte hëna. Edhe ajo zbardhur.

Dogjani lëshoi mbi shkrimore dy paketa cigare.

-Po t'i lë këto, nuk ma merr për keq. S'.

Në sy iu rrëzua nata.

-Më lejo me të kërkue edhe një shërbim, tha. Mund ta lë këtu, te ti? Ma afroi violinën te nënkresa. Do kohë, sa të. Vetëm pak ditë, ndoshta. Sido të bëhet, ti ma ruan. Te ti e kam të sigurt.

Dikush ma mëshonte me grushta nga brenda në parzëm, gjynah, pse e dëbon?

Shkrap. Dogjani uli dorezën e derës. U ndal.

-E mora vesh se më ke ndjekur. Dhe ke parë një hije kah më përcolli nëpër terr. Në oborr të kasolles, te të internuarit. E ke dëgjuar kah më puthte cuk-cuk, në faqe.

-Po, e pastaj?

-Ajo hija që ke parë është e lodhur, e këputur. Vetëm kur më sheh mua, këndellet. Ditën punon si kafshë në fushë, natën i shërben të shoqit. Ai është i sëmurë.

-Aq më keq, Dogjan. Për ty, jo për mua. Mua më kanë ndëshkuar, je liberal, por ëndërroj me u çue në këmbë, përpigem me dalë mbi ujë. Sa për veten, aq për nanën e për babën tim. Nuk mund t'ua copëtoj prapë zemrën, kanë vuajtur mjaft. Ti je më i ri se unë, të paktën për prindët e tu nuk mendon? E sheh sa poshtë paske rrëshqitur?

-Thashë, ajo i shërben atij, ai është i sëmurë. Dikur ka qenë oficer. I shkolluar në Itali.

Çupuriti nëpër xhepa, sikur kërkonte fillin e një lëmshi. Kërkonte shkrepësen.

-S'e di kur shihemi, veç. Veç mos mendo keq për mua. Ti s'e di kush është ajo që më përcolli në oborr.

-As që dua t'ia di kush është ajo!

Heshti pak.

-Në oborr më përcolli nana. Atje janë prindët e mi. Prindët e mi të internuar. Ti e kupton, nuk mund t'i takoj ditën. Megjithëse. Nana vuan dyfish.

Nata m'u dogj në gojë. Goja m'u mbush me shkrumb.

-Kam një mik, ka një motor të vjetër, e ka të punës. Sa herë ka mundësi, më përcejell e më kthen. Përndryshe nuk.

Matanë gardhit lehu thekshëm qeni i rojes. Dikush po afrohej asaj nëpër terr.



RUDOLF MARKU BOTOHET NË AMERIKË,
në **Mundus Artium Press**. Përzgjedhur dhe perkthyer prej vetë
autorit, vëllimi poetik "Mountains Entering"(Hyrje ne Male)
po bën jehonë në kritikën amerikane të poezisë.

Malet në Shtëpi, Anijet në Det: Meditime mbi një Ballkanas

Nga James Manteith

Mundus Artium Press, themeluar ne vitin 1994 ne University of Ohio nga profesori dhe poeti i njohur, Rainer Schulte, i shtrirë vite me vonë edhe në University of Dallas, Texas, synon njohjen e lexuesit amerikan me letersinë më cilësore bashkëkohore. Kolana e saj e botimeve përfshin mbi 3000 autorë, të huaj dhe amerikanë, midis të cilëve emra kanonikë si Jorge Luis Borges, Carlos Fuente, W. h Auden, Joseph Brodsky, Odysseus Elitis, Giuseppe Ungareti, Pablo Neruda, Octavio Paz, Thomas Transtromer dhe Gunter Grass.

Kjo Shtëpi Botuese publikoi në vitin 2012 vëllimin poetik të Preç Zogajt, "Occurences on Earth", (Ngjarje në Tokë) në përkthimin e përkorë të Gjek Marinajt—një eveniment i cili, befasishëm dhe shumë sukseshëm, e futi poezinë bashkëkohore shqipe në hartën amerikane të leximit të poezisë.

Në numrin e sotshëm të Ex Libris, po botojmë reçensionin e kritikut amerikan, James Manteith, botuar si parathënie e librit.

Lindur në nje mplekseje etnike te famshme per nga kompleksiteti, Rudolf Marku del prej pejsazheve te intonuara Shqiptare, sublimuar ne nje perimeter të valëzuar e prape te mprehte metafore. Ngajdhnes mbi ideologjite opresive, te shkuara e te ardhme, ai laton nje vizion sa te panjohur për ne, po aq edhe tematikisht te angazuar. Ky autor ka njohur shume forma te ekzilit dhe ndarjes: internimin e hershem në zonat me rurale, veçimin nga qendrat intelektuale, konfrontimin me Shillen dhe Karibden e censures dhe banalitetit, duke mbetur zaptues i paasimilueshem i nje hapsire te larget fizike dhe shpirtore, pasqyruet i ndryshimet kulturore te vendit të vet brenda kufijsh te perceptuar nga pikveshtrimi i pavarsisë së brendshme dhe, ta themi pa diplomaci, përherë në simpati kreative me një Britani sa të hershme po aq të pamoshë.

Në një dialog të mprehtë me Europën post hegjemoniste, Rudolf Marku mbetet dishepull i paepur i një shkollë të përvetshme; banor malesh dhe anëdetesh, poezia e tij i shmang perspektivat tokësore për të bërë bashkë najadat dhe ujqrir.


Marku eshte poet tragjik por tragjedia nuk eshte fjala e tij e fundit. Ashtu si Odisea Homerik—njeri prej heronjve te tij te preferuar—ai e vetzbulon trajektoren e vet si një barrë qëllimi që ja bën udhëtimin shumë më tepër se sa personal. Duke i rënë gjatë navigimit të historisë së kombit të vet, ai i çliron endjet e tij meditative prej përkitjes hapsinore dhe kohore. I qetë ndanë Thames-it të patrazuar, si të ishte në Itakën e Ilirisë, orbita poetike e zbret herë thellësive të Pacifikut, herë e ngjit në Alpe ku Jungfrau ja ndih rikalibrimin drejt gjeografisë arketipe. I familjarizuar me majëmalet e poezisë, ashtu siç parathotë Herakliti, kurrë nuk ja del të mbrijë në shtëpi ngase nuk mund të hysh dy herë në të njeitin qytet. Destinacionet e tij mbeten trishtimi dhe vetmia.

Tragjedia për Markun është Gehenna e një bote lutjesh statike, e prizmit miopik të modernitetit. “Poetët,” thote ai, “janë qytetarë të Ferrit,” por prapë kjo cilësi qytetarie nuk mbetet (nën)kuptim final. Ferri i poetëve ka një liri të brendshme ngaqë brenda kufijsh të dhëne, brenda ligjesh të paracaktuara ata finalizojne politika fluide. Poezia garanton dyshtetësi te pamohushme prej prerogativash ligjore nderkohe që atdheu tjetër i Poetit, “trualli ku na shtyjnë,” mbetet diku mes qiellit dhe tokës, aty në kendin e preferuar të ëngjëjve. Per Rudolf Markun, poetët janë “agjintët sekretë” të atdheut, mjeshtra galerash që minojnë të nëndheshmen; ata edhe kur sillen si banorë të zakonshëm teksa pinë në bare duke lëshuar fraza të kalkuluara dykuptimshme apo romuze rioshësh me “zonjat e natës,” edhe kur tallen rendshëm me familjet mbretnore, prapë mbeten nje racë e ndryshme. I bën të tillë përshtatja me sferat qiellore, aftësia për të përdorur epitetet e ferrit edhe kur përshkruajne parajsën. Poetët per Markun kryqëzohen padukshëm në zemrat e te gjithëve dhe të asnjërit, ata ofrojnë zemergeresisht çlirim prej realitetit skllaverues. Duke jetuar vargmaleve antike dhe dallgëve të kohës, aty në habitation e Ovidit dhe të pavdekshmëve të tjerë, poetët e vertete e dinë se fati nuk

vdes, se trishtimi ka flatra morbide, se mungesa e fundit tokësor egziston si pasoje e absolutes së preکشme, se dashuritë na bëjnë “të dallim jashtë kohe.”

Poezia e Rudolf Markut frymëzon kujtesën selektive, flakjen dhe harrimin. “Tani që kemi harruar të vdesim,” shkruan ai, “duhet t’ja nisim dashurisë sonë/ sërisht prej fillimit.” Mountains Entering, edhe pse rëndon prej dhimbjes e nostalgjisë ngaqë dashuria është shërbim i vështirë, përpjekje dhe sakrificë, prapë mbetet një libër i cili, paradoksalisht, ofron me tendencë fillime të reja. Lëndimi përmes ngjitjes në lartësira alpine, shihet si një tagër që lehtëson sublimimin e epërm në një altitudë të paraprirë nga male më të ulta—metaforë e një dashurie me adhurim më minor. Duke shmangur qëndrimin në hapsirat pa ngjyrë si aktorë dystë, ky poet i mundëson vetes shpërblimin me forma më integrale, me skena më frymëzuese, përtej asaj që ofron Teatri (i stimuluar) i Globit.

Rudolf Markut, ketij dishepulli dhe eksponenti te Ballkanit, malet i hyjne në shtëpi të heshtur e te mençur, me shtjella ujrash që na gdhendin, me pamje që mund të karakterizohen. Peisazhet e tij alpine dhe argonaute, frymezojnë një erë rebelimi përkundër përshtatjes përtace, përkundër pranisë gjasme të përvetshme të statistikave demografike. Emisar nga kufiri i larget i Europes Lindore, ai flet per te gjithë ne, per te shkuaren e shpenzuar kot dhe per te ardhmen e falimentuar.



Ky lloj shkrimi i poezise pikturon nje tradite kruciale humbur a keqperdorur qellimisht a nga konfuzioni, si diçka që mund të ribëhet apo rizbulohet ashtu si “monedhat e Piros së Epirit,” me të cilat dikur në fëmëni bashkëmoshatarët e tij, “blinin akullore / prej shitësit ambulant të qytetit...” Ky Ars Poetica, egzalton thesare që i kanë mbijetuar shvlerësimit nga bublat spekulative të shekujve.

Ngjashëm me Eliotin, Poundin a Odenin, poezitë e të cilëve i ka sjellë me finesë në gjuhën e tij amtare, Rudolf Marku priret nga pasioni për rimanifestim të bukurisë së preکشme, bëhet korrier kumtesh prej lartësive në abys. Vërejtur kujdesshëm, një bukuri e tillë lind bukuri të reja duke i nervozuar edhe më bujtinat e zhurmëshme të botës.

Në Mountains Entering, gjejme një seriozitet te cilin, në një farë mase, na e kanë tehuajzuar tendecat më të fundit të shkrimit poetik. Këtu edhe prania e humorit përzihet me një hije qortimesh aristokratike mbështjellë në tis melankolie. Pavarsisht kësaj tendence, prapë ndiejmë pulsimin e një premtimi, një “Prill të zemrave tona,” një rudinë të blertë drejt të cilës nuk të çon jeta e zakonshme.

Kompozimet e Markut, ashtu si ato te Kanonikëve Klasikë—Homer, Safo, Katul, Ovid, Shekspir apo Servantes—demonstrojnë mënyrat se si komunikon monдания me të pazakonshmen në tremen e gjatë të shkëmbimit të eksperiencave.

Nga anijet e mbytura prapë ndërtohen barka.

Të njohur a anonimë, të pavdekshmit e mëdhenj të njerëzimit, ashtu si të gjithë ne, kanë qenë shpirtira të preکشëm prej kufizimeve, ndryshojnë ngaqë i mbrinë lartësitë shtyre nga disponimi i brendshëm, nga aftësia për distilim të mençurisë prej revelimit dhe traditës, përqendruar aty në “Sheshin e Errët” të lutjeve.

Ajo çka tërheq vëmendjen e Markut, ajo çka i fiton atij zemrën, duket si një majë pa thepisjë ku e zakonshmja dhe transcendentalja njësohen ashtu si ai çifti i pleqëve tek vjersha, “Ç’ndodhi në Rrugë...” si mirëmbajtësi i kalldrëmit që përkulet për të rregulluar shuallin e këpucës, ose si drerët e Stokholmit thelbi hyjnor i të cilëve formon një kundrapikë bitnike me ruajtësit e rendit publik apo shpalljet e çmimit Nobel.

Natyra si natyra, natyra njerezore e sinqerte me veten, pranon siç shprehet poeti ne poezine per nënën e tij të vdekur, “ të ecë në majë të gishtave ‘ mes zhurmës së botës,” është pika ku gjendet dhe mbështetet pasuria dhe koherenca meditative e Rudolf Markut, një pikë ku siç shprehej motivacioni i Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë me rastin e prezantimit të tij si poeti i parë Laureat i Vendit, gjendet përtej konteksteve politike, historike dhe gjeografike.

E sapo përkthyer në Anglisht prej vetë autorit, perzgjedhja qe po mbrin per lexuesin Amerikan, artikulon me një pasion që i adresohet çdo shoqërie të braktisur gjuhet një gjendje që i shkon përshtat edhe vendit tone, edhe mëkateve tona. Jo krejt pa pendesë, edhe ne mund t’ju kthehemi dallgëve, shpateve dhe majëmaleve tona.

Malet dhe detet e Markut formojnë një ekuacion të vetëm, një qark të unifikuar. Malet zbresin drejt bregdetit dhe deti vet sikur jua mat permasat maleve, secila anë përputhet me tjetrën. Në një magjepsje dyfishe, poeti, “Ky përkthyes imagjinate në nje bote te shurdher,” ju rikthehet aromave të ujrave të kripura ashtu si “Grekët e lashtë që shkonin në Mal të Olimpiti / sa herë kërkonin ndihmën e Zotave.” Ai e di se malet dhe detet ndajnë të njeitin Zot, i paanshëm në ngushëllim, në mençuri dhe përkujdesje.

Deti na fal “guacka që dalin prej thellësive / si ëndra pa vend ku të prehen,” ngjashëm me vetë ne mirëbesuar me ëndrat e njeri-tjetrit, me ëndrat tona, të maleve dhe të vendeve të shenjta. Malet “afer qiellit dhe sipër reve” falin jo vetëm gurë dhe “bardhësi lbyrëse,” por ofrojnë edhe një afinitet familjar—lisash të fortë e shelgjesh të butë, lule ëmbëlsish të idhta, erërash energjike dhe lumenjsh kthjellimi. Kur “kuajt e Bardhë” të detit na aviten pranë, kur malet-guru na gjejnë portën, kur “ëngjejt me flatra të tjetërbotshme” zbresin e hyjnë shtëpive tona, na humb qetësia por prapë, ashtu si Maria, gjejmë ngushëllim.

Ferri nuk eshte i papërshkueshëm. Bota jonë e gjerë mund ta ringjallë përtëritjen e jetes; magjinë e saj të egër dhe autentike, ate “ritmin melodioz” të egzistencës parake, rikalitur në shestime, në gjuhë dhe në mozaik peisazhesh, një Ballkan që e kapërxe ngushtësinë për të ringritur globin mbi themelet e tij të para.

Përktheu Gezim Basha

POEZI NGA RUDOLF MARKU

*Këto poezi u shkruan gjatë muajve
korrik-gusht të ketij viti.*

TIRANA

*(Një përkthim i lirë i poezisë së njohur të John Betjeman.
Nga anglishtja.)*

Ejani, bini mbi Tiranë, o bomba miqësore,
Se nuk është më Qytet për qënjet njerëzore,
Se nuk është më vend për lule, pemë a zogjë,
Se nuk është më vend ku ke dëshirë të jetosh!

Qytet me karrike betoni, tavolina betoni, shtëpi prej betoni,
Ku pemët çelin lule nga pluhur- Terrori,
Qytet që ka mbyllur dhe vetë Zoologjikun
Se kafshët e shkreta duan të ikin.

Ku djaloshi me diplomë shkon në zyrë me gëzim
Dhe gëlltit pluhurin e qytetit n'ekzaltim,
Ku vajzat e bukura provojnë modat e fundit
Të prodhuara në Stamboll, Couture të Babrrukut.

Ku zyrtarët eksplorojnë restorantet me aq zell
Sa Kolombi tek zbulonte Ameriken njëherë,
Ku grataçielet janë të shëmtuara si Hamam
Ku krimet dhe lajmet nuk janë më lajm!

Ejani, bini mbi Tiranë, o bomba miqësore
Se nuk është më qytet për qëniet njerëzore,
Se nuk është vend më për lulet, pemët a zogjtë,
Se nuk është qytet ku ke dëshirë të jetosh!



NJË MYSAFIR NË BALLKONIN E SHTEPISË

Një zog prej betoni fluturon në rrathë mbi ballkonin tim,
Si një avion i vogël që do të sigurohet
Se ka plot vend për një ulje të sigurt,
Janë ditët e fundit që shoh prej këtu kodrat e Liqenit,
Përpara se një rrokaqiell në ndertim
Së shpejti pamjen ka për ta zhdukë.

Me zakonin e lashtë të qënjeve fluturuese
Përpiqet të këndojë. Nuk jam i sigurt nëse zhurma metalike
Vjen nga makinat poshtë apo është kënga e mysafirit tim,
Që rrëfen një histori të pa-realizuar dashurie,
Me një tërfil me pesë fletë, të humbur në rrokaqiejt modern.

Ka vite që nuk arrin ta gjejë të dashuren e vet,
Të gjithë i thonë se kanë vite që s'kanë parë një tërfil me pesë
fletë,
Ndaj fluturon kuturu, si një i dënuar dantesk.

Ngrihet në ajër me vështërsi dhe ikën.
Derisa unë vë re tek e vona se si lulet te ballkoni
-Pesë a gjashtë vazo gjithësej-të gjitha vyshken.

Prej diellit afrikan të Korrikut
Ose prej historisë së trishtë të zogut prej betoni.



NJË LULE METALIKE

Në ballkonin e Xhuljetës një lule metalike
Në qytetin e bukur Veronë /Valonë.
Romeo është inxhinjer mekanik,
Dhe mendja e tij çfarë nuk sajón!

Një lule metalike nuk ka nevojë të ujitet
Dhe as dielli e as ngrica nuk e prek.
Ndryshe nga fundi i palumtur i Shekspirit,
Nuk harrojnë të paguajnë një ebol të vetëm
Këtë rradhë Dashuria triumfon përjetë.

Turistët vijnë nga kudo të joshur
Nga shkelqimi metalik në ballkon.
Nuk harrojnë të paguajnë një ebol të vetëm
Tek varkëtari i vjetër Karont.



NJË SHISHE NË DET

Nga lartësitë e anijes transoqeanike,
Hedh në ujërat e errëta të natës një shishe-mesazh.

Brenda qelqit kam futur malin ku fëmijë ngjiteshim bashkë.

Në rrafshiren e largët, në një breg të tharë,
Dallgët do ta hedhin shishen te këmbët e tua.

Unë nuk e di,
Do ta marrësh atë mal të rëndë në duar,
Si mall a si një premtim të lashtë,

Kur ti të qash ?



DHURATË

Një rreze dielli hyn në dhomën tënde të gjumit.

Siç ngre lart gjethet e lehta, tek leshojnë oksigjen,
Ashtu mban në ajër trupin tënd të lakuriqt.

Mos më thuaj pastaj,
Se unë nuk të solla asgjë këtë ditë!



ERDHEN ME HARTA, KOMPASE DHE KOSTUME TE SHTRENJTA

Erdhen me harta, kompasë dhe kostume të shtrenjta,
Fëmijët e lanë lojën me top. Macet u fshehen të tmerruara. Qent
nuk guxuan te lehin;

Nuk i hoqën syzet e diellit. Hapen hartat e vjetra, nxorën kompa-
set

Dhe i shtrinë horizontalisht si shpatat nga milli. Me teh shumë
të prehtë.

Panë nga shtëpitë tona të vjetra. Shtëpi ku jemi rritur,
Me pusët në oborr, me dy rrrënj fiq në qoshe, me luleborat pranë
pusit

Dhe me atë këndin e përhershëm ku loznin fëmijët,
Sepse shtëpitë tona kanë qënë gjithmonë të mbushura me fëmijë,
Me emërat e çuditsëhm, jo emërat që shënohen në regjistrat e
shkollës,

Por emërat tanë të vjetër që i dinin vec nënat tona, dhe motrat
dhe vëllezërit,

Si një konspiraci kundër mësuesve të matematikës, Fizikës dhe
stërvitjes ushtarake;

Erdhen me harta dhe kompasë dhe kostume të shtrenjta,
Shpalosën ca letra me vija gjeometrike si rathë të Ferrit

Dhe filluan të flasin për të ardhmen tonë,

Ndërsa pas kurrizit të tyre qëndronin të gatshëm buldozerët;

Na lajmëruan të mos dëgjonim marrëzitë e poetëve

Që flasin për livadhe, për ajër të pastërt dhe për pemë të pado-
bishme jo frutore,

Na thanë se tashmë jetojmë në kohnat moderne,
Na thanë se shtëpitë tona do të rrafshohen për tokë,

Se ne do jetojmë nëpër shtëpi të reja prrralllore,

Në katin e dhjetë, të njëzet e pestë dhe të pesëdhjetë.

Jo për të qënë pranë qiellit, por sepse lartësitë japin gjumë të
qetë,

Se janë kundër ëndrrave, sepse janë pranë Ferrit.

Edhe kur u larguan, macet nuk u kthyen në shtëpitë e vjetra,
Fëmijët harruan të loznin, veshën përnjëherë këpucët e reja

Dhe filluam të ëndërrojmë shtëpitë e larta me shumë, shumë
kate,

Dhe kurr më në jetë askush nuk do t'i kujtojë më emërat e vjetër,
Si konspiracy kundër mësuesve të matematikës, fizikës dhe
stërvitjes ushtarake.



NJË TRUP I LAKURIQT

Një trup i lakuriqt në fushën me borë,
Si i bllokuar nga një trafik që nuk lëviz,
Ankthi i së përditshmes- rituali i zgjimit ,
Kafja e mëngjezit, kujtimi i yt që m'bën surprizë.

Ca flokë debore papritur fillojnë të shkrijnë
Si ngjyrat që përhapen në telajon e verbër ;
Është portreti im a i joti- të pambaruara mirë,
Brusha jote lëviz mbi telajo nga mijëra kilometër.

Ankthi i lakuriqt në fushën ku bie dhe bie,
Flokët e dëborës janë ndryshe nga flokët e gruas që humbet;
Nuk shtrohen flokët e dëborës me krehër a gishtërinj,
As nuk mund t'i japësh formën e flokëve të gruas që mban mend.

Antraktita u krijua nga humbjet e dashurive,
Lumturia kurr nuk përsëritet dy herë, që të kthehet pas.
O hapat e gruas që i dëgjojmë nga mijëra kilometra larg
Si mund të tingëlloni njëlloj në Ferr dhe në Parajsë?



SHENJAT

Një hënë e përgjakur në qiellin e Londrës,
Në kohëra e dikurshme mbretërit do bënin gati ushtritë,
Kurse unë shkapërcej një nga urat e Tamizit
Dhe nuk shoh më lart nga qielli, sikur të kem frikë.

Futem në Park, pemët mbulojnë qiellin,
Një dhelpër vrapon t'i shpëtoj qenve që e ndjekin pas,
Nesër gazetatat nuk do flasim për konfliktet në Planet,
Ndërsa bbc-ja do na kujtojë një Paqe që nënshkruhet pas pak.

Por prapë nuk rri pa parë qiellin e përflakur,
Unë që njëherë qesha me shenjat e hënës që lexoheshin qartë,
Tek ecnim të dashuruar në një shteg me lule
Që na çonte drejt greminës, me urdhërin nga yjet lart.



POETËT

E zvoglova dhëmbjen në lojën e tingujve të gjuhës,
Që kur trobadurët shkruan poezitë e para për Lufrat dhe Dashu-
ritë,
Që kur Pjetër Bogdani pa me sytë e vet Birin e Njeriut
Në majen e Malit të Pashtrikut duke pritë.

Përherë e më të paktë po bëhën lexuesit e poezisë,
Përherë e më rrallë njerëzit harrojnë nga qielli t'i ngrenë sytë,
Poetët vazhdojnë të mbushin penën me bojën e dëshpërimit
Për të shkruar vargjet e tyre me alfabete yjsh.

E zvoglova dhëmbjen në lojën e tingujve të gjuhës.
Për Ju, që vetë e intononi gjuhën në një instrument muzikor;
Ju, që pëlqeni aq shumë muzikën e sferave qiellore,
Dhe prisni që astrologët të jenë lexuesit e vetëm në botë.



NJË PEMË NË MESIN E QYTETIT

Kishin harruar një pemë në mesin e qytetit,
Dikush telefonoi urgjencen, numërin e frikshëm 999,
Një tjetër nxori celularin e markës më të fundit,
U kthye mënjëanë,
Dhe me po atë gjestin kur i telefon të dashurës fshehurazi nga
gruaja e vet,
I telefonoi vetë Kryetarit të Bashkisë në numrin më secret ;
Një ushtarak në pension nxori medaljet nga sunduku,
Dhe pasi i çpluhurosi me kujdes, një nga një në gjoks i vuri,
Dhe me solemnitet i shkroi një letër gjeneralit të madh,
Ndërsa forcat e ndërhyrjes së shpejtë, me maska të zeza në fytyrë
E rrethuan pemën e harruar në mesin e qytetit,
Me manovrat më të fundit të taktikës së rrethimit të armikut të
shtetit.

Ishte një pemë e pazhvilluar mirë, ç'është e verteta,
Nuk mund të thuash me siguri që nuk qe e painfektuar nga Covidi,
Qe fshehur mes ca ndertesave të reja, rrokaqiej të fundit
Dhe askush nuk e kishte vënë re,
Aq e vogël qe.
Një pemë kokëfort që nuk donte e nuk donte të pritej.
Sollën sharra elektrike, sèpata elektronike
Topa, nëndetëse, artilerinë e rëndë
Derisa ndoqëm në lajmet e fundit lajmin e gëzuar,
Se pema më së fundi qe rrëzuar për tokë
Se pema më së fundit ishte masakruar.

Dhe vetëm atëherë qyteti ra në një gjumë të qetë,
Në një gjumë të ngjashëm me gjumin e njeriut pa halle-
I patrazuar nga fantazmat e pyjeve dhe fëshfërimat e gjetheve
Dhe nga mundësia e tmerrit të daljes së milingonave në rrugë të
madhe.




LAHUTARËT

Shumë fatkqësira na mësyen këtë vit,
Vdekjet e papritura nga Covidi, ikjet e fëmijëve tonë,
Në vende të largëta. Sikur vendi ynë të mos qe i mjaftë,
Shpirtërat që braktisin të gjallët. Dhe Eunukët që vijnë në Fron.

Ka qënë e parathënë prej shekujsh. Por ne nuk u besuam shenjave,
Ne, Vdektarë të përkohshëm që na joshin duartokitjet gjithë zhur-
më,
Që ende nuk mësuam të lexojmë alfabetin e yjeve
Dhe shpikim gërma me të cilat shkruajmë gjëra që nuk ndodhin
kurr.

S'na mbetet gjë tjetër veç të thërrasim sërish lahutarët
Këngëtarët e përlurur analfabetë të zejës së lashtë;
Jak u shfaqen në pragun e kullave të tyre të rrënuara
A në mesin e grumbullit të gurëve, në lartësi malesh.

Zëri i tyre është i largët. Nuk i dëgjojmë fjalet,
Por tingulli i Lahutës është i njëjtë si 3000 vite më parë
Po ajo erë e Veriut që fryn mes gjethnajave të pemëve të lashta
Që flet per paqen e dikurshme me mëkatin tonë primordial.



PIRATËT E ULQINIT

*According to the legend, the 24 years old Miguel Cervantes fell in
slavery – one day in 1575-as three fast pirate boats- under the com-
mand of Arnaud Mami- a pirate from Ulcinj, attacked a Spanish
frigate in Adriatic Sea.*
-Internet.

Në gjiun e Ulqinit, me një bukuri që të rren,
Piratët primitivë thurin planet e veta
Që udhëtarin Miguel Servantes ta marrin peng.

Poshtë Kështjellës së Balshajve anijet presin ,
Me një durim mijëvjeçar.

O piratë budallenjt të Ulqinit
Si nuk e mësuat se është bisnezi më pak i leverdis-shëm
Të merrni peng një shkrimtar?

Ju që do të ktheheni më vonë në Kryeministra të ardhshëm,
Botues, kritikë,Presidentë, Bankierë, Arkëtarë

O piratë budallenjt të Ulqinit.
Si nuk ju shkoi ndërmend
Se shkrimtarët janë më të varfërit e kurr nuk merren peng?

Se Servantesit, kockë e lëkurë
Pa trup, pa mish,
As t'ia ngulësh shtizën nuk mund t'i gjesh vend?

Do ju duhet t'ia paguani biletën e kthimit,
Një biletë që kushton më shumë nga gjithë çfarë keni grabitur deri
me sot,
Sepse Servantesi jeton në vendin më të largët
Në atë vend ku anijet tuaja nuk mund të shkojnë dot.

Në vendin më të largët të Dheut,
Ku rrallë, shumë rrallë ndonjë vdektar arrin,
Diku mes Tokës dhe vetë Qiellit,
Vend, që Hartat tuja të gjora nuk kanë se si ta dijnë!



HAMLET

Ku shkoi ai aktori danez kur mbaroi shfaqja e Hamletit?
Ai vetë që quhej Hamlet, dhe jetonte në Elsinor,
Jo Princ, një aktor i zakonshëm i Teatrit Shekspirian.
Punon në Teatrin Kombëtar në Kopenhåg,
Sepse suksemi- dihet- nuk është në provincë, por në kryqyetet
Shumicën e kohës bën *commuting*, me tren.

I duhet të kap trenin për Elsinor. Nga Kopenhagen dy orë udhë-
tim.
Ç'është e verteta trenat nuk janë shumë të shpejtë. Shfaqja kish
patur sukses.

Ah, duartrokitet e publikut. Dhe mes spektatorëve kish qënë dhe
mbreti Danez,
Jo ai i tragjedisë së Shekspirit, por ky i verteti. Simpatik dhe
modern.
I pahelmuar kurr dhe as i shqetësuar nga fantazmat.
Nga dritarja e trenit sheh pemët si rojtarë kështjellash. Ndal!
Kush kalon?...
Në stacionin e parë hyp një vajzë simpatike me emërin Ofeli, dhe
ulet pranë.
E njeh përnjeherë. Ka vendour të mos i flas.
Por dhe ajo duket se nuk ka asnjë interes që ta josh,
Secili nxjerr telefonin smart. Ofelia në Fb dhe Hamleti me thirrjet
e humbura;
Dhe prapë pa thënë as dhe një fjalë, s'mund të thuash se nuk
janë bashkë.

Në mesnatë mbërrin në Elsinor. Ja kështella buzë oqeanit;
Vetë Ofelia ka zbritur nga treni pa thënë as dhe Naten e Mirë;
Shënjat e Post Traumatic Stress Disorder duken qartë,
Dhe Oqeani është i qetë, pa dallgë

Nuk fle.
Ndonëse fantazmat ndjehen se janë kudo, aty pranë,
Natën e mirë, Kim, Naten, Mo-ni- ca, Natën e mirë, Ed,

Ta- ta, Mjeshtër i Popullit, i Merituar, Qytetar Nderi, tik-tak,
Natën e mirë, natën e mirë, Europë , Amerikë, Tiranë dhe Shijak.

Me një diell që nesër do lind si perdet e skenave që ngrihen prapë!



BLITZ

Nuk e di nëse është e drejtë
Që këtë ditë të vërejtur të Londrës të endem kuturu !
Gjithmonë më ke thënë - Më kujto në ditët e bukura të Verës,
Veç në ditët me diell, nën një qiell blu.

Po ku ta çoj këtë ditë të vërejtur të Londres, ku ta hedh?
Krejt papritë, pas kaq shumë vitesh më shfaqesh ti,
Ti vjen vetë, pa të thërrit, me trupin tënd të lakuriqt,
Dhe pa u ulur në tokë fluturon në lartësi.

Sa shumë kohë m'u desh të kuptoja-sa shumë kohë,
Se qënka aq e dhëmbshme të jesh i lidhur me dritë !
Eci rrugëve kët'ditë të, vrejtur, avionëve të kujtimit tënd
Duke iu lutur të mos hedhin bomba nostagjish !



MODERNE

Më shkruan me atë një gjendjen neurotike të frutit të pjekur
Që vjelësit e kanë harruar ta këpusin e ai vetë nuk mund të bjerë
në tokë,
Se unë dua veç trupit tënd, seksin tënd. Se unë kërkoj të kënaq
Eifelin tim,
Më kujton se Lugina e saj e lagësht e Sharonit më ka mirëpritur
Por në fund të fundit edhe unë jam burrë, si çdo burrë tjetër- një
shovinist mashkullor
Që ka spekuluar me mikpritjen dinjitoze të Mbretëreshes Sheba,
Dhe se i shoqi i saj për pak sa nuk ka zbuluar shenjat e kafshimeve
të mia,

Provat e përpjekjeve për ta marr vjedhurazi me vete frutin e leng-
shëm
Do të kishte qënë e tmerrshme nëse burri do ta kishte marr vesh,
E gjithë harmonia familjare do ishte hedhur në erë,
Si nga një bombë artizanale terroriste,
Me takt ma kujton se Adami ëshërë dhe terroristi i parë,
Ai që përdhosi së pari dinjitetin e Evës, vetë feminizmin;
Më flet për egoizmin tim mashkullor, që rritet përherë e më
shpesh,
Dhe për pa-aftësinë time për të kuptuar një grua të bukur e të
ndjeshme...

Katër faqe shkruar me një kaligrafi delikate
Që mua më kujtojnë veç rënkimet e saj me vija të drejta dhe rrathë
të përsosur,
Në shtratin e madh të shtëpisë time. Qe pasdreke. Ajo mbështeste
kofshët e saj
Rreth qafës time. O Zot, sa të lumtur ndjeheshim të dy, të çveshur.
Nuk donte t'i largonte kofshët e veta, dhe qeshte.
Flisnim tek tuk me një sintaksë lakore ndonjë fjalë të vetme,
Si një totem fatsjellës të indogjenëve të Australisë së Eperme.

Dhe veç tani pasi lexoj letren e saj plot rënkime
Të ngjashme me ato rënkimet e saj të singerta, sepse qenë natyral-
iste,
Më kujtohet sa shumë e doja. Dhe se dhe ajo
Kohë pas kohe më donte aq shumë, sa harronte të fliste!

JO SI BRITNEY SPEARS

*Just take it all as a sign that we're through
(Ah, c'mon) (Goodbye)*

tregim nga Shqiptar Oseku

Punonjësja sociale nuk dukej aq e rrezikshme, në fakt. Kur u hasëm për herë të parë, mendoja se nga dera do të hynte një grua strikte, buzëhollë e me syze të trasha, ashtu si m'i kish përshkruar mami. Por Lela me xhinsat e bardhë dhe sandalet e verës dhe flokët me rruaza dhe airpods dhe thonjtë me xixa dhe sytë e shkruar ishte... epo, nuk është strikte buzëhollë, këtë dua të them. Është si Britney Spears, që e kam xhan. Buzët i ka normale. Syze s'ka. Dhe sytë e saj, s'janë vetëm të shkruar. Ose, janë të shkruar vërtet, por janë edhe shumë miqësorë, e kuriozë, e të qeshur, e seriozë nganjëherë, e thumbues nganjëherë, por më shpesh mirëkuptues; më shumë sy të një shoqes së ngushtë, ashtu si mendoj unë se do të kish qenë shoqja e ngushtë, po të kisha patur një të tillë, se sy të punonjësës sociale.

Është kaq e padrejtë kjo që them, sorry sorry, nuk dua ta teproj. Unë në fakt s'kam idenë si duken punonjëset sociale, s'kam hasur kurrë vetë ndonjë syresh, imazhin për to ma kanë sajuar rrëfimet gazmore e histerike të mamit, *there's too much of this noise*. Mami është gruaja më fatprerë në botë, e thotë këtë shpesh vetë, e prandaj ajo ka takuar vetëm punonjëse sociale të liga. Mami është edhe gruaja më e mençur në botë, e ua ka hedhur gjithmonë punonjëseve sociale. Por mua Lela s'më dukej e tillë. Ajo s'dukej fare si punonjëse sociale. Ajo qe si... epo, qe Lela!

Kur u takuam herën e parë, ajo erdhi në shkollë. Sorry sorry, t'ia nis nga fillimi: gjithçka qe faji im. Unë kisha shkruar në shkollë me rroba të pista dhe flokë të pakrehur, motra ime e vogël Nina poashtu. Nuk qe faji i mamit, të betohem që jo, ajo më ka mësuar të laj njollat nëpër vende të dukshme, që rrobat të mos duken të pista. Ajo më ka mësuar edhe të kreh flokët, edhe flokët e mi, edhe të Ninës. Gjithçka që di, mami ma ka mësuar. Ajo është mami shumë e mirë. Por ne u zgjuam vonë, se kishim fjetur vonë prapë, e Nina po luante prapë me atë kukullën e vet të nëmur në vend se të vishej, e çelësi i shtëpisë ish zhdukur prapë... epo, kupton se ku dua të dal. *Oops, I did it again!*

Kush ngutet përmutet, thotë mami. Sikur të mos mjaftonte tërë kjo, edhe Ninën e zë gjumi në orë të mësimit. *You drive me crazy*. Dhe mësuesja e saj e marrë, kish thirrur menjëherë shërbimet sociale. Bah.

Më kujtohet si m'u qas, mësuesja e marrë e Ninës, në kohën e pushimit të gjatë. Fustan gri, triko gri, syze gri. Ajo po që është strikte buzëhollë. A vjen me mua Mira, duhet të flasim pak, bla bla blaha. Në zyrën e saj ishte edhe Nina e trembur, me atë kukullën e vet të nëmur në dorë. Ajo m'u gjuajt në grykë, më fal Mira, s'di as vetë si m'u mbyllën sytë. Si je ti Mira, nuk dukesh mirë (jemi perfekt). Si i ke punët në shtëpi (janë perfekt). Kam vënë re se të bien notat kohëve të fundit (*ups and downs*), se vjen edhe vonë nganjëherë (na ikën autobusi) (edhe Nina s'fien vërtet zyshe, vetëm shtiret sikur fien). Ç'është kjo kukull e pistë kështu (e bën pis Nina kur loz). Ne në shkollë ndihemi një fije të brengosur për ty kohëve të fundit (s'ka pse, vërtet s'ka pse) dhe kemi thirrur një punonjëse sociale (po pse kot zyshe, s'qe nevoja) po ja që të na ndihmojë të kuptojmë se ç'po ngjan kështu me ty... kohëve të fundit.

(E di unë pse ndieni ju të gjithë një fije brengë, kohëve të fundit. Se e ndiqni kot mamën, qëkur iku babi. Por babin s'e përmendni kurrë.)

(*Wanna know, do I make you uncomfortable...*)

Kur erdhi Lela, zyshja e prezantoi si punonjëse sociale. Por vetë Lela, ajo u prezantua vetëm me emër. Tatjeta unë jam Lela, ja kaq. Nisi të na dëftonte që e kishin thirrur shkolla pse ishin ndier një fije të brengosur, ishte gjë normale dhe e kërkonte ligji; ajo dukej e gjitha si një smiley gazmor dhe Nina vajti u ul me kukullën në prehër të saj. Nina! Pastaj zysha kërkoi ndjesë e doli, ne ngelem vetëm me Lelën. Diku aty Lela i dha një të qeshur të patrazuar, se ç'po fliste me Ninën, dhe kjo më bëri mua, s'di. Që t'i besoj. Lela qeshte, s'di si ta them, *born to make you happy*. Si pranvera. A si shiu i verës, kur breron mbi atë llamarinën që kemi në oborr. Sorry sorry, unë s'jam Britney Spears dhe s'di si të përshkruaj qeshjen e Lelës. Por ajo ta merrte kalanë nga brenda, kaq di të them. Kështu thotë mami nganjëherë, për njerëz që i pëlqejnë. Mua Lela më pëlqente. Lela ta merrte kalanë nga brenda.

Natyrisht, ne s'i thamë se na mungonte babi. Sot kur mendohem, nuk e di se pse. *Toxic*. Ndoshta pse shkolla ishin të brengosur një fije, kohëve të fundit, ndërsa s'e përmendin babin kurrë. Lela tha se kur je fëmijë, heshtja e të rrit-

urve ta bën qimen tra. Por edhe një fëmijë arrin të kuptojë se ka ndodhur diçka kur ndodh diçka; ne fëmijët s'jemi aq idiotë sa mendojnë të rriturit. Sidomos jo unë, unë nuhas gjithçka. Si ta zëmë, atë ditë kur na la babi. Ja ajo ngjarje, ndonëse e madhe, s'do të kish qenë aq e rëndë ndoshta, s'e di. Sikur të rriturit të uleshin, e të na tfillonin disi se çfarë kish ndodhur. Se çfarë do të ndryshonte konkretisht, për mua, e për Ninën. Por kur të rriturit heshtin. Kur nuk zënë në gojë atë që ndodh. *Toxic!*

Pra s'folëm me Lelën për babin: por folëm për tjerat. Për shkollën, për zyshën e sertë, strikte buzëhollë (edhe Lelës i dukej fiks ashtu), për detyrat, për shokët e shkollës. Kur u ndamë, pse trokiti në derë zyshja që kish mbaruar punët e veta, Lela na tha se do të takoheshim prapë nesër: dhe hey, për çudi, ashtu ndodhi. Them për çudi pse të rriturit gjithmonë, *gjithmonë*, bëjnë të kundërtën e asaj që thonë. Por ajo erdhi ditën tjetër, e ditën tjetër, e ditën tjetër prapë. Zyshja na mblidhte, zyshja na ndante. Lela nisi të më pyeste edhe për motrën time, e për kukullën e saj. Dhe pa prituri e pa kujtuar, *bang*, isha hapur edhe për mamin. Për burrat e saj. Për dehjet. *Hey hey hey, so look who's talking now*. Si dreqin ndodhi kjo? Ec e më thuaj! S'ta kam idenë, të betohem. Do të ketë qenë figura e Lelës, me xhinsat e bardhë dhe sandalet e verës dhe flokët me rruaza dhe airpods dhe thonjtë e shkruar dhe sytë gjithë xixa... kishim harruar që po flisnim me një nga ato. Punonjëset sociale. Ishte bërë si shoqe me ne. Dua të them, Nina i ish ulur në prehër. Nina!

Dikur m'u kujtua edhe mua budallaçkës, se kishim kaluar kufirin. Se kishim përmendur gjëra që s'duhej të ishin përmendur. Kur më mbui kjo kuptesë, teksa po flisnim herën e radhës, m'u ndal fryma nga frika. U ndala në gjysëm të një fjalie, si të më kish goditur rrufeja, e një dorë e akullit ma shtrëngoi zemrën në grusht. *Oops!* Lela e kuptoi menjëherë se çfarë po ndodhte. Mos ki frikë, më tha ngadalë, sikur s'donte ta trembë Ninën. Kjo ngel midis nesh. Mua këto fjale më frikësuan, *absolutely*. Nëse ka diçka që di për të rriturit, është një gjë e thjeshtë. Të rriturit thonë gjithmonë, *gjithmonë*, të kundërtën e asaj që bëjnë.

(Ja si babi: kur iku, tha se do të ktheheshin pas pak. Natyrisht.)

Kur mbaroi ai takim e u kthye zyshja në zyrë e u ndamë me Lelën e u nisëm për në shtëpi, aty te ura e gurtë mbi lumë, nisa të kërcëlloj dhembët nga një acar që po më përshkonte trupin anepërtej. E pra jashtë ishte vapë, hej njëqind gradë Celsius a diçka. Nina po luante e këndonte me kukullën gjithë rrugën, e pe Mira sa e mirë Lela, mua më pëlqeu Lela a të pëlqeu ty, unë dua të takoj prapë Lelën a do ti. S'di as vetë si ndodhi, por i mora Ninës kukullën. E ia flaka, drejt e në lumë. Nina më pa një çast e tronditur, syshqyer, gojëvarur, imazh i gjallë i stepjes e moskuptimit e dhembjes bashkë. *'Cause all we had is broken like shattered*



glass. Pastaj i dha një klithme që, të betohem, i zgjoi dhe të vdekurit ndër varre, e m'u gjuajt mua me grushtat e vet të vegjël. Kukulla ime, kukulla ime, ma dha babi. Dua kukullën time.

Gjithçka mbaroi në të vetmen mënyrë në të cilën mund të mbaronte. Me ne dy në vrap skaj lumit duke ndjekur kukullën plastike që po notonte larg e më larg, gjersa e zumë dikur, pothuajse te varret e qytetit. Aty kukulla ngeci te një degë lisi që kish ngelur gjysëm e zhytur në ujë. Ne hymë, me njëfarë rreziku për veten, e shpëtuam kukullën. Vetëm kur dolëm, të dyjat të lagura e të kapitura, kuptuam se ku kishim mbërritur. *Your breath like ghosts that disappear*. Pushuam ca kohë, sa të thaheshin pak rrobat (nuk u thanë). E pyeta Ninën nëse donte të vizitonte babin.

(Ajo më tha jo pa më shikuar, duke ndrequr palët e fustanit të kukullës së vet.)

Kur erdhëm në shtëpi, e kuptova menjëherë që mami ishte e zemëruar. Por ajo e mbajti veten. Na pyeti se pse isha ashtu për ibret dhe unë i thashë se kishim luajtur me një zorrë uji të komshive, mami s'e zgjati më tej. Atë natë hëngrëm në heshtje dhe mami nuk piu. Ta ketë thirrur vallë Lela që atë ditë? Nuk e di. Por di se ai burri pijanec që fien tek ne nuk erdhi mbrëmë. Edhe gjërat e tij janë zhdukur nga shtëpia: është si të mos kish qenë kurrë.

(Të rriturit e kanë këtë, që zhduken pa gjurmë. Si në për-ralla. A në filma.)

Por sot na trokiti në derë Lela, me xhinsat e bardhë. Lela me sandalet e verës, e flokët me rruaza, e airpods. Lela me thonjtë gjithë xixa, e sytë e shkruar. Mami na tha të luanim në oborr, se ajo dhe Lela kishin për të kuvenduar. Nina më hodhi një shikim gjithë frikë. A nuk tha Lela që do të shiheshim në shkollë?! Nina e vogël, vetëm tashti po e merr vesh. Të rriturit gjithmonë, *gjithmonë*, thonë një gjë e bëjnë një tjetër.

Nuk di se çfarë po i thotë Lela mamit, por vë bast e di se çfarë i thotë mami Lelës. I thotë se jeta vazhdon, por se s'është hiç e vërtetë se çfarë s'të vret të forcon. Se çfarë s'të vret të sakatos, të bën të çalë për jetë. Këto janë fjalët e preferuara të mamit. I thotë se edhe gruaja është njësoj si burri, se edhe ajo shkërdhehet e dehet për të harruar. Por burrat që bëjnë ashtu ngelin disi prapë burra, pse quhet burrnore të shkërdhehesh e të dehesh. Ndërsa gruaja humb graninë e njerëzinë në sy të të tjerëve. Ajo s'quhet më njeri. Mami im, rebele me sy të perënduar. *I'm in a rebellion/And I'm up against the truth/So will you join me/Or will you be taken too*.

Do të duhej së paku të thotë kështu, mami. Por dyshoj se s'do të thotë asgjë, se do të heshtë siç e ka zakon. Mami është si unë, si Nina. I thotë mbase gjërat në kokë të vet. Por s'i nxjerr të palarat jashtë kur dëgjojnë tjerë. Jo si ti, Britney. As ty s'të doli puna mirë, kur i nxore të palarat sheshit. Përkundrazi. Edhe ti ke një babi që kontrollon jetën tënde. Jo me mungesë, si babi im. Por me prani. Etërit ashtu janë, Britney. Me prani, a me mungesë, ata kontrollojnë jetët tona. *Ooh papi, love you, mm papi, love you/You love it when I'm freaking out/Things get rough and there's no doubt/(You will always be there for me)*.

Duhej ta kishe parë, Britney, tek iku Lela, me xhinsat e sandalet e thonjtë. Ajo na përshëndeti solemnisht te dera. Na përqafoi, na puthi, na tha se do të kthehet përsëri. Unë ngrita supet. Natyrisht, Lela s'u kthye kurrë më. Supozoj se gjeti diku një punë tjetër, në një distrikt më të mirë. Diku, them, ku etërit s'vdesin papritur në trafik. E ku mamatë kanë lekë në bankë, punë zyresh, e s'dehen për të harruar. Diku ku të gjitha vajzat e vogla që lozin me kukulla në ulëse të pasme mbijetojnë, pse kanë xhinsa të bardhë, e airpods, e thonj e sy xixëllues.

Mbasi ikën Lela, mami vjen të më përqafojë. Bija ime, bija ime, më thotë e përlotur, e më mban në grykë. Më vjen keq, më vjen keq. E di që të mungojnë babi e Nina. Edhe mua më mungojnë.

Unë i kam zët këto përqaftime të mamit. Sorry sorry, por janë gjithë agushi, e angështi, e ufëm, e duhmë të mefshtë trupi, një si agoni e pafundshme brenda një pusi që s'ka skaj e s'ka mbarim. Mua më duket më shumë si një shtrëngim ankthi se një përqafim. Është thuase mami kërkon të më shndërrojë, të më ndryshojë disi. Të më shërojë.

Por unë s'dua të ndryshoj.

Why should I be sad? Heaven knows!

*From the stupid freaking things that you do
(Stupid freaking things)*

Why should I get mad? Feel sad? Who knows?

Just take it all as a sign that we're through

(Ah, c'mon) (Goodbye)

Ndoshta kur të rritem bëhem artiste si Britney. Zyshja thotë se shprehem mirë. Por unë shprehem mirë vetëm në shkollë, jo në shtëpi. Ta zëmë Nina, ajo pyet nganjëherë për Lelën, teksa luan me kukullën. Mira sa e bukur ishte Lela, a të kujtohet, si kukull. Mira a do të kthehet Lela ndonjëherë. Ajo tha se do të kthehet prapë. Unë vetëm ngrem supet, i them s'di. Por unë e di. Se unë s'jam bebe, që të loz me vetveten. Unë e di, natyrisht. Të rriturit bëjnë gjithmonë, *gjithmonë*, të kundërtën e asaj që thonë.

Shishja e rakisë ndodhet ende në komodinë. Mami thotë se s'do të pijë më. Por s'do të më befasonte sikur, kur të kthehem një ditë nga shkolla, ta gjej tapë në dysheme.

(Edhe ti babi the se do të ktheheshit. Natyrisht.)

(Por s'u ktheve më.)

TIRANA

Ato re që lundrojnë mbi qiejt e mallit tim krahas aromave të luleblirit, më sjellin herë herë edhe zhurma dhe zëra kryeqyteti. Tirana nuk është larg prej këtej, por sa herë që kalon muaji pa u parë me të, mua, i dashur, kilometrat më shumëfishohen çuditshëm. Nuk di se çfarë arome ka qyteti yt, por unë të them që Tirana ime shpesh më krijon idenë se i ngjan një gruaje të bukur, që pasi i deh të tjerët me bukurinë e saj, deh dhe vetveten, sepse qytetet e bukur janë dhe pak narcisë, apo jo?

Jo, të lutem, mos i kundërsh-to këto që të them. Është e vërtetë që kohët e pakohë i vranë kujtimet tona dhe e shndërruan këtë qytet nga një Eden dashurie, në një metropol të zhurmshëm dhe të betonizuar keqas. Është e vërtetë që për të numëruar mëkatet e tij, do të na duheshin muaj dhe vite. E megjithatë unë ia fal të gjitha këtij qyteti. Vetëm ky diti të më dhurojë atëherë buqetën e parë të lule mimozave të porsa çelura, diti të më drithëronte dhe të më bënte me krahë kur më the se unë isha me e bukur se gjitha vajzat e tjera. A të kujtohet sa e bukur na dukej lulja e kumbullës së kuqe mbas puthjes sonë të parë dhe transformimi në një muzikë të këndshme i zërave të njerëzve që kalonin pranë nesh. Po stinët që ishin varur mbi krahët e zogjve?

Tirana s'është larg prej këtej. Sa një fërshëllimë e zgjatur malli dhe nostalgjie, sa një sirenë e zgjatur lokomotive, ngarkuar me të dashuruar ose sa ndjenja magjike e vargut të parë dhe të fundit në poezinë time të sapo shkruar dhe asaj që nuk e kam shkruar akoma. Sa një ëndërr bukur apo sa një amshim mbushur me shumë dashuri. Një qytet që di të dashurojë dhe di t'i ndajë kujtimet me të gjithë ne, asnjëherë nuk është larg. Unë e ndjej dhe e shikoj atë, ndonëse më ndajnë malet dhe detet. Është një qytet që ne i besojmë përrallat tona të dashurisë sa herë që ndihemi të mërëzitur dhe ai vazhdon besnikërisht të na besojë gjer në pafundësi...

ODISEU

Unë dhe ti jemi njohur pikërisht në momentin kur akrepat e orës u takuan si përherë tek dymbëdhjeta. Grumbulli i rrezeve të

diellit i ngjante flokëve të pakrehur në një natë të pagjumë. Sapo ishte çliruar mëngjesi nga përgjumja dhe unë sapo kisha mbaruar kapitullin e parë të librit të zgjimit dhe kisha një etje të çuditshme për të folur. I pari që më foli në atë moment ishte malli, ai që më kish zënë pritën në një cep.

Në atë çast po shihja lëvizjet e ngutura të akrepit në fushën e orës dhe po mendoja se sa të bukur i bën çastet e saj dashuria. Po mendoja momentin kur Helena u gjet për herë të parë në krahët e Paridit apo edhe natën e parë të dashurisë së Penelopes me Odiseun.

Në çfarë shkretëtirë të verdhë mund ta kthejnë gjoksin e një burri emocionet dhe dehja e momentit! Ç'mund t'i falë çastit portreti yt pas shtatë malesh! Unë e kam provuar atë çast kur treni frenoi dhe nga një vagon i zakonshëm zbritte ti. A

ishte ti Odiseu im që zbret në Itakë, ndonëse as ti e as qyteti s'kishin asgjë të përbashkët me imazhet e mia antike!

Unë i jam afruar dëshirave dhe dashurive të mia deri në fagen e fundit. Më tej nuk kam dashur t'ua mbylli kapakët. I kam lënë ashtu, te hapura, që t'i prekë malli yt në çdo grimcë, malli i Odiseut...

ANIJA

Drita që lëviz nëpër damarët e ujërave, i zgjoi varkëtarët nga gjumi i mesditës, kurse varkave të bregut ju qepi mbi kyç nga një vel të artë në formë gjethi. Kjo ndodh pikërisht në momentin kur

PROZË E SHKURTËR NGA NEVIANA SHEHI



pasqyrat e ujërave thyhen dhe një mërmërimë e thelle qenie misterioze bëhet mbizotëruese e bregut.

-Nga cilat tablo impresioniste duhet të ketë dalë kjo mbrëmje, nga Salvador Dali apo Pikaso?, - më pëshpërit një zë i brendshëm.

S'më duhet përgjigje, sepse unë mund t'i besoj vetvetes vetëm një metaforë perëndimi, ndërsa të tjerat ia besoj këtij peizazhi enigmatik.

Tërë mbasditen ujërat dhe bregu grinden keq me njëri tjetrin, kurse në mbrëmje ju ngjajnë të dashuruarve që vetëm këmbëjnë puthje njëri me tjetrin.

Shëëësh, mos i trembni magjitë e përkundjes së anijeve, as pikturën e shkëmbinjve të bregut në pritje të zbaticës, - sërish e dëgjoj atë zë të brendshëm, i cili më duket se vjen nga thellësitë e detit.

Dhe, pastaj ia beh perëndimi. Dhe bëhet mirë, mbase akoma më magjike, sepse yjet me siguri do të fyheshin nga mospasja mundësi të shndrisin qiellit të errësuar dhe të futen në ëndrrat e të rinjve, të cilët presin të marrin rrugën e të arrijnë në ujdhesën e të dashuruarve. Anija është gati dhe varkëtarët ngrenë spirancën e lëshojnë velat. Dikush valëvit shaminë e përshëndetjeve...

BURRI IM I VJESHTËS

Tre herë të pyeta dhe të tria herët ti nuk m'u përgjigje. Nuk më kujtohet se kur ndodhi kjo. Në kufirin mes fjalës sime dhe heshtjes tënde lëviznin pareshtur tufa të zeza me zogj dyshimesh. Ndonëse fjalët binin prej qiellit, përgjigje kurrë nuk mora prej teje. Ndoshta kjo ndodhi sepse kufij pyjesh të lëvizshëm dhe silueta të frikshme drurësh nxitonin në krahun e kundërt të përfytyrimeve të mia. S'mund të them se sa qiej kishin ndërruar vetveten përpara se të njiheshim bashkë. Ditën e parë që të pashë ka qenë fillim-jave dhe autobusët plot pluhur nxitonin për diku dhe gjithë njerëzit mbanin në fytyra maska. Njerëzit me maska në këtë kohë maskash, s'janë tjetër përveç se ca sklevër fatkeq që përgatiten të shoqërojnë faraonin e tyre në udhëtimin e fundit. Shoqërues kufomash, mbikëqyrës fatësh të vdekur. Kur jemi njohur e kam ditur që ti dhe shirat do të dilni shpesh në hapësirat e vjeshtës, në ndjekje të reve të bardha. Para kësaj nuk të kisha parë. Tani që të pashë, dua të vij edhe unë mbrapa teje, burri im i stinës së vjeshtës...

Përsiatje rreth romanit “I kam shërbyer mbretit të Anglisë” të Bohumil Hrabal”

NJË AFRESK BURLESK SI NJË GAZ-A-VAJ QË NA MAHNIT

Nga Josif Papagjoni

Rugës për Sarandë kinoregjisori i njohur Piro Milkani më dhuroi një roman të shkrimtarit të shquar çek Bohumil Hrabal: “I kam shërbyer mbretit të Anglisë”. Ai e kishte përkthyer atë kohë më parë, ndofta kur ishte ambasadori ynë në Republikën e Çekisë. Ai e njihte mirë çekishten sepse aty edhe e kishte mbaruar shkollën e lartë për kinematografi. Romani dhe vetë shkrimtari ishin një zbulim për mua. Nuk kisha lexuar kurrë prej tij, ani pse ai ishte ndër më të mëdhenjtë shkrimtarë çek, i barabatur me Jaroslav Hashek, Karel Čapek dhe Milan Kundera, i përkthyer në 27 gjuhë të botës, dhe diç të tillë e dija. Romanet e tij “Perlat e thellësive”, “Leksion vallëzimi për të moshuarit”, “Trenat e vëzhguar rreptë”, “Vita nuova”, “Kafeneja botërore”, “Balada vrastare dhe legjenda të tjera”, “Barbarët xhentilë”, “Hidhërimi i bukur”, “Në shtëpinë e dasmave”, “Duke e prerë shkurt”, “Milionat e Harlekinëve” etj., e kanë bërë këtë shkrimtar në syrin e lexuesit një mjeshtër i të thënave të të vërtetave përmes dyzimeve të njëpasnjëshme dhe një ambiguiteti të gjithpranishëm, ku nuk merret vesh ku është realja dhe ku trillimi pa të keq, ku hareja dhe ku loti i fshehur pas një fraze të shpenguar. Dhe teksa e lexoja romanin e tij të famshëm “I kam shërbyer mbretit të Anglisë”, në syrin tim hyri një botë e trazuar, një aventurë njerëzore që shkonte cep më cep pa e “çarë kokën”, si vrap i një pele të hazdisur dhe hergjele, e gjitha e rrëfyer me një frymë, nën një shpoti të pamëshirshme për kohët, ideologjitë e rrejshme

dhe indoktrinimet, për vuajtjen dhe përpjekjen për t’i përballuar me stoicizëm ato, shpesh falë një vetëbesimi dhe moskokëçarjeje sfiduese. Aty lëvizte me shpejtësi brenda “një jete”, krejt jeta. Qenë pranë e pranë egërsia dhe bukuria. Të dyja së bashku vejevinin brenda një çasti, një dite, një jete; vejevinin dhimbja njerëzore e përzier me ndjesitë, sjelljet dhe praninë e kafshës, mik i njeriut, i vetmisë dhe i mizantropisë së tij. Turavrapi atyre fletëve po aq pasioni për punën, të veçantën, të bukurën, turavrapi magjia e lirisë, gjente një strehëz prehjeje nevoja e njeriut të marginalizuar e të dëbuar për vetminë, heshtjen, natyrën dhe personalitetin. Është pikërisht siç e pohonte edhe vetë shkrimtari: “Atë muaj vere kur e shkrova këtë tekst, jetoja nën ndikimin e fortë të “kujtimit artificial” të Salvador Dalisë dhe të “dashuri e ndryshur”, që sipas Frojdit “shpërthen te gjuha””.

Pra një jetë dhe një dashuri, që shpërthen te gjuha (e cila duket se i shpërthen vargonjtë e saj sintaksorë, rreptësinë e shenjave të pikësimit dhe brendh “rrëmujshtëm” në një narrativë të çlirët e pa mëgojza); një jetë dhe një dashuri që na duket krejt-krejt e çuditshme, “qesharake”, si e pabesueshme, me dy krerë, tokë e qiell bashkë, llum e rrëzë përzier, ujë i pisët kënetë dhe ujë qelibar prej burimeve malore, ku e besueshmja dhe e pabesueshmja bëheshin po bashkë, edhe tragjedia e komedia po bashkë, e bukura dhe e shmëtuara, e hirshmja dhe e neveritshmja. Një “çorbë” apo amalgamë alla Salvador Dali. Dhe të habiste fakti



by fate velaj

se si ti kaloje nga realja te surrealja. Dhe ecejakeshin të dyja këto te njëra-tjetra, përherë së toku, në marritë a bukuritë e tyre, duke përplotësuar mrekullisht shoqi-shoqin. Fillimisht kjo “rrëmujshtë” e paramenduar sikur më lodhi ca, por pastaj umësova dhe si lexues ia hipa gjogut vërvëlitës të Buhomilit dhe i graha për mrekulli pyjeve, ujëvarave, shkretive dhe rrëpirave ku ai më çonte, tek ato aventura që vështirë se mund t’i përfytyroja.

...Dhe ja tek e ndiqja djaloshin shtatshkurtër, që zgjaste qafën të dukej më i gjatë për lezetin e syrit të femrave, teksa shkon “pikolik”, ndihmës kamerier, në një restaurant në Pragë para Luftës II Botërore, njohja me zakonet dhe sqimatarët e hoteleve, gatimeve, klientëve të klasave të ndryshme, fisnikët që humbin mes fustaneve dhe mishit të vashave të “porositura”, thënë ndryshe prostitutave, dashuritë e fshehta dhomave duke u arratisur nga burgjet e grave pa shije dhe rituali i lodhshëm i familjes, shoqërisë, për të kërkuar pak liri, dalje nga vetja, dehje, zëdhallje, gjer te një president që vinte aty, në hotelin mes pyjesh me të dashurën e tij, dhe ashtu përthithur sy më sy, pasi pinin e pinin, ia mbathnin pyllit të vetmuar, hiqnin petkat e ritualit, bënë dashuri, thithnin atë pak lumturi të munguar dhe aq të ankthshme, për t’u riveshur sërish me kostumet dhe kopsat e shumta zyrtare dhe për të shkruar rishtazi drejt “rregullit”, “moralit”, “fisnikërisë”, “ndershmërisë”. Ose një gosti e orgji në pritje të perandorit të Etiopisë, më verëra, erëza, lëngje e gjellë të papara, që i shkulnin njerëzit nga “llogoret” e sqimës prej fisnikësh e zyrtarësh hijerëndë të shtetit dhe i bashkonin që të gjithë në një ekstazë marramendëse, çliruese e çudane.

Mes këtyre njerëzve e kësaj zallamahije vërtitet edhe hero i ynë shkurtbajq, por i zgjuar e me sqimë, me pesë copëzat që e përbëjnë romanin: “Një gotë limonatë”, “Hotel Qetësia”, “I kam shërbyer mbretit të Anglisë”, “Dhe kokën nuk e gjeta më”, “Si u bëra milioner”. Secila nga këto pjesë a novela qëndron edhe më vete, por të pesta ofrojnë një strukturë romanore që i lidh e i bashkon aventura e personazhit të saj, paçka se i paemër; është po ai “Unë” letrar, i kudogjendshëm i rrëfimit në vetë të parë. Aty ai provon së pari trupin e femrës teksa pleqtë i nderzullonin ato më herët dhe ai priste më pas orgazmat e tyre të tërbuara mbi trupin e tij; aty u njoh me një gjermankë, Lizën, idhtare e “racës së pastër ariane”, martesë me të cilën kërkonte të vërtetonte pastërtinë e gjakut të tij për të qenë i denjë kundruall saj; me të edhe lind një fëmijë të gjymtë që ngulte natë-ditë gozhdë në dysHEME, mijëra e mijëra gozhdë, të cilat u bënë vuajtja, ndëshkimi dhe stërmundimi i tij si baba, një metaforë e bukur kjo, por e thënë, si për dreq, me aq shpoti; aty ai përcjell gjithë tmerrin e luftës, segregacionin racor e nacional, oficerët gjermanë që takonin për të fundit herë gratë e tyre para se të shkonin në frontin rus, ku me siguri nuk do të ktheheshin më; aty e përcolli edhe çlirimin e Çekosllovakisë, ardhjen e komunistëve me shtetëzimet, dëbimet, internimet, zhbërjen e bukurisë së jetës dhe thatësirën shpirtërore që ata sollën; dhe po aty vjen edhe një nga skenat më të mrekullueshme, më prekëse, sidomos filozofike, të rrugëtimit të heroit në thellësitë e pyllit, si mirëmbajtës rruge, me një karrocë dhe katër shokët e tij të pandarë: kalin, qenin ujk, dhinë dhe macen. Këtu gjithçka merr një tjetër konotacion. Kafshanjeri qenka më e keqe se vetë kafsha. Kafshërimi që ka mbuluar vendin me komunistët dhe komunizmin, edhe pse nuk tregohet, nënkuptohet. Është kjo metaforë e jashtëzakonshme që Buhomil na e sjell gjithë mprehtësi e që na e lëndon fort shpirtin. Është ajo mace e egër që ka nevojë për ushqim dhe për dorën e njeriut, por frika dhe instinkti e lënë gjithnjë pas, gjersa një ditë ajo e pranon



dorën e heroit që t'i fërkojë kokën e të shtriqet, kur kafshët-njerëz vrasin qenin ujk, mikun e tij dhe mikun e saj. E si mund të shprehej vuajtja më mirë se kaq! Kafsha ishte më njeri se njeriu!

Siç vetë romani është pa “pika e presje”, me fraza të gjata, të pareshtura e të padisiplinuara nga sintaksa, mu si një rrjedhë ndjesish, mendimesh e aventurash duke ndjekur teknikën e “përroit të ndërgjegjes”, ashtu të rrëmben edhe fati i personazhit, një kamarier i ardhur diku nga thellësitë dhe që falë talentit dhe vullnetit të tij bëhet një mjeshtër, i quajtur ndryshe “kamarieri që i ka shërbyer perandorit të Etipoisë”, më pas një hotelier, dhe akoma më pas një pronar i pasur, saje aftësisë dhe fantazisë së tij për të gjetur të bukurën dhe të veçantën aty ku mendja e fjetur nuk e gjente dot.

Dhe të duket sikur në “rrëmujën” e rrëfimit, që s’është veçse stili i shkrimtarit, formë postmoderne e ligjërimit romanor, ti kridhesh në atë dramë njerëzore, madje shoqërore e kombëtare, por ndryshe: duke tallur veten dhe të tjerët, pa ia hequr syrin ironik gjithë asaj çka ngjet, edhe pse në brendësi aty gëlojnë dukuri e veprime të vrazhdëta, dramatike e tragjike, në zgrip të mbijetesës dhe buzë vdekjes. Kjo mënyrë rrëfimi e Buhomil Hrabal, ku e besueshmja dhe e pabesueshmja, logjikja dhe absurdja, e njëmendëta dhe e sajuara, realja dhe surealja pleksen aq mrekullisht, na bën saora që aty të mprehim mendjen dhe të reagojmë ndaj jetës njerëzore të rrëfyer si një gaz-a-vaj, dhe po aty të qeshim tok me autorin për shpotinë që ai përdor duke u tallur dhe duke asgjësuar çdo pasion, çdo veprim e situatë, sado e trishtë a dramatike qoftë. Vetironia e shkrimtarit në rolin e heroit letrar kthehet në një ironi tërësore, për gjithçka dhe për të gjithë. Është një afreskë burleske si një gaz-a-vaj që na mahnit.

Që të shpjegosh stilin e Buhomil Hrabalit të duket vetja i pafuqishëm për ta thënë më bukur se vetë ai, me gojën e tij, se si lindi ky roman dhe në ç’mënyrë u ngjiz: “Këto radhë janë shkruar nën diellin përvëlues të verës që e ndizte aq fort makinën e shkrimit sa që disa herë në minutë ngecte e bëlbëzonte. Duke mos i parë dot fijet e letrës së një bardhësie verbuese, nuk arrija të kontrolloja ato që shkruaja, shkruaja pra në mënyrë automatike në një dalldi drite, drita e diellit më verbonte në atë pikë sa shihja vetëm siluetën e ndritshme të makinës së shkrimit, mbas disa orësh kapaku prej alumini ishte aq përvëlues sa fletët e shkruara rrotulloheshin nga nxehtësia. Dhe duke qenë se ngjarjet e këtij fundviti po më binin në kokë pa më lënë as kohë për vdekjen e nënës, këto ngjarje më detyrojnë ta lë tekstin ashtu siç është hedhur në dorë të parë, e të shpresoj se herët a vonë do të kem kohë dhe kurajo t’i futem përsëri e të djersit mbi të, ta lëmoj e ta përpunojë drejt një lloj perfeksioni klasik ose – i ndikuar nga frymëzimi i momentit dhe me rrezikun se mund të fshijë spontanitetin fillestar të imazheve – t’i fus gërshërët tekstit dhe me frymëzimin e çastit të heq në to ato imazhe, të cilat edhe pse ka kaluar kohë, e ruajnë ende freskinë. Dhe në qoftë se nuk do të jem më në këtë botë, le ta bëjë këtë ndonjë nga miqtë e mi. Le të nxjerrë nga kjo një novelë të shkurtër apo një tregim të gjatë. Kjo është e gjitha.”

E shikoni se si ka qejf të shpotisë e të tallet edhe me vetë mënyrën e të shkruarit të tij Buhomil Hrabal, kur këtë roman e ka parë dhe stërparë aq e kaq herë?! E atypëratyshmja, e papërfunduara, e rrëmujshmja, vetëtallja, ambiguidja është, në të vërtetë, një mënyrë vetjake të shkruari, stili i tij, autorësia e vetë Hrabalit...



JHUMPA LAHIRI

Mbi kënaqësinë e përkthimit si një zbulim

Përkthimi më shtyn të rikonsidërojer, thelbësisht, si shkruaj dhe pse. Librat që kam shkruar që prej *In other Words* – romani *Dove mi trovo*, një libër me poema i quajtur *Il quaderno di Nerina*, dhe një përmbledhje me tregime e quajtur *Racconti romani* – kanë ecur në një rrugë paralele me përkthimin tim, deri tani, të tre romaneve nga Domenico Starnone (*Ties*, *Trick*, dhe së shpejt *Trust*), tregime të ndryshme që kam përkthyer për *The Penguin Book of Italian Short Stories*, dhe tani, nga latinishtja, një bashkëpërkthim i *Metamorfizat* e Ovidit.

Përkthimi më tregon se si të punoj me fjalë të reja, si të eksperimentoj me stile e forma të reja, si të marr rrezeqë më të mëdha, si të strukturoj dhe shtresëzoj fjalitë e mia në mënyra të ndryshme. Leximi më ekspozon ndaj të gjithë kësaj, por përkthimi shkon nën lëkurën time dhe shkund sistemin, aq sa të gjithë këto zgjidhje shfaqen në mënyra të papritura dhe zbuluese. Ekosistemi i veçantë që përmban latinishten, italishten, dhe anglishten e bën italishten më të njohur dhe anglishten më mrekullisht të çuditshme.

Vëmendja që kërkon përkthimi ndaj gjuhës, po e leviz veprën time jo vetëm në drejtime të reja por në një dimension gjithnjë e më shumë të fokusuar gjuhësisht: nuk do të kisha filluar kurrë të shkruaja poezi pa ekspozimin intim me gjuhën italiane që vetëm përkthimi mund ta bëjë; ky ndryshim ishte veçanërisht surprizues duke qenë se nuk kam shkruar kurrë poezi në anglisht.

Gjithashtu, përkthimi punon në një shpejtësi ndryshe në krahasim me shkrimin – skica e parë mund të lëvizë më me shpejtësi, por pasi filloj ta rishikoj, mund të kaloj orë të tëra duke luajtur me një fjalë të vetme, ose duke medituar mbi një fjalë të vetme. Ai vendos ritme dhe qasje të reja që pjallojnë procesin e të menduarit dhe krijimit të veprës time. Përkthimi i të tjerëve më ka përgatitur të përkthej veten time, dhe ky përjetim ka ripërcaktuar përfytyrimet që kam pasur në lidhje me fjalët si “origjinal”, “autentik”, dhe “autorësi”. Ndihej më pak në ankth dhe e vetëdijshme për shkrimin tim tani që e shoqëron përkthimi.

Biseda që kam kërkuar të kem me

letërsinë për një pjesë kaq të madhe të jetës time tani ndihet më e plotë, më në harmoni, gjithashtu dhe shumë më e pasur me mundësi. Jam habitur nga numri i shkrimtarëve italianë në antologjinë e Penguin të cilët kanë dedikuar kohë dhe energji të konsiderueshme për përkthimin, jo vetëm për mentorim dhe ndikim personal, por për të çuar më tej misionin thelbësor publik dhe politik për të hapur kufijtë gjuhësorë dhe kulturorë, edhe duke i prezantuar lexuesit me vepra të cilët ata nuk do t’i qasin dot ndryshe. Jam krenarë që jam në shoqërinë e tyre.

Në këtë pikë, nuk mund ta imagjinoj të mos punoj me një përkthim, po aq sa s’mund të imagjinoj të mos punoj – ose të mos mendoj të punoj – me shkrimet e mia. I mendoj si dy aspekte të të njëjtit aktivitet, dy anë të së njëjtës monedhë, ose ndoshta është më mirë t’i përshkruar si dy goditje, duke ushtruar forca të ndryshme por plotësuese, që më lejojnë të notoj në largësi më të mëdha, në thellësi më të mëdha, përmes elementeve misterioze të gjuhës.

LitHub / Përktheu E.H.



Si e ndryshuan Beatles kulturën amerikane

Joe McGasko

Deri në 7 shkurt të vitit 1964, Britania e Madhe njihej për shumë gjëra: çajin, flotën e kompletuar, rrobaqepësinë mjeshtërore, Mbretëreshën. Megjithatë, “eksporti i muzikës emocionuese,” nuk kishte vend kryesor në këtë listë. E gjithë kjo ndryshoi kur katër muzikantë të rinj anglezë nga Liverpool, u ulën në Aeroportin Ndërkombëtar John F. Kennedy, në New York dhe shkaktuan një shpërthim kulturor, i cili do të jehonte për shumë vite me radhë. Po i referohem, sigurisht, mbërritjes madhështore në Amerikë, të grupit unik të cilin të gjithë e kemi njohur dhe e duam, atë grup të mahnitshëm që e ndryshoi muzikën amerikane përgjithmonë: Beqarët!

Po, unë bëj edhe shaka. Beqarët janë një grup i mrekullueshëm (në janarin e vitit 1964, ata patën një këngë shumë të suksesshme dhe janë edhe sot aktivë), por ata nuk janë si Beatles. Asnjë grup nuk mund të jetë dhe asnjë grup nuk ka për t’u bërë ndonjëherë. Ishin Beatles ata që u ulën në Amerikë në shkurt të vitit 1964, për të mos u larguar më kurrë.

Është e vështirë të nënvlerësohet ndikimi i Beatles në rrugën e muzikës pop në Amerikë. Si individë të tjerë të caktuar në historinë e pop-it amerikan, përfshirë Benny Goodman, Frank Sinatra dhe Elvis Presley, ata nxitën një zjarr të hershëm, një periudhë “manie” ku adoleshentët shprehnin entuziazmin e tyre në grupe të mëdha në koncertet dhe shfaqjet publike. Por Beatles, njësoj si paraardhësit e tyre (madje edhe më shumë), kaluan përtej kësaj faze dhe u bënë një forcë kulturore, ku kompozimet dhe sjelljet e tyre po ndryshonin mënyrën se si muzika pop përjetohej nga një numër i madh njerëzish. Muzika e Beatles, duke rastisur në një nga periudhat më të trazuara të historisë së Amerikës, reflektoi atë epokë, madje edhe e kapërceu dhe ditët e sotme, muzika e tyre mbetet e freskët për çdo brez pasardhës që e zbulon.

Këtu kemi një vështrim të këndshëm mbi ndikimin që ata patën në terrenin kulturor amerikan. Ja shtatë mënyra se si Beatles e ndryshuan përgjithmonë Amerikën.

Beatles rritën standardin e cilësisë së idhullit për adoleshentët

Përpara se Beatles të mbërrinin në Amerikë, skena e muzikës pop mbijetonte midis sharmit të një grushti këngëtarësh me paraqitje të rregullt e me dhëmbë si ruaza të bardha, një pjesë e mirë prej tyre nga Philadelphia dhe muzika e të cilëve ishte aq e fabrikuar, sa imazhi i tyre si fqinj të mirë. Këta djem ishin të sjellshëm dhe në disa raste edhe kishin talent, por karriera e tyre drejtohej nga producentë dhe njerëz të industrisë, të

cilët ndërronin marshet e makinerisë që krijonte këngët e suksesshme, ajo çfarë muzika pop ishte bërë në fillim të viteve ’60. Sjelljet e “çmendura” të këngëtarëve si Little Richard apo Jerry Lee Lewis nuk shfaqeshin më dhe muzika rock’n’roll tani përfaqësohej nga këngëtarë më të menaxhueshëm si Fabian, Franklin Avalon dhe Bobby Rydell.

Të analizosh shijen e rinisë amerikane është një përpjekje e pakuptimtë (fakti që në vitet ’50, Pat Boone konkurronte dhe me raste e mposhte Elvis Presley-n në sondazhet e popullaritetit për të rinjtë, është thjesht dokument), por Beatles, ishin me siguri një frymë e re në një terren të mërziqshëm të idhujve të adoleshentëve. Theksi i tyre i Liverpool-it dhe paraqitja e pazakontë jo vetëm i bënte tmerrsisht ekzotikë, por ata ishin si katër idhuj për adoleshentët, të bashkuar në një pako të shndritshme. Ishte Paul, i lezetshëm dhe i adhuruarshëm; John, i zgjuar dhe pak i rrezikshëm; George, i urtë dhe i ndrojtur; dhe Ringo, argëtues dhe qesharak. Kishte diçka për të gjitha shijet e adoleshentëve dhe uniformiteti i prezantimit të tyre, “çuna, të gjithë për një dhe një për të gjithë,” i bënte edhe më tërheqës: stilet e ngjashme të flokëve, kostumet e mbërthyer pa kollare dhe çizmet me majë dhe takë kubaneze.

Një ndryshim i rëndësishëm midis Beatles dhe konkurrentëve të tyre, ishte se Beatles e kontrollin vetë paraqitjen. Me menaxherin Brian Epstein, ata zgjidhnin garderobën, një pjesë e mirë e së cilës ishte marrë nga miqtë e tyre të modës në Hamburg. Më e rëndësishme akoma, Beatles e kontrollonin vetë muzikën e tyre, e cila bazohej tek rhythm dhe blues, si dhe këngë nga shtëpia diskografike Motown, jo Patti Page apo Mitch Miller. Kur nuk këndonin këngë të vjetra që i zgjidhnin vetë, ata kompozonin këngët e tyre, diçka që pak këngëtarë të tjerë po aq të njohur mund ta bënin, edhe nëse ishin të aftë. Kjo e bënte të gjithë dallimin. Përveçse ishin të lezetshëm dhe karizmatikë, Beatles kishin edhe substancë, të cilën ishin të vendosur ta vërtetonin.

Beatles e bënë rebelizmin diçka të kohës në tendencën kulturore

Edhe pse sjellja rebele dhe kundërautoritare ka një traditë të vjetër në kulturën amerikane, Beatles u shfaqën në kohën kur kjo nuk ishte përhapur ende mirë. Në fakt, performuesit si komediani Lenny Bruce, i cili u persekutua për thyerjen e rregullave, përjashtoheshin nga trendi amerikan pasi krijonin telashe. Argëtimi në Amerikë u përpoq të ishte një industri të cilën njerëzit do ta respektonin, duke sjellë performues të parrezikshëm, njësoj siç Detroit prodhonte makina të sigurta.

Beatles ishin më të ndërgjegjshëm se aspirantët e tjerë në llotarinë e industrisë pop. Ata kuptuan një farë absurditeti në aktivitetin e kësaj muzike dhe dukeshin të vendosur të ndiqnin rrugën e tyre. Kjo sjellje binte gjithmonë në sy kur përballeshin me gazetarët. Gjatë këtyre momenteve, ata ua kthenin me qëllim të mirë pyetjet gazetarëve ose u përgjigjeshin me fjalë të kota. Beatles e bënë të qartë se ishin mendimtarë të pavarur, të cilët do të bënin atë që donin, pavarësisht se çfarë mendonte bota. Disa vite më parë, adoleshentëve u kishte ngjitur qëndrimi prej rebelësh i James Dean dhe Elvis Presley; Beatles përshtatën po këtë sjellje, por e shfaqën në mënyrë më të sofistikuar dhe pa rënë në sy. Shakatë e Beatles gjatë konferencave të shtypit, mund t’i thumbonin vërtetë gazetarët dhe ata nuk ishin asnjëherë aq të nënshtruar sa Elvis, i cili ishte gjithmonë i sjellshëm me të gjithë të rriturit, sado të pagdhendur të ishin. Ishte një nga mënyrat e shumta se si ata shfaqnin dijeninë e tyre ndaj sistemit të showbiz-it ku bënin pjesë dhe se sa shumë e meritonte vënien në lojë. Kjo anarki që krijohej, të rriturve u dukej edhe turbulluese, edhe e këndshme.

Me raste, grupi e çonte rebelizmin shumë larg; një koment i John Lennon ku thoshte se ishin “më të mëdhenj se Jezusi,” rezultoi në djegien e sasive të mëdha të albumeve të tyre në disa pjesë të Amerikës, si dhe në një rënie të përkohshme në shitjen e këngëve të tyre në vitin 1966. Por shumica e admiruesve të muzikës pop (dhe nëse ju ishit admirues i muzikës pop në vitet ’60, ishit admirues edhe i Beatles) e vlerësonin ndershmërinë e grupit dhe i besonin. Ky besim vetëm sa do të forcohej ndërsa Beatles vazhduan të përmirësoheshin dhe të hynin në fusha më të panjohura nga ana muzikore dhe politike. Të rinjtë i shihnin Beatles si përfaqësuesit e tyre kulturorë dhe ndiqnin drejtimin e grupit. Nuk do të kalonte shumë kohë para se rebelizmi të bëhej diçka kombëtare dhe, pas një farë kohe, një tipar i përhershëm i kulturës së rinisë amerikane (disa mund të thonë i të gjithë kulturës amerikane). Beatles, një faktor i pavarur me një sjellje që thoshte në djall pasojat, ka ndikuar aq shumë sa të tjerët në këtë transformim. Gjithashtu, ata i hapën dyert çdo grupi që mund ta shprehte këtë sjellje më lirisht, tani që pengesa ishte shtyrë më tej.

Beatles i bënë të pranueshëm flokët e gjatë për burrat, madje edhe të dëshirueshëm.

Tani duket qesharake, por përpara se Beatles të vinin në Amerikë, “flokëgjatë” ishte një term i cili u drejtohej një grupi të vogël njerëzish, shumica prej tyre artistë. “Flokëgjatë” ishte për shembull një referim shpërfillës ndaj disa muzikantëve të caktuar klasikë, ose Bitnikëve dhe Bohemianëve të tjerë. Flokët e gjatë shiheshin si diçka thelbësore e një temperamentit artistik të pazakontë, ndoshta me përjashtim të veçantë të burrave fetarë nga rajone të huaja, të cilët i rrisnin flokët dhe mjekrat me devotshmëri.

Më pas u shfaqën Beatles me flokët e tyre të “çrregullt.” Shumica e shkrimeve në shtyp të asaj kohe, merreshin me stilin e tyre të flokëve, i cili tani do të konsiderohej i rregullt dhe i pastër. Në një rast, një gazetar i cili i pyeti “Nga i gjetët këto stile flokësh...?” u ndërpre në çast nga John Lennon, i cili ia ktheu me ironi, “Po thua për flokët e shpuapurishur.” Njësoj si uniformat e skenës, stilet e flokëve të Beatles ishin një produkt i origjinalitetit gjerman dhe vinte nga komuniteti artistik që mbështeti Beatles në Hamburg. Sapo u bë i njohur, ky stil flokësh mori identitet të vetin kur paruke të Beatles nisën të prodhoheshin dhe komedianët në emisionet televizive visheshin si ata për të marrë të qeshura nga publiku. Jo për të përfituar nga kjo gjë e pakuptimtë, Beatles panë se si llogaritë e tyre bankare po mbusheshin, megjithëse nuk kaloi shumë para se ky stil i çrregullt flokësh të kalonte në vend të dytë. Teksa koha ecte dhe grupe të tjera ndoqën shembullin e Beatles, flokën u zgjatën gjithnjë e më shumë.

Në vitin 1966, Beatles mbanin mjekër. Pamja e plotë prej “hipi” ishte shumë afër dhe Beatles e nisën këtë trend. Në fund të viteve ’60, stili çrregullt i flokëve do të konsiderohej i dalë mode, përpara paraqitjes prej malësori që shumë figura pop-i po përfaqonin (George Harrison i Beatles ishte më leshtori). Flokët e gjata u bënë diçka dalluese, një simbol i përbuzjes për rregullat e shoqërisë; shumica e figurave të larta të shoqërisë e urrenin pamjen prej hipi dhe sulmet ndaj tyre nuk ishin të padëguara, madje edhe deri në fillim të viteve ’70. Megjithatë, me kalimin e kohës, edhe politikanët po i zgjasnin flokët mbi veshë e mbi jaka dhe revolucioni u fitua. Zgjatja e flokëve nuk ishte më një akt provokues, si në kohën kur Beatles e bënë për herë të parë. U kthye thjesht në një zgjedhje tjetër.

Beatles na trullosën

Edhe pse në bregun perëndimor të Amerikës ishin shfaqur me kohë dhe Donovan po fillonte të këndonte për supermenë të lumtur dhe “udhëtime” në Angli, gjatë viteve ’60, Beatles ishin ndër grupet e para pop dhe me siguri më ndikuesit, në infektimin e rrymës popullore në Amerikë, me virusin e halucinacioneve. Kur Beatles nisën të këndonin për “fikjen e mendjes,” LSD ishte ende një drogë e ligjshme në Amerikë, por pas disa vitesh do të bëhej e jashtëligjshme, kryesisht për shkak të imazhit të mirë që mori.

Treguesi i parë se Beatles kishin hyrë në një fazë të re zbulimi, ishte kënga e fundit në albumin e tyre të vitit 1966, Revolveri. Teksti i këngës “E nesërmja nuk di kurrë,” u riprodhua nga një

libër i titulluar “Përvoja e halucinacionit”: Një manual i bazuar në librin tibetian të të vdekurve, me bashkautorë përkrahësin e LSD-së, Dr. Timothy Leary, gurunë Ram Dass dhe akademikun Ralph Metzner. “E nesërmja nuk di kurrë”, njësoj si gjuha e librit, kishte një tekst abstrakt të përzier me një nuancë shpirtërore, ndërsa muzika i përshtatej tonit të tyre – një tingull muzikor indian ndërthurej me një motiv hipnotizues e të vazhdueshëm baterie, i cili dukej sikur do të ngatërrohej në çdo përsëritje dhe efekte të ndryshme si shirita kasete të kthyera mbrapsht, krijonin një përzierje të mbinatyrshme. Zëri i John Lennon u përpunua që të tingëllonte i largët dhe si vorbull. E qeshura e Paul McCartney u luajt së prapthi dhe u përsërit pa ndërprerje duke tingëlluar si një tufë pulëbardhash.

Rinia lehtësisht e ndikueshme mund ta shmangte këtë këngë të “çuditshme” duke e ngritur pak më shpejt gjilpërën e gramafonit, por prej bombës hipnotizuese “Përgjithmonë fusha me luleshtrydhe”, kënga pasardhëse e Beatles, nuk kishte shpëtim. Që nga teksti enigmatik (“Asgjë nuk është e vërtetë/ Dhe s’ka asgjë për t’u shqetësuar”) tek akordi i pazakontë e zhangëllues, e gjitha ishte si halucinacion, me një përmbyllje euforike të mbushur me tinguj qestre indiane, një violinçel që mezi dëgjohej dhe instrumente që luheshin së prapthi. Sigurisht, kishte edhe një pjesë të madhe të melodisë së Beatles, që e bënte këtë gjë anormale, më të këndshme.

“Përgjithmonë fusha me luleshtrydhe,” një nga 10 këngët më të mira, caktoi modelin për zhvillimin e plotë të fiksimit hipnotizues të Beatles ndaj Bandës së klubit të zemrave të vetmuara të rreshterit Pepper, një album, shpeshherë i cituar si albumi rrok më ndikues që është regjistruar ndonjëherë. Të gjithë po e dëgjonin, nga kolegët në skenën muzikore, tek adoleshentët në radiot e tyre. Rroku hipnotizues (dhe frymëzim e mënyrës së jetesës) do të bëhej gjatë viteve të ardhshme, një aspekt i rëndësishëm i kulturës amerikane. Sapo Beatles hyri në skenë, pemët me mandarina dhe qiejt prej marmalade, nuk ishin më diçka ekskluzive e një grushti muzikantësh anglezë dhe kimistëve amerikanë që i frymëzonin.

Beatles zhvilluan videot muzikore

Kur MTV debutoi për herë të parë në vitin 1981, Amerika u bë shteti i parë që kishte një stacion televiziv vetëm për muzikën. Në atë kohë, rrjeti televiziv kishte qëllim shfaqjen e videove muzikore, të cilat pas një farë kohe, do të bëheshin po aq popullore sa vetë këngët, kur artistët si Michael Jackson dhe Peter Gabriel nisën të sillnin gjëra të reja. Videoja muzikore u kthye në një simbol të viteve ’80, por rrënjët i kishte më të hershme. Siç mund ta merrni me mend, grupi Fab Four e kishte nisur këtë shumë herët.

Pamjet vizuale të shoqëruara nga muzika, e kanë origjinën që kur filluan filmat me zë dhe pjesë të caktuara nga filmat muzikorë të viteve ’30 dhe ’40, mund të merreshin për të krijuar diçka të ngjashme me një video muzikore. Në vitet ’40 madje, kishte makineri me monedha të cilat luanin filma të krijuar posaçërisht për promovimin e një kënge. Këto queshin Soundies. Në vitet ’50 dhe ’60, Francezët u përfshinë duke prodhuar makineri që quheshin Scopitones. Megjithatë, filmat e shkurtër që luheshin tek Soundies dhe Scopitones, në përgjithësi kishin kosto të ulët prodhimi dhe ishin të mërzitshëm.

Beatles e ndryshuan të gjithë këtë, me filmin e tyre të parë, Nata e një dite të vështirë. Ky film përmban disa sekuenca ku këngët luhen të plota dhe shërbejnë si shprehje e muzikës, por nuk e zgjasin ngjarjen e filmit. Më e famshmja prej tyre është sekuenca e këngës “Nuk më blen dot dashuri,” ku Beatles shfaqen duke kërcyer përreth një fushe. Montimi është përmbledhës, filmi shpejtohet dhe ngadalësohet sipas lëvizjeve të tyre dhe ka një përdorim origjinal të fotografisë me kënd të ulët dhe nga lart. “Nuk më blen dot dashuri,” në thelb, është një video muzikore.

Pas kësaj, Beatles vazhduan me dy video të palidhura me njëra tjetrën, për dy këngët kontroversiale, “Përgjithmonë fusha me luleshtrydhe” dhe “Rrugica e qindarkave.” Për të dyja u xhiruan filma të shkurtër. Më interesantja është “Përgjithmonë fusha me luleshtrydhe,” tek e cila, grupi gjendet sërish në një fushë, por këtë herë, efekti nuk është gëzim dhe humor, por drithërimë dhe turbullim, duke përdorur kthimin mbrapsht të filmit, vendosjen e imazheve njëri mbi tjetrin dhe zmadhimin pa u përqendruar në qendër, të cilat krijojnë një ndjesi hutimi. Filmi kulmon me rrëzimin e një pianoje dhe pjesa e përparme e saj, spërkartet me bojë nga grupi.

Meqë Beatles i kishin ndërprerë koncertet, këto filma promocionalë morën rëndësi. Përpara se karrierës së tyre t’i vinte fundi, ata bënë disa filma të tjerë për televizionet dhe kinematë. Përgjatë viteve ’70, shumë artistë (përfshi George Harrison dhe Paul McCartney) vazhduan të prodhonin filma të tillë, deri sa MTV erdhi dhe videot u kthyen në mjet standard për promovimin e këngëve.

Beatles i bënë të pranueshëm filmat vizatimorë me personazhe rroku.

Që kur filluan karrierën, dukej qartë se Beatles nuk pëlqeheshin vetëm nga një grup moshe. Pjesën më të madhe të audiencës së tyre të hershme e përbënin adoleshentët, por njerëzit më në moshë, si dhe të vegjlit, iu bashkuan këtij popullariteti. Një mënyrë për të tërhequr të vegjëlit, ishte përshtatja me ta dhe kështu, Beatles, pranuan prodhimin e

një filmi vizatimor të përjavshëm, ku do të luhej muzika e tyre. Filmi vizatimor The Beatles, edhe pse mbahet mend më pak se arritjet e tyre të tjera audiovizive, vazhdoi për tre sezona në televizionin ABC, nga mesi deri në fund të viteve ’60 dhe i ekspozoi adhuruesit e vegjël, ndaj muzikës së Beatles.

Beatles krijuan filmin e parë vizatimor për muzikën pop; me shumë gjasa ka qenë edhe i pari që bazohej në njerëz të vërtetë. Sigurisht, skenari ishte qesharak: John zvogëlohet nga një lëng magjik; Ringo bëhet toreanor; Paul rrëmbehet nga një shkencëtar i çmendur i cili kërkon ta martojë me vajzën e tij vampire; George përfshihet në një duel sërri me një personazh të quajtur Surf Wolf. Ngjarja e çdo episodi ishte kryesisht një pretekst për të shfaqur dy këngë të Beatles, disa prej të cilave ishin këngë pak të njohura, por të përfshira në album. Animimi nuk ishte shumë i sofistikuar, por nga viti 1965, deri në vitin 1969 (dy vitet e fundit ishin përsëritje), ishte emisioni kryesor i paraditës së të shtunës.

Edhe pse Beatles nuk i përkushtoheshin shumë filmit vizatimor dhe nuk bënëin gjë përveçse autorizonin muzikën e tyre, sërish pati ndikim. Personazhe të reja që përfaqësonin grupe të vërtetë rroku (Jackson 5, Osmonds) dhe të trilluara (Archies, Josie dhe Pussycats) ndoqën po këtë linjë. Në fakt, për të reflektuar muzikën që shoqëronte filmat vizatimorë, u krijuar një zhanër i ri pop-i: bubblegum.

Në kohën kur këngët e zhanrit bubblegum po kryesonin renditjet muzikore, Beatles e kishin lënë pas botën e filmave vizatimorë, por jo përpara se të binin dakord për prodhimin e një filmi të plotë të tillë, të bazuar në këngën e tyre “Nëndetësja e verdhë.” Ngjyrat hipnotizuese të filmit “Nëndetësja e verdhë,” reflektonin më saktësisht shijet e tyre në atë pikë të karrierës, megjithëse është intriguese të theksohet se emisioni televiziv, u përpoq të përfshinte edhe “Përgjithmonë fusha me luleshtrydhe.” Beatles kishin hapur sërish derën dhe animime të tjera që kishin muzikën e Nilsson, Pink Floyd dhe bandave të rrymës heavy metal, do t’i pasonin. Pavarësisht ndikimit, seriali vizatimor The Beatles, duhet ende të rishitet në format DVD, megjithëse qarkullojnë versione gjysmë të ligjshme dhe një pjesë e mirë e tyre mund të shihen online, por me cilësi të dobët.

Beatles ndryshuan mënyrën se si e përjetojmë muzikën

Ne jetojmë tani në epokën e shkarkimit të këngëve, ku dëgjuesit kanë më shumë gjasa t’i blejnë në internet, sesa në dyqan dhe kanë më shumë gjasa të blejnë një këngë të suksesshme, sesa një album të tërë. Në disa mënyra, kjo metodë për të blerë këngët, e ka origjinën përpara se të vinin Beatles, kur të gjitha burimet, përqendroheshin në kompozimin e një kënge të suksesshme. Kënga regjistrokej, publikohej më vete me një shpejtësi luajtje prej 78 ose 45 rrotullimesh në minutë dhe njerëzit, ose e blinin, ose nuk e blinin. Nëse e blinin, bëhej një sukses. Në ditët e hershme, Beatles përparonin pasi këngët e tyre ishin gati gjithmonë të suksesshme. Në prill të vitit 1964, pothuajse dy muaj pas mbërritjes në Amerikë, këngët e Beatles zunë pesë pozicionet e para në renditjen e 100 këngëve më të mira të Billboard.

Edhe pse kjo ishte mënyra se si industria e muzikës funksiononte, Beatles nuk e shihnin veten si një makineri që prodhonte vetëm këngë individuale, megjithëse publikuan disa

nga këngët më të suksesshme në historinë e muzikës. Ata u përpoqën t’i bënin të gjitha këngët e tyre cilësore, në një kohë kur albumet mbusheshin kryesisht me materiale jo të mira, për të rritur shitjen e një kënge të suksesshme. Përpara Beatles, ka pasur përjashtime nga ky rregull, si për shembull Frank Sinatra, i cili mblidhte shumë pllaka të këngëve që i përkisnin një teme të caktuar, ose këngëtarë të ndryshëm xhazi, tingulli i të cilëve përmirësohej me çdo publikim. Por Beatles ishin muzikantët e parë pop që përpunuan albume ku secila këngë, ishte pjesë e rëndësishme e së gjithës. Ata punonin që çdo album të kishte cilësi të lartë, nga fillimi, deri në fund. Ata nisën t’i vinin rëndësi albumit, në vend të këngës së suksesshme.

Në Amerikë, në mënyrë ironike, një pjesë e mirë e kësaj përpjekje mposhtej nga shtëpia diskografike e Beatles, Capitol. Të paduruar për t’i mbushur raftet me më shumë produkte, Capitol, merrte publikimet e Beatles në shtëpinë diskografike Parlophone në Britani dhe i rishpërndante në më shumë albume, duke shtuar këngët të cilat në Britani nuk u publikuan. Pllaka gramafoni dhe shkurttime në kohën e luajtjes. Si pasojë, në Amerikë u publikua dyfishi i këngëve, krahasuar me Britaninë. Në raste të rralla, metoda ju pëlqen ose jo e Capitol, do t’u mundësonte adhuruesve amerikanë, blerjen e këngëve që në Britani nuk ishin publikuar ende (si për shembull “Dizzie Miss Lizzie” e Beatles VI), në mënyrë që adhuruesit britanikë, t’i importonin pllakat e gramafonit nga Amerika! Por, shumicën e kohës, ajo çfarë adhuruesit amerikanë po merrnin, ishin versione të ngatërruara të asaj çfarë kishin synuar Beatles. Beatles nuk donin që këngët individuale të përziheshin me përmbledhjet e këngëve të krijuara me aq kujdes, e megjithatë, Capitol bëri pikërisht këtë gjë. Sidoqoftë duhet theksuar se, sado e padëshiruar mund t’u jetë dukur Beatles kjo praktikë, për adhuruesit amerikanë ishte një mrekulli, të dëgjonin të gjitha këngët e preferuara, në një pllakë që luante për një kohë të gjatë.

Kjo praktikë vazhdoi deri tek Rreshteri Pepper në vitin 1967, kur Beatles më në fund, u siguruan që të dyja kompanitë diskografike, të publikonin të njëjtin version të albumit duke ruajtur kështu, vizionin e tyre. Një nga arsytet që albumi Rreshteri Pepper ka privilegjin të jetë LP (pllakë me të gjitha këngët e grupit), është se u përjetua njësoj në të gjithë botën. Publikimet e mëpasshme të Beatles, të konsideruara si shembuj tipikë të albumeve të shkëlqyera të muzikës pop, ndoqën po këtë mënyrë. Në rastin e albumit Abbey Road, edhe pse prej tij u publikuan këngë individuale, konsiderohet përgjithësisht si diçka e plotë e që mund të shijohet më mirë ashtu. Edhe pse ideja e këngëve të suksesshme nuk u zhduk, disa grupe të mëvonshme në vitet ’60 dhe ’70, të frymëzuar nga metoda e Beatles, u përqendruan aq shumë në prezantimin e albumeve, saqë as nuk e morën mundimin të publikonin këngë individuale.

Pavarësisht faktit se disa të çmendur pas Beatles i konsideronin si thertore, shumë adhurues amerikanë ndiejnë ende një lidhje sentimentale me versionet e hershme amerikane të albumeve të Beatles. Tani, në 50 albumet më të mira në Billboard, renditet një set albimesh amerikanë të Beatles. Mbi 50 vjet pasi mbërritën në Amerikë, Beatles mund të përjetojnë sërish, ashtu siç amerikanët i njohën për herë të parë – me të gjitha këngët të përfshira!

Përktheu nga anglishtja David Hudhri



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

ARBNI

HISTORIK, GJEOGRAFIK,
KISHTAR DHE POLITIK



AUREL PLASARI

Onufri